



# Koha

www.koha.mk



Refugjatët,  
shpresa  
dhe frika

FAQE 12-13

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3205 • E enjte 26 tetor 2017 15 DEN

## ASH-BESA bashkë edhe në zgjedhjet e ardhshme



Shkup, 25 tetor - Krerët e koalicionit "Me dije dhe guxim për një jetë të re", Ziadin Sela i Aleancës për Shqiptarët dhe Bilall Kasami i Lëvizjes BESA të mërkurë në Tetovë u shfaqën bashkë në një takim me intelektualët tetovar duke bërë të qartë konturat e vazhdimet të koalicionit dhe duke premtuar se BDI-në do ta nxjerrin në opozitë si në pushtetin lokal tani - ashtu dhe në pushtetin qendror në zgjedhjet e ardhës parlamentare. "Të mos keni asnjë dilemë. Ky është fillimi i koalicionit për zgjedhjet parlamentare dhe realisht - BDI ka pse të ketë frikë dhe pse janë të shqetësuar, ka pse sil-

len si pa kokë. Shumë shpejtë, kurdo që të jenë zgjedhjet parlamentare, ata do t'i shohim në opozitë, edhe atë në opozitë të thellë", theksoi Ziadin Sela gjatë konferencës për shtyp të mbajtur në Universitetin e Evropës Juglindore, duke i ofruar njëherësh dhe përkrahje...

len si pa kokë. Shumë shpejtë, kurdo që të jenë zgjedhjet parlamentare, ata do t'i shohim në opozitë, edhe atë në opozitë të thellë", theksoi Ziadin Sela gjatë konferencës për shtyp të mbajtur në Universitetin e Evropës Juglindore, duke i ofruar njëherësh dhe përkrahje...

FAQE 2

Pacoli në vizitë diplomatike në Maqedoni

## Me Kosovën s'kemi çështje të hapura



Pacoli në Shkup i diskutoi fushat konkrete në të cilat do të intensifikohet bashkëpunimi midis Maqedonisë dhe Kosovës. Ato janë ekonomia, energjetika, infrastruktura, lehtësimet doganore, lëvizja më e thjeshtë e njerëzve dhe mallit. Është dakorduar që qeveritë e Maqedonisë dhe të Kosovës t'i nxitin bashkësitë e biznesit dhe odave për bashkëpunim më të fuqishëm dhe më aktiv, si dhe realizimin e takimeve më të shpeshta në nivel të lartë qeveritar

FAQE 4

RAJON

Habilajt në  
4 vjet  
trafikuan 30  
tonë kanabis



Grupi kriminal i drejtuar dhe i organizuar nga vëllezërit Habilajt kanë trafikuar nga brigjet shqiptare drejt atyre Italiane rreth 30 tonë kanabis sativa. Në këtë konkluzion kanë dalë hetuesit italian, ku ky aktivitet kriminal ishte kryer në harkun 2013-2017. Gjatë biseda të përgjuara dhe të bëra...

FAQE 14

RAJON

Rruga e  
ngadalshme  
e Kosovës  
drejt BE-së

FAQE 14

GLOBI

Fillon me  
detyrë min-  
istri i parë  
në botë i  
Inteligjencës  
Artificiale

FAQE 15

## Rritet numri i martesave nën 18 vjet!



Shkup, 25 tetor - Nuk janë të pakta martesat midis të miturve nën moshën 18 vjeçare në vendin tonë, derisa kjo dukuri më së shpeshti ndodh tek etniteti rom. Disa nga arsyet janë mungesa e arsimit, tradita, varfëria, papunësia... Vetëm vitin e kaluar janë martuar mbi 100 femra të moshës nën 18

vjeçe, thonë të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror për Statistikë të Maqedonisë. "Në vitin 2014 janë martuar 13 meshkuj dhe 163 femra të moshës nën 18 vjet. Në 2015 janë martuar 5 meshkuj, ndërsa 135 femra të moshës nën 18 vjet, ndërsa vitin e kaluar - nën moshën 18 vjeçare janë martuar 7 djem dhe

119 femra", thonë për KOHA nga Enti Shtetëror për Statistikë e Maqedonisë. Për momentin, në Maqedoni nuk ka shumë hulumtime që merren më seriozisht me këtë problematikë. Organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve - UNICEF, vitin e kaluar në raportin e saj...

FAQE 4

KULTURË

Benigni: Si të  
bëhesh poet



FAQE 18





Liderët e partive ndezin atmosferën para 29 tetorit

Kryetari i ASH-së, Ziadin Sela të mërkurën në Tetovë i dha përkrahje kandidatit të Lëvizjes BESA, Bilall Kasami duke i bërë të qarta konturat e vazhimit të koalicionit edhe për zgjedhjet parlamentare kurdo që të mbahen ato. Nga ana tjetër, nënkryetarja e LSDM-së, Radmilla Sheqerinska, i dha përkrahje kandidates së BDI-së për Tetovën, Teuta Arifi, ndërsa lideri i LSDM-së, Zoran Zaev, pritet që gjatë një tubimi me qytetarët sot në Strugë, hapur të mbështesë Ramiz Merkon e BDI-së për kryetar komune

# Koalicioni ASH-BESA edhe në zgjedhjet e ardhshme



Koha **Fatos RUSHITI**

Shkup, 25 tetor - Krerët e koalicionit "Me dije dhe guxim për një jetë të re", Ziadin Sela i Aleancës për Shqiptarët dhe Bilall Kasami i Lëvizjes BESA të mërkurë në Tetovë u shfaqën bashkë në një takim me intelektualët tetovar duke bërë të qartë konturat e vazhimit të koalicionit dhe duke premtuar se BDI-në do ta nxjerrin në opozitë si në pushtetin lokal tani - ashtu dhe në pushtetin qendror në zgjedhjet e ardhës parlamentare. "Të mos keni asnjë dilemë. Ky është fillimi i koalicionit për zgjedhjet parlamentare dhe realisht - BDI ka pse të ketë frikë dhe pse janë të shqetësuar, ka pse sillen si pa kokë. Shumë shpejtë, kurdo që të jenë zgjedhjet parlamentare, ata do t'i shohim në opozitë, edhe atë në opozitë të thellë", theksoi Ziadin Sela gjatë konferencës për shtyp të mbajtur në Universitetin e Evropës Juglindore, duke i ofruar njëherësh dhe përkrahje kandidatit të BESËS për Komunën e Tetovës, Bilall Kasami.

**ASH mbetet në Qeveri, thotë Sela**

"Kam ardhur të jap përkrahjen për kandidatin e Tetovës, Bilall Kasami. Urime Bilall", tha Sela. Ndërkaq lideri i Lëvizjes BESA, Kasami tha se koalicioni me ASH-në është pritur gjatë kohës nga populli dhe se do të jep rezultate për fitore në komunat ku kandidojnë kundër kandidatëve të BDI-së. "Është ky koalicion i fitores në gjitha komunat. Bashkëpunim i kërkuar nga populli dhe për popullin, i pritur gjatë kohës dhe në kohë të duhur. Do të jep rezultate për ndryshim dhe fitore për ta larguar këtë të keqe edhe

## SHILEGOV E MORI FUNKSIONIN E KRYETARIT TË SHKUPIT

Kryetari i ri i Qytetit të Shkupit, Petre Shilegov, të mërkurën e mori funksionin e kryetarit të komunës nga kryetari i deritanishëm Koce Trajanovski i cili udhëhoqi me kryeqytetin në tetë vitet e fundit. Duke iu falënderuar qytetarëve për besimin e dhënë, Shilegov tha se kjo paraqet obligim për të që të punojë me përgjegjësi, në mënyrë transparente, si nikoqir dhe në interes të të gjithë qytetarëve. "Pas shumë viteve arritëm që Shkupin t'u kthejmë qytetarëve. Shkupi sërisht do të jetë qytet i humanitetit dhe qytet i solidaritetit. Maqedonia përfundimisht fitoi kryeqytet i cili do t'i ndërlihdë qytetarët dhe do të punojë për ata. Administrata e re e qytetit të cilën do ta udhëheqë, do të vazhdojë parimi i përgjegjësisë, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies që e vendosi Qeveria e udhëhequr nga LSDM-ja. Do të punojmë në interes të të gjithë qytetarëve pa dallim të vendbanimit të tyre, përkatësinë e tyre etnike apo përkatësinë partiake", theksoi Shilegov, duke shtuar se të gjitha vendimet do të merren së bashku me shoqëritë civile dhe opinionin profesionist. Si çështje prioritare në të cilën do të punojë Shilegov i theksoi uljen e ndotjes së ajrit për të cilën është paralajmëruar gjelbërim urgjent i qytetit, gazifikim dhe ndërtim i unazës sekondare të komunikacionit i cili do të mundësojë zhvillim të llojeve bashkëkohore të transportit publik. Para takimit me Trajanovskin, kryetari të ri të komunës Shilegov iu dorëzua vendimi për kryetar komune.



në pushtetin qendror dhe lokal", theksoi Kasami. Sa i përket pozicionit në Qeveri të ASH-së, Sela tha se janë spekulime nga BDI për të krijuar, siç shtoi ai, huti tel votuesit. Sela u zotua se do të rezistoj në Qeveri deri në miratimin e plotë të Ligjit për gjuhën shqipe. "Bëhet propagandë dhe spekulime nga Bashkimi Demokratik për

Integrim që të krijojnë huti te votuesit. Aleanca për Shqiptarët vazhdon të jetë pjese e Qeverisë. Derisa të bëhet shqipja gjuhë zyrtare, derisa të plotësohet ky premtim elektoral, as që dua të dëgjoj për tema të tilla. Për Ligjin e gjuhës shqipe, ia vlen të rezistoj, të qëndrohet në Qeveri, do ta shqyrtojmë mundësinë edhe me

PDSH-në, do të shohim", tha Sela. Nga gazetarët pati pyetje provokative për Selën lidhur me qëndrimet e tij mëshërshme për financimet e lëvizjes BESA, nëse i ka dhe të njëjtat edhe sot. "Institucionet e shtetit do të merren me dyshimet për financat e partisë BESA, sepse dyshime mund të ketë", u përgjigj shkurt Sela. Më

pas, gjatë tubimit me qytetarë në sheshin ILIRA të Tetovës, Sela bëri apel elektoratit të tij të votojë Kasamin. "Këtë mesazh e them në gjuhë shqipe, them shumë natyrshëm, pa pasur nevojë që të kem prapa, ku di unë gjuhë tjera, dhe pa pasur nevojë që të zihemi ngushtë nga ai mesazh që japim. Të tjerët që dalin dhe tani për një grusht vota, nuk e di a e kanë në natyrën e tyre, do të kisha dashur që të dalin nga natyra e tyre dhe në natyrën e tyre të jetë indi kombëtar shqiptarë, por siç duket - e kanë pasur në natyrën e tyre që të turpërohen, realisht do të duhet të turpërohen", deklaroi Sela. Sela më tej shtoi se duhet të çrrënjohet një oktapod, siç tha ai, që di të shantazhojë shoqërinë shqiptare duke përmendur zgjedhjet lokale të 2013-ës dhe ato parlamentare të 2014-ës. "Duhet përfundimisht të çrrënjohet një oktapod thellë i ngulitur në shoqërinë shqiptare, i cili di të shantazhojë, të kërcënoj saqë fitohet përshtypja se ky raund i dytë i zgjedhjeve lokale, nuk ndryshon aspak nga zgjedhjet lokale të vitit 2013, ato të vitit 2014, duke pasur parasysh kërcënimet që bëjnë institucionet e shtetit", akuzoi Sela. Më tej, duke aluduar në përkrahje që LSDM po i jep BDI-së, Sela tha se reformat qeveritare nuk nënkuptojnë të përkrahen, siç tha ai, kriminelët që duhet të ishin në burg dhe jo nëpër tubime. "Reformat, qeveri reformatore në të cilën edhe unë bëj pjesë si Aleancë për Shqiptarët, reformat nuk janë të këtila. Reformat nënkuptojnë mbi gjitha lirinë e qytetarit, reformat nënkuptojnë kriminelët dhe njerëzit që kanë shkelur ligjet të përfundojnë dhe të përgjigjen para ligjeve dhe në burg dhe jo të përkrahen nëpër tubime", i apeloj Sela kryeministrit Zoran Zaev.

**Edhe Sheqerinska mbështet Arifin**

Nga ana tjetër, eksponentë të lartë të LSDM-së, së fundmi edhe nënkryetarja Radmilla Sheqerinska i ofroi përkrahje kandidates së

BDI-së për Tetovën, Teuta Arifit. "Arifi ka qenë njëra nga politikanet, vendimi i së cilës pas zgjedhjeve parlamentare, ka mundësuar ndryshimet në shtet për koncept për paqe, prosperitet dhe shanse për të rinjtë që jetën e tyre ta kalojnë në Maqedoni", theksoi Sheqerinska. Ndërsa Teuta Arifi tha se ndryshimi i vërtetë ndodhi më 15 tetor, kur doli me mbi 5000 vota kundër rivalit të saj nga Lëvizja BESA, Bilall Kasami. "Prioritet për katër vitet e ardhshme do të jetë ndërtimi i kapaciteteve për trajtim të ujërave të zeza për çka Tetova - së bashku me Strumicën dhe Manastirin do të fitojnë mjete të IPA fondeve, do të hapim disa bulevarde në qytet dhe shumë projekte tjera", theksoi Arifi. Nga ana tjetër, lideri i LSDM-së, Zoran Zaev për sot (e enjte) ka paralajmëruar se do ta vizitojë Strugën për të dhënë mbështetje kandidatit të BDI-së në këtë komunë, Ramiz Merko. Ndërkaq, lideri i BDI-së, Ali Ahmeti të mërkurën ka qëndruar në Dollnen dhe në fshatrat Kamjan dhe Pallçishtë të Komunës së Bogovinës për të mbështetur kandidatin e partisë së tij për kryetar komune. BDI e Ahmetit, Dega në Çair, përmes një kumtese ndërkohë për media akuzoi kandidatin e Lëvizjes BESA për Komunën e Çairit, Zeqirja Ibrahimimi, se i ka ofruar postin e nënkryetarit të Komunës një kuadri të VMRO-së. "Lëvizja BESA dhe kandidati i saj për kryetar komune në Çair, Zeqirja Ibrahimimi, me secilën parti politike që ulet dhe bisedon, ua ofron postin e zëvendëskryetarit të Komunës së Çairit. Abija Zeqë në mospasjen e rrugëdaljes tjetër, i ka premtuar VMRO-së postin e zëvendëskryetarit të Komunës, nëse anëtarët e partisë opozitare maqedonase në Çair votojnë për Ibrahimin. Ai gjithashtu në këmbim të votave, VMRO-DPMNE-së i ka ofruar postin e drejtorëve në dy shkolla fillore dhe në dy çerdhe, të cilët gravitojnë në territorin e Komunës së Çairit", thuhet kështu në kumtesën e Degës së BDI-së në Çair.



**Eksponentë të lartë të LSDM-së, së fundmi edhe nënkryetarja Radmilla Sheqerinska i ofroi përkrahje kandidates së BDI-së për Tetovën, Teuta Arifit. "Arifi ka qenë njëra nga politikanet, vendimi i së cilës pas zgjedhjeve parlamentare, ka mundësuar ndryshimet në shtet për koncept për paqe, prosperitet dhe shanse për të rinjtë që jetën e tyre ta kalojnë në Maqedoni", theksoi Sheqerinska**





Pacolli në Shkup i diskutoi fushat konkrete në të cilat do të intensifikohet bashkëpunimi midis Maqedonisë dhe Kosovës. Ato janë ekonomia, energjetika, infrastruktura, lehtësimet doganore, lëvizja më e thjeshtë e njerëzve dhe mallit. Është dakorduar që qeveritë e Maqedonisë dhe të Kosovës t'i nxitin bashkësitë e biznesit dhe odave për bashkëpunim më të fuqishëm dhe më aktiv, si dhe realizimin e takimeve më të shpeshta në nivel të lartë qeveritar

Shkup, 25 tetor - Qeveria e Maqedonisë është përcaktuar të ndërtojë marrëdhënie të mira me Republikën e Kosovës, si dhe me të gjithë fqinjët dhe me këtë në mënyrë aktive të kontribuojë ndaj ardhmërisë së tërë rajonit të Ballkanit Perëndimor, në Bashkimin Evropian dhe në NATO, theksoi të mërkurën kryeministri Zoran Zaev në takim me ministrin e Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli. "Kemi potencial, si dy qeveri të reja të cilat mendojnë mirë për qytetarët e tyre dhe shtetet e tyre, të ecim përpara në proceset eurointegruese", vlerësoi kryeministri Zaev. Siç kumtoi shërbimi qeveritar për media, në takim se bashku është konstatuar se Maqedonia dhe Kosova nuk kanë çështje të hapura bilaterale, që hap mundësi të mëdha për përparimin e marrëdhënieve midis dy shteteve.

"Jemi të përkushtuar si Qeveri, ta përmirësojmë cilësinë e jetës së qytetarëve tanë dhe t'i hapim perspektivat euro-atlantike. Do t'i ndër-marrim të gjitha hapat e nevojshme për realizimin e qëllimeve qytetare dhe shtetërore", shtoi kryeministri Zaev. Bashkëbiseduesit diskutuan për fushat konkrete në të cilat do të intensifikohet bashkëpunimi midis Maqedonisë dhe Kosovës. Ato janë ekonomia, energjetika, infrastruktura, lehtësimet doganore, lëvizja më e thjeshtë e njerëzve dhe mallit. Është dakorduar që qeveritë e Maqedonisë dhe të Kosovës t'i nxitin bashkësitë e biznesit dhe odave për bashkëpunim më të fuqishëm dhe më aktiv, si dhe realizimin e takimeve më të shpeshta në nivel të lartë qeveritar. Ministri Pacolli theksoi

Pacolli në vizitë diplomatike në Maqedoni

## Me Kosovën nuk kemi çështje të hapura



se Kosova i mbështet integrimet në NATO të Maqedonisë që do të kontribuojnë ndaj përfundimit të sigurisë dhe do të ndikojnë në perspektivat për tërë rajonin, ndërsa shprehu edhe transparencë në perspektivat për tërë rajonin, si dhe shprehu edhe transparencë për zbatimin e përvojave nga Maqedonia në integrimet e BE-së. Ai vlerësoi se Zaev me aftësi të madhe dhe dinjitet ka krijuar një shoqëri për të gjithë. Me këtë, siç vlerësoi ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, kryeministri Zaev ka treguar si respektohen njerëzit pavarësisht nga cilado diferencë dhe ka bërë kthim në marrëdhëniet dhe respektimin midis qytetarëve në Maqedoni, për çka e ka respektin e tërë rajonit dhe të botës, duke e përfshirë edhe Republikën e Kosovës. Në takim u bisedua edhe për mundësinë për realizimin e takimit në nivel më të lartë të kryeministrave. Në ndërkohë, në takim me Pacolli me homologun maqedonas, Nikolla Dimitrov, është folur edhe për anëtarësimin e Kosovës në UNESKO.

"Vendimin në lidhje me kërkesën e Kosovës për anëtarësim në UNESKO, Maqedonia do ta sjell në bazë të interesit të Kosovës, të Serbisë, por edhe në pajtim të interesave personale, që i përfshin edhe interesat e pjesëtarëve të komunitetit shqiptar",

porositi ministri Dimitrov. "Maqedonia këtë çështje e trajton me vëmendje të jashtëzakonshme, sepse bëhet fjalë për çështje që i ndan dy fqinjët tanë, të cilët duam të jenë në anën e njëjtë. Ne nuk do të kemi rol kyç në atë proces dhe pasi do të vijë në rend dite do t'i kemi parasysh interesin e miqve tanë nga Kosova, interesin e miqve tanë nga Serbia dhe do të sjellim vendim në pajtim me interesat e Republikës së Maqedonisë, që i përfshijnë edhe interesat e bashkëqytetarëve tanë, të cilët janë pjesëtarë të komunitetit shqiptar", theksoi Dimitrov. Ai përmendi se të gjitha shtetet e Ballkanit duhet sa më shpejt ta pranajnë perspektivën se nuk ka anë, madje edhe për çështjet më delikate, sepse siç tha "të gjithë së bashku një ditë do të gjendemi në të njëjtën anë". Pacolli nga ana e tij theksoi se anëtarësimi i Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare, e rrit edhe cilësinë e jetës së qytetarëve në Kosovë dhe përmendi se ky proces shkon edhe në drejtim të anasjelltë. "E mbështesim Maqedoninë dhe e presim mbështetjen e saj. Ne jemi dy vende fqinje dhe fqinji nuk zgjidhet. Fati ynë është të bashkëpunojmë", shtoi ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës.

Autoritetet prishtinase në fillim të muajit kumtuan se kanë hequr dorë nga kërkesa për anëtarësim në Interpol

dhe UNESKO-s. MPJ e Kosovës kumtoi se "anulimi pragmatik" i kërkesës është bërë në pajtim me SHBA-në, Britaninë e Madhe, Francën, Gjermaninë dhe Italinë. Qeveria e Kosovës paradokshe paralajmëroi se punon në anëtarësimin në Interpol vitin e ardhshëm dhe në UNESKO në vitin 2019. Dy ministrat në takim me djeshëm në Shkup kanë arritur marrëveshje që të mbajnë seanca të përbashkëta qeveritare, me ç'rast e para është caktuar për në fillim të vitit të ardhshëm. Kosova dhe Maqedonia, siç përmendi Dimitrov kanë kornizë solide juridike, të bazuar në 19 marrëveshje dypalëshe dhe shumë nisma për përmirësimin e bashkëpunimit. Pacolli theksoi se në takim është biseduar për mundësitë për ndër-lidhje infrastrukturore, mënjanim të barrierave në transport dhe tregti, rritje të vëllimit të shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve. Shefi i diplomacisë kosovare përmendi se është biseduar edhe për mundësinë për zonë të lirë ekonomike, si dhe për mundësinë që doganimi të bëhet vetëm në një vend. Maqedonia dhe Kosova kanë vendosur marrëdhënie diplomatike në vitin 2009. Kosova është vendi i 127-të me të cilën Republika e Maqedonisë ka vendosur marrëdhënie diplomatike nën emrin kushtetues.

## Qeveria greke nuk ka pozicion për çështjen për emrin

Shkup, 25 tetor - Deputeti i partisë opozitare greke Demokracia e Re i obliguar për politikë të jashtme, Jorgos Kumucakos, sërish e sulmoi qeverinë greke për atë se nuk ka pozicion të përbashkët dhe të vetëm për çështjen për emrin. Kumucakos në një intervistë për agjencinë shtetërore APE-MPE deklaroi se, për dallim nga partnerët qeveritarë, partia e tij ka qëndrim të qartë për emrin, ai nga Bukureshti nga viti 2008. "Çështja kyçe është se çfarë pozicioni do të marrë qeveria, e cila mban edhe "përgjegjësi, thotë Kumucakos për çështjen për emrin, me ç'rast shtoi se qeveria aktuale në Greqi është ndarë në tre pjesë për këtë, siç tha, "çështje të rëndësishme". "Nga njëra anë, janë ministri i Financave Cakalotos, ministri i Arsimit Gavroglu, këshilltari i kryeministrit Karanikas, ish-ministria Hristodulopulu, me qëndrim tjetër është shefi i diplomacisë greke Nikos Koxias, ndërsa krejt të tretë ka ministri i Mbrojtjes dhe partneri i Koalicionit Panos Kamenos, i cili nuk e fsheh pozitën e tij se është kundër termit Maqedoni të jetë i përfshirë në emrin në vendin fqinj", sqaron Kumucakos. "Nga njëra anë, funksionarë të lartë qeveritarë në vitin 2008, pak para betejshes nacionale në Bukuresht nënshkruan tekst në të cilin e mbështesin emrin 'Maqedoni'. Thanë se nuk ekziston kurrfarë 'interesi nacional' që do të rrezikohet, nëse vendit fqinj i jepet mundësi ta mbajë emrin kushtetues. Atëherë, natyrisht, folën për 'integrim të drejtpërdrejtë të Republikës së Maqedonisë në NATO'. Nga ana tjetër, Koxias e ka përvetësuar pozicionin për emrin e përbërë me përcaktim gjeografik para fjalës Maqedoni, i cili do të vlejë për të gjithë (egra omnes), për çdo përdorim edhe të brendshëm edhe të jashtëm. Kamenos dhe deputetët e tij, ndërkaq, kanë pozita të ndryshme", sqaron Kumucakos në intervistën për agjencinë shtetërore greke të lajmeve. Ai e potencoi nevojën që Qeveria greke të ndërtojë pozitë të vetme, e cila do ta mbështesë tërë shumicën qeveritare. "Vendi nuk mund të negociojë me synime të paqarta", potencoi Kumucakos. Në periudhën e fundit, ky anëtar i shquar i partisë opozitare Demokracia e Re, në mënyrë gjithnjë e më të zëshme dhe më intensifikuese ka komentuar se Greqia nuk mund të hyjë në negociata me ministër të Punëve të Brendshme dhe të Mbrojtjes me pozicione diametralisht të kundërta në kontestin me emrin.

Ivanov në Bruksel

## Nevojitet mesazh pozitiv për zhbllokimin e integritetit



Bruksel, 25 tetor - Presidenti Gjorge Ivanov, të mërkurën në Bruksel real-

izoi takim me njeriun e parë të Këshillit Evropian, Donald Tusk, në të cilin

kërkoji impuls të ri dhe dërgimin e mesazhit pozitiv në drejtim të zhbllokimit të integritetit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian dhe fillimin e negociatave inkuadruese për anëtarësim. Siç njofton korrespondenti i MIA-s nga Brukseli, në deklaratën e tij pas takimit, presidenti Ivanov konfirmoi se në fokus të takimit me Tuskun ka qenë e ardhmja evropiane e Maqedonisë dhe gjithë asaj që e bën vendi që përfundimisht të marrë datë për fillimin e

negociatave, por edhe gjendja në rajon dhe në BE, si dhe çështja me krizën e emigrantëve që e tronditi kontinentin. "Tusk desh të dëgjojë prej nesh për pikëpamjet tona për gjendjet edhe në Bosnjë e Hercegovinë dhe në Serbi. Biseduam edhe për krizën e emigrantëve dhe të gjithë atë që si përvojë e fituam prej vitit 2015, gjegjësisht çfarë janë trendet e reja, çfarë po ndodh në rrethim dhe ngjashëm. U hapën temat për të ardhmen evropiane të Maqedonisë,

gjendjen në rajon dhe krizën e emigrantëve, por edhe për brengosjen tonë për gjendjet në BE, gjegjësisht se çfarë po ndodh këtu dhe fundit në BE, siç është rasti me Bregzitin, ngjarjet në Katalonjë dhe lëvizjen e cila ekziston në BE për marrjen e të drejtave më të mëdha në nivel lokal", theksoi presidenti i Maqedonisë në deklaratën e tij për MIA-n pas takimit. I pyetur nëse BE, por edhe Maqedonia, pret valë të re emigrantësh përmes rutës së Ballkanit Perëndi-

mor, në të cilën ndodhet edhe shteti i Maqedonisë, presidenti Ivanov theksoi se druajtja tek ne ka qenë në vitin 2015, kur vendi nuk ishte i gatshëm dhe nuk patëm përvojë dhe njohuri për atë që ndodhte. Sipas shefit të shtetit të Maqedonisë, tani në Evropë po hapen ruta të reja, dhe numri më i madh i emigrantëve po shkojnë përmes rrugës tokësore, përmes Bullgarisë në Rumani, ndërsa që atje drejt Hungarisë dhe deri në Gjermani.





Dukuri që shqetëson

# Rritet numri i martesave nën 18 vjet!

**Martesat nën moshën 18 vjet tek romët përfaqësohen me 22 për qind në krahasim me shqiptarët ku janë 6 për qind, ndërsa maqedonasit me 2 për qind, thuhet në raportin e UNICEF-it.**

Shkup, 25 tetor - Nuk janë të pakta martesat midis të miturve nën moshën 18 vjeçare në vendin tonë, derisa kjo dukuri më së shpeshti ndodh tek etniteti rom. Disa nga arsyet janë mungesa e arsimimit, tradita, varfëria, papunësia... Vetëm vitin e kaluar janë martuar mbi 100 femra të moshës nën 18 vjeçe, thonë të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror për Statistikë të Maqedonisë. "Në vitin 2014 janë martuar 13 meshkuj dhe 163 femra të moshës nën 18 vjet. Në 2015 janë martuar 5 meshkuj, ndërsa 135 femra të moshës nën 18 vjet, ndërsa vitin e kaluar - nën moshën 18 vjeçare janë martuar 7 djem dhe 119 femra", thonë për KOHA nga Enti Shtetëror për Statistikë e Maqedonisë. Për momentin, në Maqedoni nuk ka shumë hulumtime që merren më seriozisht me këtë problematikë. Organizata ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve - UNICEF, vitin e kaluar në raportin e saj vjetor mbi gjendjen e arsimimit dhe martesave të hershme, ndërsa sa i përket Maqedonisë - publikoi se më së shpeshti vajzat rome martohen nga



mosha prej 15 deri 19, në krahasim me ato shqiptare dhe maqedonase që janë më të rralla. Martesat e fëmijëve tek romët përfaqësohen me 22 për qind në krahasim me shqiptarët, ku janë 6 për qind ndërsa maqedonasit me 2 për qind, thuhet në raportin e UNICEF-it. Efektet negative të martesës së hershme të vajzave të vogla tashmë janë të njohura. Atyre u mohohen shanset e shkollimit dhe zhvillimit, ndërsa u rriten rreziqet shëndetësore. Sipas të dhënave të organizatës së OKB-ve për fëmijët - UNICEF, në të gjithë botën martohen 15 milionë vajza para moshës 18 vjeçe, madje disa prej tyre sapo kanë mbushur 10 vjeç.

Sipas Ligjit për familje të Maqedonisë, kushtet për realizim të martesës, konkretisht Neni 16 i Ligjit për familjen thotë se Gjyka-

ta kompetente mundet në procedurë jashtëkontestimore të lejojë martesën e personit që ka mbushur 16 vjet vetëm nëse vërtetohet se personi ka arritur pjekuri trupore dhe shpirtërore për kryerjen e të drejtave dhe obligimeve që i sjell martesa, pas marrjes paraprake të mendimit nga Shtëpitë e Shëndetit dhe ndihmës profesionale të Qendrës për Punë Sociale. Në përgjithësi, numri i martesave të lidhura në tremujorin e dytë të këtij viti shënon rritje për 7.8 për qind në krahasim me të njëjtën periudhë nga viti 2016. Në këtë periudhë janë lidhur 3447 martesat, tregojnë të dhënat nga Enti Shtetëror për Statistikë.

Pothuajse dyfish më shumë rritje në periudhën e njëjtë shënojnë edhe divorcet. Në këtë tremujor janë shkëputur 436 martesat,

që sipas ESHS-së - është rritje prej 13.5 për qind në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2016. Gjithashtu, sipas Entit Shtetëror për Statistikë - në tremujorin e dytë të vitit në Maqedoni janë regjistruar për 7.2 për qind më pak fëmijë të lindur të gjallë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Numri i fëmijëve të lindur të gjallë në tremujorin e dytë të këtij viti arrin 5205. Sipas ESHS-së, ulje në periudhën e njëjtë shënon edhe numri i personave të vdekur edhe atë nga 6.1 për qind në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit 2016 dhe arrin 4544 persona, ndërsa prej tyre - 54 janë foshnja të vdekura. Rritja natyrore arrin 661 persona, që do të thotë për aq persona numri i fëmijëve të lindur të gjallë është më i madh nga numri i personave të vdekur. (A.Xh)

## Teste psikologjike për mbrojtjen e shëndetit mental të fëmijëve

Shkup, 25 tetor - Është e domosdoshme ngritja e vetëdijes për rëndësinë e përdorimit të drejtë të testeve psikologjike në Republikën e Maqedonisë në arsimin parashkollor dhe fillor, ndërsa me atë edhe për rëndësinë për parandalimin dhe mbrojtjen e shëndetit mental të fëmijëve. Kjo u theksua në simpoziumin shkencor për standardizimin e testeve psikologjike ndërkombëtare me temë "Përdorimi i testeve psikologjike në sferën e arsimit parashkollor dhe fillor në funksion të zhvillimit të shëndetit mental të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë", që u mbajt dje në Institutin për hulumtime sociologjike dhe politiko - juridike në Shkup. Simpoziumin e organizon laboratorin psikologjik në kuadër të Institutit dhe është pjesë e ciklit të prezantimeve, i cili është quajtur "E mërkura shkencore", dhe i cili zbatohet prej ekzistimit të tij. "Që të mund të flasim për mbrojtjen e shëndetit mental duhet të fillojmë prej mjeteve tona kryesore, ndërsa ato janë testet psikologjike. Për fat të keq nuk kemi teste dhe prandaj e nisëm gjithë këtë proces në një standardizim dhe adaptim kulturor të testeve para testeve ndërkombëtare të cilat përdoren jashtë vendit", theksoi prof. Eleonora Serafimovska e Institutit për hulumtime sociologjike dhe politiko - juridike. Ajo theksoi se në sesionin e dytë psikologët e tyre do të bisedojnë për atë të bëhet një set i tërë i testeve të cilat duhet të shfrytëzohen në arsimin parashkollor dhe fillor. "Roli i psikologëve në shkollë është shumë i rëndësishëm. Psikologët janë mbrojtës të shëndetit mental të nxënësve dhe kuadrit mësimor", tha kryetarja e Odës së Psikologëve të Republikës së Maqedonisë, Mirjana Jovanovska Stojanovska. Ajo sqaroi se në Republikën e Maqedonisë nuk ekzistojnë mjetet të standardizuara të cilat do t'i shfrytëzonin psikologët e shkollave. "Kjo gjendje është alarmante. Detyra jonë është t'ua bëjmë me dije organeve kompetente se nevoja e veglave psikologjike dhe standardizimi i tyre është në dobi të parandalimit dhe ruajtjes së shëndetit mental të nxënësve. Duke u kujdesur për shëndetin mental të nxënësve ne kujdesemi për të ardhmen tonë dhe të ardhmen e tyre", shtoi Jovanovska Stojanovska.

## Konferencë "Femicidë - vrasje të grave për shkak të asaj që janë gra"

# Për tre vjet janë vrarë 15 gra për arsyt e vetme që janë gra

"Nga viti 2013 deri në vitin 2016 kemi regjistruar 15 vrasje, por kjo nuk është statistikë zyrtare dhe nuk e paraqet numrin real. Nga Enti shtetëror për statistikë ka të dhëna dhe nga viti 2008 deri në vitin 2016 ka 70 gra të vrara, por tani bëhet analizë sa nga vrasjet janë femicidë. Viktimat gra janë të moshave të ndryshme", informoi Dimushevska



Shkup, 25 tetor - Nga viti 2013 deri në vitin 2016, në Maqedoni, jozyrtarisht, janë regjistruar 15 vrasje të grave të njohura si "femicidë", gjegjësisht vrasje të qëllimshme të grave vetëm pse janë gra. Kjo të martën u theksua në konferencën "Femicidë

- vrasje të grave për shkak të asaj që janë gra" në organizim të Rrjetit ndërkombëtare kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në bashkëpunim me KB-në. Femicidë është forma më e rëndë e dhunës ndaj grave dhe mund të jetë pasojë e

drejtëpërdrejtë e dhunës familjare ose dhunës intime mes partnerëve. Drejtoresha ekzekutive e Rrjetit ndërkombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare Elena Dimushevska theksoi se në Maqedoni femicidë nuk është rregulluar si

vepër e veçantë penale dhe se shqetësues është që nuk ka statistikë zyrtare të femicidit ose vrasjeve të grave në nivel nacional. "Nga viti 2013 deri në vitin 2016 kemi regjistruar 15 vrasje, por kjo nuk është statistikë zyrtare dhe nuk e paraqet numrin real.

Nga Enti shtetëror për statistikë ka të dhëna dhe nga viti 2008 deri në vitin 2016 ka 70 gra të vrara, por tani bëhet analizë sa nga vrasjet janë femicidë. Viktimat gra janë të moshave të ndryshme", informoi Dimushevska. Sipas saj, gratë të cilat janë viktimat të femicidit paraprakisht ishin viktimat të dhunës, por ishin edhe pak të informuara për paraqitje në institucione adekuate. Koordinatorja e përhershme e KB-së dhe përfaqësues e përhershme e UNDP-së Luiza Uinton tha se pas çdo vrasjeje ka një histori të gjatë të njerëzve të cilat kanë ditur diçka, por nuk kanë vepruar. Në të gjitha rastet ekziston obligim përmes të drejtës obligative që të ndërmerret aksion që të mbrohet viktimat potenciale. Porositi se më me rëndësi për Maqedoninë është që të ratifikohet Konventa e Stambollit. Virve Vimpari nga Delegacioni i BE-së tha se femicidë është një lloj i diskriminimit dhe se është arsye dhe pasojë e pabarazisë gjinore. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale Svetlana Cvetkovska tha se te ne ende ndodh që të moralizohet këto ngjarje, të akuzohen gratë se vetë janë fajtoresh për atë që ka ndodhur, se ata e kanë provokuar përdhunuesin dhe se vetë janë fajtoresh për pasojat. Informoi se për këtë qëllim është formuar grup punues nga shumë përfaqësues nga institucionet ndërdikasteriale, por e dhe se janë të përfshira edhe organizatat joqeveritare. Cvetkovska tha se në MPPS, intensivisht punohet edhe në hapjen e Qendrës për viktimat të dhunës seksuale. (A.Xh)





Sipas të dhënave të prezantuara, në sistemin e gjykatave në Maqedoni, është i punësuar vetëm një gjykatës rom dhe asnjë prokuror, respektivisht nëpër gjykatat e vendit duhet të punësohet minimum 16 gjykatës dhe 18 prokurorë të komunitetit rom

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 25 tetor - Pjesa dërmuese e komunitetit rom në Maqedoni, gjatë procedurave penale pranë gjykatave themelore në vendin tonë, pothuajse fare nuk kanë përfaqësues ligjore (avokat). Njëherësh, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike, ata nuk kanë mundësi t'i sigurojnë dëshmitë dhe provat e mjaftueshme për procedurat gjyqësore që zhvillohen kundër tyre. Këto konstatime janë publikuar në analizën e fundit të Qendrës për hulumtime dhe analiza juridike, me titull "Pozita e komuniteti rom në procedurat penale", ku mes tjerash thuhet se institucionet ndaj kësaj pjesë të shoqërisë, duhet të kenë trajtim të posaçëm, me theks të veçantë kur bëhet fjalë për ndihmën juridike.

"Diskriminimi ndaj romëve mund të haset në veprimet e policisë, me çka ekziston zbrazëti e madhe e hetimeve serioze-efikase, për pretendimet e brutalitetit policor. Nga numri i përgjithshëm i aktgjykimeve të cilat Gjykata Evropiane i ka miratuar kundër Republikës së Maqedonisë, në të cilët është konstatuar mungesa e hetimeve efikase dhe efektive të Prokurorisë, pothuajse 50 për qind prej këtyre aktgjykimeve i

Pozita e romëve në procedurat penale

# Romët s'i njeh as drejtësia



dedikohen romëve, të cilët në masë të madhe janë ankuar për tejkalimin e kompetencave nga policia dhe përdorimi i tepruar i forcës", thuhet në njërën prej shumë konstatime të kësaj Analize juridike.

Gjatë prezantimit të analizës, përfaqësuesi i Qendrës për hulumtime dhe analiza juridike, Oliver Mitov, profesoresha e të Drejtës procedurale penale, Gordana Lazhettiq Buzharovska dhe avokatja Allma Mustafovska Salimovska, thanë se në instanca gjyqësore parimi i përfaqësimit të drejtë, kur është fjalë të romët është tejet i ulët, por mos të thënë diskriminues. Sipas këtyre të dhënave, në sistemin e gjykatave në

Maqedoni, është i punësuar vetëm një gjykatës rom dhe asnjë prokuror, respektivisht nëpër gjykatat e vendit duhet të punësohet minimum 16 gjykatës dhe 18 prokurorë. Me qëllim mënjanimin e këtyre shkeljeve, nga Qendra për hulumtime dhe analiza juridike, rekomandojnë që diskriminimet e natyrave të ndryshme pranë gjykatave të vendit, kur bëhet fjalë për persona nga komuniteti rom mund të detektohet vetëm me monitorimin e procedurave paraprak dhe atyre gjyqësore. Ndërkohë, në analizën e prezantuar të mërkurën, propozohet përmirësimi i mekanizmeve për pranimin e

ndihmës falas juridike, respektivisht rekomandohet që këtij komuniteti t'i lehtësohet qasja deri te ndihma falas juridike, si dhe mundësimi i përkthimit në gjuhën amë gjatë kohës kur ata përballen me procedura gjyqësore. Ndryshe, duke e respektuar parimin e barazisë, me qëllim arritjen e mbrojtjes efikase nga diskriminimi, në analizë "Pozita e romë në procedura penale", rekomandohet nisja e një procesi të edukimit dhe vetëdijesimit të nëpunësve policor, prokurorëve publik, punëtorëve social, por jo edhe të gjykatësve, gjatë rasteve kur ata të ballafaqohen me pjesëtarë të këtij komuniteti.

Kronikë

## Plaçkitet banesa ku jetonin studentë

Të martën mbrëma mes orës 18 dhe 19 persona të panjohur kanë kryer vjedhje të rëndë në një banesë në rrugën e Ilindenit, në Tetovë ku kanë qëndruar student nga Struga dhe Dibra. Pasi që me forcë kanë hapur derën hyrëse, ata nga brendia kanë marrë tre llap-top, dy prej të cilëve kanë qenë të struganëve dhe një e studentit nga Dibra. Pasi që kanë marrë të tre llaptopët, të pavërejtur nga askush e kanë lëshuar banesën duke përfutur në mënyrë të paligjshme diku rreth 18 mijë denarë. Gjatë vjedhjes, hajnat kanë shkaktuar edhe dëm material rreth 1000 denarë. Është kryer hetim dhe punohet në zbardhjen e plotë të kësaj vjedhje.

## Pesë të lënduar në 10 aksidente në Shkup

Pesë persona janë lënduar më lehtë në pesë nga gjithsej 10 aksidente që kanë ndodhur gjatë 24 orëve në rajonin e Shkupit. Në pesë të tjerat është shkaktuar vetëm dëm material. Siç informon MPB, gjatë ditës së djeshme policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të shkeljeve. Nga trafiku janë përjashtuar një person i cili e ka drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 11 shoferë e kanë drejtuar automjetin para se të marrin të drejtën e drejtimit të automjetit, 12 persona e kanë drejtuar automjetin me vlefshmëri të lejes së qarkullimit, si dhe një person i cili e ka drejtuar automjetin teknikisht të parregullt. Janë sanksionuar edhe nëntë shoferë të cilët nuk e kanë respektuar përkufizimin e shpejtësisë së lëvizjes, një këmbësor ka kaluar në rrugë jashtë kalimit për këmbësorë, si dhe tre shoferë për shkak të renditjes së parregullt. Janë hasur 89 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special "karrotrec" janë larguar 84 automjete.

## Vjedhje në Gostivar

Në periudhën ndërmjet 22 dhe 24 tetorit të këtij viti, persona të panjohur kanë kryer vjedhje në shtëpinë e 50 vjeçarit R.R. përkohësisht i punësuar në Itali. Fillimisht e kanë mënjeluar mburojën prej metali të dritares së bodrumit të shtëpisë që ndodhet në rrugën "Çede Filipovski", në Gostivar, e kanë hapur dritaren, kanë hyrë brenda dhe kanë marrë një Televizor, dhe aparate elektrike për ndërtimtari. Gjithsej vlera e kësaj vjedhje është përllogaritur mbi 100 mijë denarë. Poashtu, gjatë vjedhjes është shkaktuar një dëm prej 4000 denarëve.

## Aksident në Pallçisht

Në rrugën regionale Tetovë-Pirok, në Pallçisht të Poshtëm, të martën në mëngjes është regjistruar aksident trafiku. Sipas policisë, janë aksidentuar vetura e tipit Ford Transitz me targa të Tetovës e drejtuar nga 21 vjeçari E.A nga fshati Pirok dhe Reno 5 që e ka drejtuar 60 vjeçari F.R nga Kamjani. Në këtë aksident vozitësi i Reno-s, ka marrë lëndime trupore dhe është dërguar në Spitalin Klinik të Tetovës dhe pas marrjes së ndihmës së parë është lëshuar për mjekim shtëpiak. Sipas informatave të para shkak për këtë aksident ka qenë tejkalimi i parregullt, kurse dëmi është vlerësuar rreth 60 mijë denarë.

## Alpinisti çek vdes afër grykës së Demir Kapisë

Një alpinist çek e ka humbur jetën tek gryka e Demir Kapisë, duke u ngjitur në një shkëmb. Ai ka rënë nga një lartësi prej rreth 20 metra, me ç'rast ka marrë lëndime të rënda trupore. Ministria e Punëve të Brendshme sot konfirmoi se ka ndodhur aksident ku e ka humbur jetën 71 vjeçari S.P. nga Deçini, Republika e Çekisë. Aksidenti është denoncuar dje rreth orës 12 në Stacionin Policor në Negotinë. Ekipi i Stacionit Policor në Negotinë dhe nga ndihma urgjente mjekësore kanë dalë në vendin e ngjarjes ku e kanë konstatuar vdekjen. Shkak për rrëzimin, siç theksohet në kumtesën e policisë, është gabimi personal. Me urdhër të prokurorit publik, trupi i pajetë është dërguar në Institutin për mjekësi ligjore në Shkup për autopsi. (U.H)

## Kosovari deshi ta vrasë bashkëshorten në një hotel në Shkup

Shkup, 25 tetor - Sektori për Punë të Brendshme në Shkup ngriti padi penale kundër I.S. (34) nga Kosova për shkak të ekzistencës së bazës për dyshimin e kryerjes së veprave penale "vrasje në tentativë" dhe "sulm ndaj një zyrtari gjatë kryerjes së veprimtarive të sigurisë". Siç informon MPB, të dielën, më 22 tetor, rreth orës 4:50 në një hotel të vendosur në rrugën "Titoveleshka" në Shkup, i dyshuari u përpoq t'ia merrte jetën gruas së tij N.H. (39) nga Riga, Letoni, pasi që me thikë i ka shkaktuar çarje në zonën e kokës dhe të trupit, si dhe një plagë të shkaktuar nga goditja me thikë në pjesën e majtë të qafës. "Gjatë tentativës për vrasje në dhomë hyri F.Z. (26) nga Shkupi, një punonjës i agjencisë për sigurimin e pronës dhe të personave "NIKOB" i cili ishte thirrur nga punonjësit e hotelit. Pas përpjekjes për ta larguar të denoncuarin nga N.H., F.Z. u sulmua nga ana e tij duke e lënduar me thikë në pjesën e dorës së djathtë", njoftoi MPB. Të denoncuarit i është shqiptuar masë arresti për 30 ditë.

## Emigrantët, problemi i fqinjit është edhe problemi yt

Vjenë, 25 tetor - Kriza emigruese është një sfidë komplekse dhe kërkon përgjigje komplekse, koordinative dhe menaxhuese. Kriza emigruese kërkon sinqeritet, përkushtueshmëri të të gjitha vendeve, në të gjithë komunitetin ndërkombëtar, porositi sekretarja shtetërore në MPB, Magdalean Nestorovka, në Konferencën e Vjenës për partneritet për emigrimin - korniza për emigrim të sigurt dhe të rregullt, në organizim të Qendrës ndërkombëtare për zhvillim të politikave emigruese (ICMPD) e cila u mbajt dje në Vjenë. "Kjo krizë kërkon përkushtueshmëri maksimale të çdo faktori se problemi i fqinjit është edhe problemi yt dhe se asnjë nuk mundet të mbyllet hermetikisht në një kuti qelqi dhe vetëm të vëzhgojë se çfarë ndodh në vendin fqinj, në vendet e tjera. Përkrahja që Republika e Maqedonisë e mori ishte një provim për shumë vende. Provimi që u dha në kufirin tonë, ndërsa e dhanë edhe shumë vende, e dha

Evropa", theksoi Nestorovska. Siç informojnë nga MPB-ja, Nestorovska ishte paneliste në pjesën "Partneriteti për emigracionin dhe bashkëpunimin operativ", vlerësoi se provimi me krizën emigruese është dhënë, por se nuk nënkupton se në të ardhmen nuk do të jepen provime të tilla të ngjashme. Konferenca për Emigracion e Vjenës është evenimenti i sivjetshëm kryesor i ICMPD-së, në të cilin njëkohësisht morën pjesë politikanë, funksionarë të lartë, ekspertë dhe praktikantë, organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare. Në konferencë janë debatuar për konceptin e Partneritetit për emigracionin si aspekt kryesor për ndërtimin e emigracionit të rregullt dhe të sigurt siç është konfirmuar me Deklaratën e Nju-Jorkut në vitin 2016. Në marginat e Konferencës, Nestorovska ka realizuar edhe takim bilateral me drejtorin e përgjithshëm të ICMPD-së, Michael Shpindelger.





Shtetasit e Maqedonisë harxhojnë edhe në vendet e jashtme

# Për 6 muaj, mbi 100 milionë euro

**Nga muaji janarit i vitit 2017 e deri në fund të muajit qershor, përmes kartelave kreditore shtetasit e Maqedonisë bankomatet e vendeve të huaja kanë tërhequr kesh para duke harxhuar 104 milion euro për blerje të mallrave të ndryshme nëpër butikë apo shitore**

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 25 tetor - Përveç kompanive të huaja që një pjesë të fitimit në tregun Maqedonisë e dërgojnë si dividendë aksionareve në vendet amë nga ata vijnë, një shumë të madhe të parave që qytetarët e Maqedonisë i kanë nëpër kartelat kreditore, i harxhojnë për blerje të mallrave të ndryshme në vendet e jashtme.

Sipas të dhënave të Bankës Popullore të Maqedonisë, për gjashtë muajt e parë të këtij viti, në emër të dividendës, kompanitë e huaja prezent në Maqedoni, drejt aksionarëve të tyre kanë transferuar 127 milionë euro, ndërsa nga viti 2012 apo 5 vitet e fundit, nga Maqedo-



## NORMA E TVSH-SË NUK DO TË RRIET

Norma e tatimit të vlerës së shtuar nuk do të ndryshohet, deklaruan nga Ministria e Financave për MIA-n. Siç theksojnë nga Ministria lidhur me informacione të caktuara të cilat dolën në opinion se është planifikuar rritje e TVSH-së, një gjë e tillë nuk është paraparë në Programin e Qeverisë, e as ndonjëherë është diskutuar. Nga Ministria e Financave thonë se deri në fund të vitit do të hapet debat publik për vendosje eventuale të shkallës progresive për tatimin personal të të ardhurave.

nia, kompanitë e huaja drejt kompanive amë si dividendë kanë transferuar rreth 1 miliard euro. Po ashtu, të dhënat zyrtare

të BPM-së për gjashtë muajt e parë të këtij tregojnë se shtetasit e Maqedonisë, gjatë udhëtimit jashtë vendit, nga llogaritë

e tyre bankare kanë harxhuar 103.9 milionë euro. Nga muaji janarit i vitit 2017 e deri në fund të muajit qershor, përmes kartelave kreditore, shtetasit e Maqedonisë në bankomatet e vendeve të huaja kanë tërhequr kesh para, duke harxhuar 104 milionë euro për blerje të mallrave të ndryshme nëpër butikë apo shitoret e ndryshme.

Në anën tjetër, sipas BPM-së, shtetasit e huaj që kanë vizituar Maqedoninë për periudhën e njëjtë, përmes kartelave të tyre kanë realizuar

transaksione në vlerë të përgjithshme prej 124.3 milionë euro. Të dhënat e fundit zyrtare të BPM-së tregojnë se pjesën më të madhe të parave, shtetasit e Maqedonisë jashtë vendit i kanë tërhequr nga bankomatet, gjë që tregon se me para kesh kanë blerë mallra të ndryshme nëpër butikë apo shitore tjera. Për gjashtë muajt e parë shtetasit e Maqedonisë, kanë blerë mallra të ndryshme me kartela kreditore në vlerë prej 57.2 milionë euro. Gjithashtu nga bankomatet në vendet e jashtme

shtetasit e Maqedonisë për 6 muajt e parë këtij viti kanë tërhequr 11.9 milionë euro. Ndërkohë, qytetarët e Maqedonisë nga muaji janar e deri në fund të muajit qershor të këtij viti, përmes internetit në internet shitoret e shteteve të huaja kanë harxhuar rreth 40 milionë euro dhe pjesa më madhe e mallrave të blera janë nga internet shitorja e "Ali Ekspres".

Në anën tjetër, sa i përket harxhimeve të bëra nga vizitorët e huaj që kanë qëndruar në Maqedoni nga janari i këtij viti e deri në fund të muajit qershor, më shumë para kesh kanë tërhequr nëpër bankomatet përmes kartelave kreditore si dhe kanë bërë pazare me kartela kreditore edhe nëpër butikë apo shitore të ndryshme. Kështu, vizitorët e huaj nga bankomatet kanë tërhequr kesh para në vlerë prej 73.9 milionë euro, ndërsa në anën tjetër me kartela kreditore në shitoret dhe butikët kanë harxhuar rreth 50 milionë euro. Sa i përket blerjeve në shitoret e internetit që ofrojnë shërbime në Maqedoni, shtetasit e huaj kanë blerë mallra të ndryshme përmes kartelave të tyre kreditore në vlerë prej 1.4 milionë euro.

**OEMVP mbetet në qëndrimin se Maqedonia duhet ta lërë anash mitin për fuqi të lirë pune, që sa më shpejt ta zbatojë regjistrimin e popullatës dhe të drejtohet fillimisht ndaj uljes së importit para se ta përforcojë eksportin**

Shkup, 25 tetor - Oda Ekonomike e Maqedonisë Veriperëndimore (OEMVP) konsideron se sivjet do ta rrumbullaksojmë me maksimum 0.7 për qind rritje ekonomike, kundrejt vlerësimeve të fundit të Bankës Botërore për rritje prej 1.5 për qind. "Do të jemi tejet të kënaqur nëse Maqedonia e rrumbullakson vitin me rritje ekonomike prej 0,5 deri 0,7 për qind. Konsiderojmë se projektionet prej 1,5 për qind të Bankës Botërore apo 2,5 për qind të Qeverisë assesi nuk mund të arrihen. Në tremujorin e parë rritja ishte zero, në të dytin -1,8 për qind. Që të arrihet rritje prej 2,5 për qind duhet të dy tremujoret të jenë pesë për qind, që nuk ka logjikë", thotë drejtori ekzekutiv i OEMVP-së, Drilon Iseni në bisedë për MIA-n. Iseni dhe drejtori operativ i Odës, Milaim Ameti porosisin, shteti në vend që t'u japë kompanive subvencione për pagën minimale, të mendojë për mbështetje për vendosjen e teknologjive të reja dhe nou-hau që do t'i bëjë financiarisht më të fuqishme dhe

OEMVP kundër parashikimeve të BB-së

## Projeksioni prej 1.5 për qind nuk mund të arrihet



konkurrese, ndërsa trajtimi i njëjtë i investuesve të huaj të dhe vendor të mos jetë vetëm në lidhje me lehtësimet tatimore dhe subvencionet, por edhe në pjesën e infrastrukturës.

OEMVP mbetet në qëndrimin se Maqedonia duhet ta lërë anash mitin për fuqi të lirë pune, që sa më shpejt ta zbatojë regjistrimin e popullatës dhe të drejtohet fillimisht ndaj uljes së importit para se ta përforcojë eksportin. Kyçe për biznesin,

sipas Isenit, edhe më tej janë qasja më e lehtë deri te financat, zhvillimi i barabartë rajonal, sundimi i të drejtës dhe zbatimimi joselektiv i ligjeve. "Anëtarët tona nuk kanë kurrfarë problemi lidhur me zbatimin e Ligjit për pagë minimale sepse pagat që ua japim të punësuarve dukshëm janë më të larta. Ne jemi përkrahës madje edhe të mbështetjet edhe pagën mesatare, të ngritet standardi. Nëse subvencionimi i fir-

mave për sigurimin të pagës minimale është mënyra më e mirë, nuk e dimë. Është e mirë të mendohet nëse subvencionet për firmat janë zgjidhja më e mirë, apo ndoshta duhet të shkohet me mbështetje për vendosjen e teknologjive të reja, makina dhe nou-hau, që do të kontribuonte kompanitë të bëhen financiarisht më të forta, vetë ta mbajnë barrën dhe të jenë më konkurrese", theksojnë Iseni dhe Ameti.

## Peticion kundër Ligjit të ri për duhan

Shkup, 25 tetor - "Prioritet le të jetë shëndeti i qytetarëve", "Ligji i tillë nuk na duhet", "Iniciativë e palogjikshme", "ligji i tanishëm ishte ndër të rrallët që mund ti thuash Ligji i mirë", "Askush nuk ka të drejtë të përfitojë në llogari të shëndetit tim", "Të mos kthehem një hap mbrapa"... Këto janë disa nga komentet që qytetarët i kanë publikuar bashkë me nënshkrimin në peticionin online kundër paralajmërimeve për Ligji të ri për duhan. Peticioni për 15 orë, që kur është publikuar ka grumbulluar 2.700 nënshkrime. "Të mos lejojmë të shembet njëri nga Ligjet e rralla që është për mbrojtjen shëndetësore të njeriut. A thua përfitimi i pak njerëzve vlen sa shëndeti dhe jeta e një njeriu?", thuhet në thirrjen e peticionit online të cilën iniciatori planifikon ta parashtrijë deri tek qeveria. Kundër ligjit është shprehur edhe Ministria e Shëndetësisë, të cilët theksojnë se edhe pse pirja e duhanit është zgjedhje personale, kjo shkakton dëm të madh tek pirja pasive e tij.





Janë plotësuar kriteret kryesore

# Uji i sigurt, por shija e çuditshme

Ende nuk ka ndonjë qëndrim nga ana e Ndërmarrjes Publike Komunale-Tetova-Tetovë lidhur me këtë situatë në rrjetin e ujësjellësit të Tetovës. Por, nga Qendra për Shëndet Publik thonë se ata qytetarë që hezitojnë të konsumojnë ujin, mund të shfrytëzojnë ujë të ambalazhuar

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 25 tetor - Analizat e Qendrës për Shëndet Publik në Tetovë, kanë treguar se uji është i sigurt për pije. Kështu ka thënë Ratko Davidovski, mjek në Shtëpinë e Shëndetit në Tetovë, duke shtuar se këto analiza janë bërë ditën e hënë dhe të martë, pas deoncimeve të qytetarëve se uji mban erë pesticide. Davidovski tha se gjendja e ujit në aspektin teknik dhe mikrobiologjik i plotëson të gjitha kushtet.

"Kemi bërë analiza edhe në qytet brenda, personalisht kam qenë edhe në Kodrën e Diellit dhe në një rezervuar. Po ashtu analiza kam bërë edhe para hyrjes së ujit në rezervuar dhe pas daljes. Edhe në vendet tjera gjithnjë del se uji është i pastër dhe i plotëson kriteret kryesore për t'u konsumuar", tha mjeku Davidovski.

Më tej ai ka shtuar se për të qenë të sigurt në analizat e ujit, ato janë dërguar në



Shkup. "Neve nuk na kanë mjaftuar analizat tona që janë bërë. Ne i kemi dërguar në Shkup dhe presim përgjigje prej atje. Nuk dyshoj se do të ketë ndryshime apo dallime nga analizat tona, por do të presim përgjigjen prej tyre që të jemi më të saktë", tha ai.

Në ndërkohë, nuk ka asnjë sqarim se pse ndodhi kjo me ujin e pijshëm në qytetin e Tetovës. Davidovski thotë se në bazë të analizave uji është i pastër, por ajo se çfarë erë përmban ende nuk është zbuluar, sepse është vështirë që të zbulohet se për çka bëhet fjalë. Ndërkaq, ka reaguar sërish Lëvizja Eco Guerilla, e cila i ka quajtur joserioze deklarata e Shërbimit për informim të Komunës së Tetovës. Në këtë drejtim, Lëvizja Eco Guerilla dënon ashpër deklaratën joserioze dhe nënçmuese të zëdhënësit

të Komunës së Tetovës, ndaj qytetarëve të cilët janë të shqetësuar seriozisht për shkak të cilësisë së ujit të pijshëm, që ditët e fundit mban erë apo shije të çuditshme, si ajo e gazit apo kimikateve.

"Edhe pse nuk është kompetent, zëdhënësi i Komunës së Tetovës, të martën i ka demantuar si të pavërteta këto ankesa të qytetarëve, duke thënë se nuk ka asnjë problem me ujin, edhe pse ankesat e qytetarëve i ka vërtetuar edhe Instituti për Shëndetësi Publike, si institucion i vetëm kompetent. Këtë deklaratë e vlerësojmë si skandaloze, arrogante dhe si tallje me dinjitetin e qytetarëve, për të fshehur faktin se në Tetovë qytetarëve po u mohohet e drejta kushtetuese për ujë të pijshëm. Ndërkaq Instituti për Shëndet Publik vlerëson që uji për pije në Tetovë "ka shi-

je të re, por nuk ka erë". Sipas tyre, uji nuk ndalohet për përdorim, por nuk rekomandohet të pihet", thuhet në reagimin e Lëvizjes Eco Guerilla.

Më tej nga kjo Lëvizje kanë theksuar se presin që të vërtetohen shkaqet për këtë cilësi të ujit në Tetovë. "Këto deklarata kundërtënëse nga Komuna e Tetovës dhe nga Instituti për Shëndet Publik, edhe më shumë hutojnë qytetarët e Tetovës. Kërkojmë edhe një herë nga Komuna e Tetovës, në vend të fushatës parazgjedhore, prioritet të ketë shëndetin e qytetarëve. Ajo që pritet urgjentisht, janë sqarimet e verifikuara shkencërisht, për cilësinë e ujit dhe veprimet që duhet të ndjekin qytetarët e Tetovës", thuhet në reagimin e Lëvizjes Eco Guerilla.

Ditët e fundit uji në Tetovë mban erë të pazakontë si ajo e pesticideve kimike. Kjo dukuri ka ndodhur në shumë lagje të Tetovës, prej nga kanë raportuar se uji mban një erë të rëndë, me ç'rast krahas raportimit në rrjetet sociale, po ashtu ata këtë e kanë raportuar edhe në qendrën për shëndet publik. Përndryshe, ende nuk ka ndonjë qëndrim nga ana e Ndërmarrjes Publike Komunale-Tetova-Tetovë lidhur me këtë situatë në rrjetin e ujësjellësit të Tetovës. Por, nga Qendra për Shëndet Publik thonë se ata qytetarë që hezitojnë të konsumojnë ujin, mund të shfrytëzojnë ujë të ambalazhuar.



## Tetova 10 vjet me Galeri pamore

Tetovë, 25 tetor - Mbrëmjen e 15 tetorit të vitit 2007, Hamami i qytetit të Tetovës u shndërrua në Galeri pamore. Kjo, flaç një donacioni amerikan në kohën kur ambasadore ishte Xhilian Millovanoviç. Prej atëherë kanë kaluar 10 vjet. Në Galerinë e Arteve në Tetovë, është shënuar ky përvjetor në praninë e artistëve dhe funksionarëve shtetërorë. Valmir Aziri, ish drejtor i kësaj galerie dhe aktualisht sekretar Shtetëror në Ministrinë e Kulturës, tha se që në fillim e saj, kjo galeri ka pasur premisa që të shndërrohet në një institucion serioz.

"Është një vend pikëtakimi mes artistëve, është një vend ku vizitorët e jashtëm vijnë për të parë pikturat e artistëve. Kjo galeri është e vendosur në një vend me një histori të gjatë. Ne si ministri do të jemi përkrah kësaj galerie, duke e përkrahur punën e saj dhe mendoj se me këtë ky institucion do të ketë një të ardhme të sigurt", tha Valmir Aziri. Drejtori aktual Afrim Ziberi, tha se deri më tash jemi të kënaqur me punën që është bërë, duke qenë kjo galeri në shërbim të artistëve. "Ne si institucione mendojmë se kemi bërë punë të mira, por edhe mendoj se artistët janë të kënaqur me atë që ne ofrojmë si Galeri e arteve pamore në Tetovë, një institucion i rrallë që është në shërbim të të gjithë artistëve jo vetëm nga Tetova, por edhe më gjerë", tha Ziberi. Përndryshe, deri më tani në Galerinë e arteve pamore në Tetovë, për çdo vit mbahet Kolonia e Artistëve, ndërsa me dhjetëra piktorë ekspozojnë pikturat e tyre para artdashësve tëovarë dhe më gjerë. Ndërkaq, Çifte Hamami i qytetit të Tetovës, i ngritur në shekullin XVI, është i vendosur në bregun e majtë të lumit Shkumbim, përballë Xhamisë së Larme. Çifte Hamami i Tetovës si ndërtim klasik i arkitekturës orientale islameshqiptare, u ndërtua në një vend shumë të përshtatshëm për banorët e asaj kohe, në udhëkryqin që lidhë qytetin me vendbanimet tjera të Pollogut, ndërsa tani më që dhjetë vite i njëjti është transformuar në një galeri për artistët. (u.h.)

## Të dielën mbahet Festivali për fëmijë "Ylberi"

Shkup, 25 tetor - Të dielën në Shkup mbahet edicioni i tetëmbëdhjetë i Festivalit për fëmijë "Ylberi". Do të prezantohen 20 këngë nga fëmijë të moshës deri 13 vjeç. Drejtori i Festivalit, Adem Ymeri, për gazetën KOHA thotë se këtë vit, 10 këngë do të interpretohen nga fëmijë deri në moshën 9 vjet, ndërsa dhjetë të tjera të fëmijëve prej moshës 9 e gjysmë deri 13 vjet. "Festivali 'Ylberi', si tradicionalisht - prezanton 20 këngë të reja për fëmijë e që do të marrin pjesë fëmijë nga gjitha qytetet e Maqedonisë,



tre nga Kosova respektivisht Prishtina, Ferizaj dhe Rahoveci, si dhe tre nga Shqipëria - nga qyteti i Shkodrës, Fushë

Kruja dhe Elbasani. Festivali mbahet më 29 tetor me fillim në orën 17:00 në Teatrin Popullor Maqedonas, me ka-

pacitet për 600 persona. Festivali ka karakter garues. Do të garojnë 10 këngë të fëmijëve deri në moshën 9 vjet, dhe dhjetë të tjera të fëmijëve prej moshës 9 e gjysmë deri 13 vjet. Në fund do të zgjidhet edhe kompozimi më i mirë i festivalit për këtë vit", tha Ymeri. Biletat janë në shitje tek shkolla fillore "Rajko Zhinzifov", në Fushë Tophanë. "Ylberi" është festivali i vetëm shqiptar i këtij lloji në Maqedoni, i cili promovon në mënyrë aktive vlera të mirëfillta fëmijërore përmes artit muzikor.

## UT ndau bursa për studentët e dalluar

Tetovë, 25 tetor - Universiteti i Tetovës në një ceremoni solemne në hapësirat e këtij Universiteti, në bazë të vendimit të senatit ka shpërblyer studentët më të mirë, ekselentët me ndarjen e bursave studimore për sukseset e arritura gjatë studimeve. Bursat për studentët me sukses të dalluar i liron ata nga participimi në ciklin e parë të studimeve për vitin akademik 2017/18.

"Ne të gjithë së bashku, me përkushtim dhe angazhim serioz kemi arritur t'i realizojmë prior-

itetet arsimore dhe shkencore të Universitetit, ndaj, ndarja e bursave për studentët e dalluar e konfirmim se Universiteti ynë identifikohet si institucioni i cilësisë, i mundësive të mëdha për të rinjtë dhe është shndërruar në alternativën më të sigurt për arsimimin e brezave ndër vite. Më lejoni t'ju njoftoj se në përputhje me Ligjin për arsimin e të lartë, Statutin e Universitetit dhe me vendim të Senatit, të miratuar nga Rektori, ne sot do të ndajmë bursat universitare për studentë të ciklit të

parë në vitin akademik 2017/18. Me këtë rast, si Rektori i Universitetit të Tetovës, i përgëzoj ekselentët tanë që i kanë plotësuar kriteret e kërkuara arsimore dhe i kanë fituar bursat universitare në bazë të punës, aftësisë dhe meritës së tyre, dhe njëherit u shpreh mirënjohjen për kontributin që jepni dhe nderin që i bëni Universitetit të Tetovës", tha rektori Ahmeti.

Ai më tej tha se UT-ja në të ardhmen do të përkushtohet në avancimin e cilësisë së këtij universiteti. "Por, mbi

të gjitha, respekt dhe mirënjohje të veçantë për prindërit dhe familjet tuaja, që ju kanë mbështetur në këtë rrugë të suksesshme, sepse pa përkrahjen e tyre një arritje e tillë do ishte e paimagjinuar. Ne drejtuesit e Universitetit jemi të vetëdijshëm se na presin edhe detyra dhe angazhime të shumta, por në kushtet dhe standardet që tashmë funksionojmë, si konsolidimin e frymës së bashkëpunimit profesional mes nesh, zhvillimin e debatit arsimor, promovimin e më të




aftëve, jam i bindur se jo vetëm që do t'ia dalim përballë çdo beteje, por të gjithë së bashku do ta ruajmë dhe do ta lartësojmë këtë Universitet në nivel të universiteteve bashkëkohorë më prestigjiozë", nënvizoi rektori Ahmeti. Studentët të cilët pranuan bursat universitare, në shenjë falënder-

imi për rektorin, familjet e tyre si dhe organet tjera të Universitetit të Tetovës për mbështetjen e dhënë, nënvizuan se këto bursa janë motivim shtesë që ata në të ardhmen të angazhohen edhe më shumë në studimet e tyre, duke bërë krenar veten familjet e tyre si dhe Universitetin.






Ngjarje të veçanta



Aparat e stacionit të Radiotelegrafisë Tiranë



Motorat elektrike dhe tabelat e manevrave të stacionit të radiotelegrafisë Tiranës



# Elbasani, “kyçi i telefonave të Shqipërisë”

Referuar projektit të Nosit, Vlora si qendra e qeverisë do të lidhej me Fierin dhe Fieri më pas do të lidhej me Beratin. Vija telefonike parashikohej të kishte stacione në Berat, Lushnje, Elbasan, Qukës, Starovë dhe Korçë

Pas shpalljes së Pavarësisë në 1912, mjetet e komunikimit telegrafik të trashëguara nga periudha osmane ishin fare të pakta. Linjat telegrafike ishin të shkatërruara si nga përdorimi i tyre i gjatë, ashtu edhe nga pasojat e Luftës së Parë Ballkanike. Në Qeverinë e përkohshme të Ismail Qemalit do të kishte edhe një ministri për Postë Telegrafët, drejtimi i të cilës do t'i besohej Lef Nosit. Personeli drejtues i kësaj ministrie përbëhej nga 5 persona, përfshirë edhe Nosit.

Ky i fundit do të bënte përpjekje për të modernizuar sistemin e komunikimit të brendshëm. E për këtë qëllim, ai do t'i kushtonte rëndësi edhe ndërtimit të një rrjeti komunikimi telefonik të brendshëm. Nosi do të mandatonte Mehmet Rizën, asokohe Inspektor i Postave dhe Telegrafëve që të shkonte në vendet e Europës për të blerë materiale telegrafike dhe postare.

E në fakt, Riza do të kthehej nga ky udhëtim me një seri materialesh të nevojshme për ndërtimin e rrjetit të brendshëm të komunikimit, mes të cilave ishin edhe 40 makina telefonike dhe



Centrali nderlidhës automatik që lidhë telefonat me Bateri lokale me telefonat automatik Tiranë

150 kilometra tel i rëndë, i posaçëm për telefonat.

Një pjesë e këtyre makinerive telefonike do

të përdorreshin nga administrata shtetërore ndërsa një pjesë tjetër do t'i jepet gjandarmërisë.

Në raportimin e organit zyrtar të qeverisë “Përlindja e Shqipërisë” që drejtohej nga Dhimitër

Beratti, jepen edhe detaje se si ministri i Postave Nosi kishte planifikuar të bënte shpërndarjen e makinave telefonike.

Referuar projektit të Nosit, Vlora si qendra e qeverisë do të lidhej me Fierin dhe Fieri më pas do të lidhej me Beratin. Vija telefonike parashikohej të kishte stacione në Berat, Lushnje, Elbasan, Qukës, Starovë dhe Korçë.

Sipas këtij projekti, Elbasani parashikohej të ishte “kyçi i telefonave të Shqipërisë”.

Në këto kohë kur diskutohej ky projekt, Shqipëria edhe rrjetin postar e kishte të organizuar në një mënyrë primitive. Shërbimi i brendshëm i postave funksiononte përmes transportit me kuaj. Ndërkohë, shërbimi postar me jashtë funksiononte vetëm tranzit, ku zyrat postare shqiptare i dorëzonin dërgesat te zyrat e huaja postare që ishin në Shqipëri (italiane

dhe austriake) që prej kohës së Perandorisë Osmane.

Sa i përket komunikimit telegrafik ndërkombëtar, Shqipëria kishte lidhje vetëm përmes Italisë ku ishte në funksion një kablo që lidhte Vlorën me Brindizin e Italisë.

Kohëzgjatja e shkurtër e qeverisë së Vlorës dhe shpërthimi i Luftës së Parë Botërore do të ndërpriste projektin e nisur dhe ato pak komunikacione telegrafike që ishin ndërtuar u prishën. Vetëm pas vitit 1918 do të ndërmerreshin procese për riorganizimin e rrjetit telegrafik e telefonik të vendit. Për këtë qëllim, do të rithirreshin në detyrë funksionarët dhe ekspertët e mëparshëm.

Në vitin 1924 do të çelë shërbimi telegrafik i brendshëm për privatë, i kufizuar deri atëherë vetëm për nevojat shtetërore. Në vitin 1926 u ngrit linja telefonike Durrës-Tiranë me dy linja. Me fondet e buxhetit të shtetit do të bliheshin jashtë pajisje teknologjike dhe do të krijohej Sekcioni Teknik i drejtuar nga një inxhinier elektrik.

Po ashtu, do të shtoheshin linjat e komunikimit telegrafik me Italinë dhe u ngritën 3 stacione radio-telegrafike në Tiranë, Shkodër e Korçë. Stacioni i Tiranës, në vitin 1925, do të ofronte shërbimin e lidhjes direkte me Romën, Beogradin dhe Vjenën.

E sa i përket shërbimit telefonik, në vitet 30 në Tiranë do të shtoheshin 100 numra telefonikë për centralin e zakonshëm dhe 150 numra për centralin automatik. Centrali automatik ishte në përdorim nga administrata tatimore. (scan)





Procesi më i madh gjyqësor, dhe që zgjoi interesimin e masave të gjëra shqiptare, pa dyshim është procesi gjyqësor i At Bernard Llupit, Kolë Parubit, Gjergj Martinit, Marie Shllakut e shumë të tjerëve, që ishin bashkëpunëtorët e ngushtë të prof. Ymer Berishës

Marie Shllaku, shkodrana që u flijua për Kosovën

# Fjalët e fundit: “Kosovë, gjaku im t’u bëftë dritë!”

Bardha NERGJONI

Marie Shllaku mori pjesë në Kuvendin e Drenicës, më 20 janar 1945. Aty mbajti një fjalim të zjarrtë, i cili pati ndikim edhe në pajtimin e dy pri-jësve të Luftës së Drenicës: Shaban Palluzhës dhe Mehmet Gradicës. Maria ishte e lidhur kryesisht me shqiptarë të besimit mysliman, natyrisht jo për shkak të fesë, apo për ndonjë shkak tjetër, por pikërisht se ishte një atdhetare e shquar, e dinte se shpëtimi i kombit mund të vinte vetëm po qe se do të bashkoheshin të gjithë shqiptarët, pavarësisht nga feja dhe ndarja krahinore. Marie Shllaku, vajzë e re shqiptare, pati fatin të gjendej midis burrash të mëdhenj të kombit shqiptar dhe veçanërisht midis burrash dhe luftëtarësh të mirënjohur shkodranë, ndër të cilët ishin edhe i madhi At Gjergj Fishta, Bernard Llupi, etj. Marie Shllaku, ndonëse shumë e re në moshë, vetëm 20-vjeçare, ishte studente dhe përbënte rast të rrallë për femrat shqiptare të asaj kohe. Ajo u angazhua me tërë qenien e saj, me të gjitha forcat dhe me tërë potencialin që kishte u përpoq ta vinte në jetë idealin e lartë të bashkimit kombëtar të të gjitha trojeve etnike, pavarësisht se në ç’kushte, apo në ç’rrethana do të arrihej ajo; sepse kryesorja qe dhe mbeti aritja e këtij qëllimi jashtëzakonisht të lartë, e këtij qëllimi të shenjtë kombëtar, për çka u derdh kaq shumë gjak, deri edhe vetë gjaku i Marie Shllakut. Marie Shllaku e vazhdoi rrugën madhështore të luftës për atdhe dhe për çlirim kombëtar, rrugën e atyre burrave shkodranë, siç ishte Hamzë Kazazi, i cili luftoi kundër pashallarëve të Turqisë dhe Oso Kuka, që luftoi në trojet e Vraninës kundër cubave të Cetinës.

Në luftën për çlirimin e atdheut nga ripushtimi sllavo-komunist Marie Shllaku u gjend edhe në Drenicën legjendare, ku dy dekada më parë luftoi dhe qëndroi për dymbëdhjetë vjet me radhë heroina e popullit, Shote Galica (1895-1937). Po kështu, edhe pse ishin kohë të turbullta, ato kohë kur doli kundër tradhtisë serbosllave heroi Shaban Palluzha, Maria, pa kurrfarë hamendjeje, që në ditët e para doli në anën e tij dhe e përkrahu deri në fund me gjithë ç’pati, duke u bërë krah përpjekjeve vigane të fundit të luftës antifashiste, që të hiqej



qafesh njëherë e përgjithmonë zgjedha sllave. Marie Shllaku është e lindur në Shkodër më 22 tetor 1922, nga babai Marku dhe e ëma Dila. Prindërit i kishin kushtuar kujdes të madh shkollimit të Marisë. Në sajë të përkujdesjes së drejtpërdrejtë të atdhetarit At Gjergj Fishta, i njohur si shkrimtar me orientime patriotike, Maria kishte mësuar mirë historinë shqiptare, fliste pa gabim gjermanisht, italisht, frëngjisht, latinisht si dhe gjuhën e vjetër greke. Me vështrësi Maria e fliste edhe gjuhën serbo-kroate.

## Heronjtë e Luftës së Kosovës

Marie Shllaku, edhe në momentet më vendimtare, në kohën më tragjike të luftës kundër ripushtimit serbosllav, iu bashkëngjit kraut më atdhetar të asaj kohe, rreth 100 intelektualëve që u angazhuan rezistencën shqiptare të fundit të luftës antifashiste. Ndër këto figura më të ndritura ishin: Shaban Palluzha, prof. Ymer Berisha, At Bernard Llupi, Mehmet Gradica, Gjon Serreqi, Ndue Përlleshi, Ukë Sadiku, Metë Dini, Bajram Sokoli (vëllai i bajraktarit të Uçës), Qazim Bajraktari i Astrazupit, Sadik Lutani, Ajet Gërguri, Ahmet Selaci, Ukshin Kovaqica, Ismail Thaçi, Nuhi Gashi, Hasan Bilalli, Kemal Skënderi, Mulla Idriz Gjilani, Hysen Tërpeza, Kolë Parubi, Luan Gashi, etj., të cilët qëndruan deri në fund të pamposhtur.

Në vend të posaçëm në jetën ilegale dhe në luftën që bëri Maria nëpër trevat e Kosovës zë atdhetari Pjetër

Toma. Maria ishte e lidhur kryesisht me shqiptarë të besimit mysliman, natyrisht jo për shkak të fesë, apo për ndonjë shkak tjetër, por pikërisht se ishte një atdhetare e shquar, e dinte se shpëtimi i kombit mund të vinte vetëm po qe se do të bashkoheshin të gjithë shqiptarët, pavarësisht nga feja dhe ndarja krahinore. Ajo, natyrisht, i kishte të qarta edhe qëllimet përçarëse të serbosllavëve dhe e dinte se po këta ishin edhe burim i të gjitha shpifjeve kundër saj. Prandaj ajo nuk i përfillte ato. Në luftën për pavarësinë kombëtare dhe për bashkimin e trojeve të pushtuara Maria u angazhua në mënyrë të gjithanshme. Duke e parë ngulmimin e saj si studente, me tipare të shquara të atdhetarisë, nacionalist të kohës, Abaz Kupi (Bazi Canit) e angazhoi Marie Shllakun në përpjekje legale për bashkimin kombëtar. Me këtë mision Maria punësohet sekretare e Ilaz Agushit, ministër shqiptar në regjimin italian në Tiranë. Sipas materialeve arkivore, në prill të vitit 1941, Maria njihet me Bernard Llupin, i cili atëkohë ishte drejtor i Shoqërisë “Bijave të Zonjës” me seli në Shkodër, që ishte e lidhur me Vatikanin. Në maj të vitit 1942, Marie Shllaku, me sugjerimin e Idriz Matit, ishte punësuar në ministri në Tiranë, seksioni për rrugë, me detyrën e zëvendëssekretarit. Me të pranuar të një detyre të tillë të rëndësishme edhe nga Gjergj Gjoni, Maria kishte pranuar detyrën të

kontrollonte të gjitha dokumentet, leje sekrete të qeverisë, pastaj ato t’ia lejonte si dokumente dispozitive grupit të Bazit Canit. Këtë detyrë do ta kryente deri më 20 nëntor 1942.

Pas atentatit ndaj Ilaz Agushit, Maria përjashtohet nga puna deri më 25 shkurt 1943, kur do të rrijë e paangazhuar në Shkodër. Ajo, në këtë kohë, lidhet me aleancën angleze, duke shërbyer si korriere në vijën: Tiranë-Shkodër-Romë dhe anasjelltas. Këto punë do t’i realizojë përmes Gjergj Gjoni dhe korrierit të Bazit Canit, Hasan Miftarit. Më 25 shkurt të vitit 1943 Maria punësohet në Prizren. Punësimi i saj këtu ishte sugjerim i Pjetër Tomës, sekretar kryesor e Ministrinë e Financave me seli në Prizren. Me qëllim që të mbulonte si vëzhguese tërë territorin e Kosovës, Marie Shllaku emërohet nëpunëse në Prizren. Në këtë kohë edhe Xhafer Deva i ofron bashkëpunim dhe postin e sekretares së tij personale. Xhafer Deva atëbotë ishte ministër i Punëve të Brendshme në Qeverinë e Rexhep Mitrovicës (1943-1944). Ofertën e pranoi përkohësisht, pas konsultimit me drejtuesit e grupit të Bazit Canit. Nuk dihen rrethanat dhe arsytet pse Maria u tërhoq nga Prizreni në Tiranë dhe sërish u kthye më 9 shtator 1944.

Maria do të deklaronte para gjyqit të OZN-së se ishte antifashiste, por edhe antikomuniste. Më 21 tetor 1944, në fshatin Novoselë, Maria mbajti një fjalim atdhetar. Më 9 nëntor 1944 partizanët hynë në Gjakovë, ndërsa Maria, bashkë me Mehmet Agë Berishën, kaloi në rajonin e Ferizajt, ku qëndroi disa ditë. Në këtë kohë ajo do të udhëtojë nga Ferizaj në Gjilan, pastaj në Prishtinë, ku do të takohet për herë të fundit me Xhafer Devën, me Rexhep Mitrovicën dhe me lider të tjerë, prej të cilëve do të marrë udhëzime për veprime të mëtejshme, që të lidhet me Bernard Llupin në Pejë dhe prej andej të mbante lidhje edhe me Shkodrën dhe me rezistencën që do të drejtohej prej andej. Nga Prishtina transferohet në Pejë, në hotelin “Skënderbeg”. Këtu, sipas instrukcioneve që ia kishte dhënë Komiteti i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, që po vepron me porosinë e Xhafer Devës, merr përsipër organizimin e grupeve të rezistencës në tërë vendin. Këto grupe udhëhiqeshin nga Metë Dina, Adem Shala, Mehmet Gradica dhe Marie Shllaku. Atëkohë rezisten-

ca shqiptare kishte llogaritur në 3000 veta që do të rekrutoheshin në luftë.

Priifti atdhetar Bernard Llupi e lidh Marien me Ndue Përlleshin, kryetar komune në Budisalc të Lugut të Drinit. Aty mbahet një takim me popullatën e kësaj komune, me ç’rast flet Marie Shllaku. Një javë më vonë, më 27 dhjetor 1944, në odë të Ukë Bekës, në fshatin Krushëvë e Madhe, Maria sërish mban një fjalim pranë flamurit kombëtar dhe e thërret popullin shqiptar në kryengritje kundër ripushtimit sllavo-komunist. Gjatë një konfrontimi të luftëtarëve që e përcillnin Marien me ata të OZN-së serbosllave, në Glogjan (të Lugut të Baranit), Maria plagoset, ndërsa Qendra e Komitetit Demokratik Shqiptar, në këto rrethana, do ta vendosë atë në shtëpinë e Pjetër Tomës (më 9 dhjetor 1944), në Dobërdol të Llapushës, ku do të mjekohet për tri javë.

Marie Shllaku mori pjesë në Kuvendin e Drenicës, më 20 janar 1945. Aty mbajti një fjalim të zjarrtë, i cili pati ndikim edhe në pajtimin e dy pri-jësve të Luftës së Drenicës: Shaban Palluzhës dhe Mehmet Gradicës. Ishte në mbledhjen e mbajtur në Livadhet e Hajdinit (Pllaçicë), në fillim të korrikut të vitit 1945, në Kuvendin e Dobërdolit më 4 e 5 gusht 1945, në Grykë të Graçevës në fillim të shtatorit dhe me Çetën e Ukë Sadikut, në Luftën e Çelisë së Siçevës, më 12 shtator 1945, ku mori plagë të rënda. Bashkë me Musli Hotin u drejtua nga Resniku. Musliu nga gjakrrjedhja vdiq, kurse Maria u drejtua nga Açaqevë, ku, me ndihmën e Xhafer Imerit, shkoi në shtëpinë e Hatës (gruaja e Xhemajl Selimit), të cilën e njihje edhe më parë. Kjo grua e mjekoi me barna popullore. Spiunët e hetuan, e lajmëruan OZN-në e Skenderajt dhe e zunë. Pas shumë burgjesh dhe torturash shtazarake të OZN-së serbosllave, në vitin 1946, së bashku me tre shkodranë të tjerë, Gjyqi Ushtarak (prokuror Ali Shukria) e dënoi me vdekje. Në sallën e Gjyqit të Prizrenit Maria brohoriti: “Kosovë, gjaku im t’u bëftë dritë!” -Në odën e Imer Seferit të Turjakës prof. Ymer Berisha ma kishte dhënë një letër që t’ia dërgoja Marie Shllakut në Prizren. Marinë e gjeta duke punuar në një zyrë të Komunës së Prizrenit. Asaj i tregova se kush më kishte dërguar e ajo e mori letrën dhe më falënderoi. Unë u ktheva dhe në Rahovec, e takova prof. Ymer Berishën

dhe i tregova se ia kisha dhënë letrën Marie Shllakut. Edhe Ymeri më falënderoi për punën e bërë.

Unë mora pjesë edhe në gjykimin e Marisë në Prizren, më 11 korrik 1946. Shkuam së bashku me Osman Isuf Kastratin e Turjakës. Në sallë ishte atmosferë e zymtë, plot policë, prokuror Ali Shukria. Maria ishte kryelartë, s’i jepte pesë para se çfarë dënimi do t’i jepnin. Në gjykim ishte edhe Bedri Pejani. Maria sympatrembur u përgjigjej pyetjeve të prokurorit Ali Shukria. I pranonte të gjitha veprat që i kishte bërë. Në një rast ajo tha: -I pranoj të gjitha veprat që i kam bërë, por këtu ka shumë edhe shpifje dhe akuza ndaj meje. Veprat e mira në të mirë të kombit tim i pranoj, edhe nëse ato nuk janë të miat! Kjo e habiti trupin gjykuës. Maria kishte pasur ndikim të drejtpërdrejtë, së bashku me prof. Ymer Berishën, Miftar Bajraktarin, Azem Aruqin dhe personalitete të tjera të shquara të kohës, kur më 13 shkurt të vitit 1945, ia kishin shtrirë dorën e pajtimit njëri-tjetrit komandanti i Forcave të Armatosura Kombëtare Shaban Palluzha dhe togeri Mehmet Gradica. Maria, gjatë këtij solemniteti, mbajti një fjalim të zjarrtë, duke elaboruar lidhur me gjendjen politiko-ushtarake, e cila mbretëronte në të gjitha trojet shqiptare, me theks të posaçëm për tradhtinë e forcave komuniste shqiptare që ua kishin bërë interesave kombëtare, duke lidhur aleanca me popujt sllavo-ortodoksë.

## Dënimi

Procesi më i madh gjyqësor, dhe që zgjoi interesimin e masave të gjëra shqiptare, pa dyshim është procesi gjyqësor i At Bernard Llupit, Kolë Parubit, Gjergj Martinit, Marie Shllakut e shumë të tjerëve, që ishin bashkëpunëtorët e ngushtë të prof. Ymer Berishës. Procesi filloi me 29 qershor 1946, dhe përfundoi me 11 korrik po të njëjtë vit, që do të thotë se zgjati gjithsej 13 ditë pa llogaritur ditët e hetuesisë e të tjera. Prokuror publik i këtij procesi, siç ishte bërë rregull si në çdo proces tjetër ishte Ali Shukria. Procesi u mbajt në Prizren. Me 29 qershor, Prizreni ishte në zi. Para trupit gjykuës të okupuesit, në bankën e zezë u ulën 27 të akuzuar shqiptarë. Ata akuzoheshin vetëm pse kishin dashur vendin e tyre, lirinë dhe një Shqipëri Etnike. Në një pyetje të një hetuesi drejtuar Marie Shllakut, se qe sa kohë ke filluar të merresh me politikë, ajo iu kishte përgjigjur “Po, që herët jam marrë me politikë, në qoftë se mund të quhet politikë dashuria e ime për atdheun, përpjekja ime qysh se di për vete për një Shqipëri Etnike, të bashkuar me pjesët e saja të shpëputura, Kosovën dhe Çamërinë” dhe ja pse u dënua me vdekje Marie Shllaku. (Arena Dardane)





Augustin PALOKAJ

# Miliarderët e transicionit-shembulli “Agrokor” në Kroaci

Edhe pse është bërë anëtare e Bashkimit Evropian para më shumë se katër vjetësh, Kroacia vazhdon të përballet me pasojat e transicionit, procesit të privatizimit dhe të lidhjeve të ngushta të strukturave politike me biznesin, gjyqësorin e pse jo edhe me korrupsionin. Kroacia gjatë procesit të integritimit në BE ka kaluar përmes ndryshimeve rrënjësore. Është dashur të dëshmonte me rezultate konkrete përkushtimin për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, pavarësinë e gjyqësorit, lirinë e mediave dhe lirinë e tregut sipas standardeve që kërkon Bashkimi Evropian. Dhe në këtë rrugë Kroacia është bërë shembull për vendet që në procesin e zgjerimit të BE-së vijjnë pas saj. Pasi kanë kaluar shumë vjet qëkur Kroacia ishte në procesin e përbushjes së kriterëve për anëtarësim në BE, të rikujtojmë se ajo ka dorëzuar në Hagë gjeneralët e saj kryesorë që ishin akuzuar për krime lufte. Ata edhe u liruan pas një procesi të gjatë si të pafajshëm. Pastaj Kroacia është dashur ta godiste krimin e organizuar, duke arrestuar krerët e grupeve kriminale. Kjo nuk ka qenë e lehtë, sepse ata ishin të lidhur edhe me bandat nga vendet e tjera të rajonit. Gjatë kësaj lufte rol të rëndësishëm luajtën edhe mediat. Një botues e

**Afera “Agrokor” në Kroaci, që është sfida më e madhe për këtë shtet që nga lufta atdhetare, po dëshmon se pasojat e transicionit, gjatë së cilit u krijua një klasë e pasuruar përmes procesit të privatizimit, mund të jenë fatale për tërë një shtet**

kishte paguar edhe me jetën e tij angazhimin kundër grupeve të krimit të organizuar, duke vdekur në një shpërthim bombe në automjetin e tij në qendër të Zagrebit. Dhe si kulm i kësaj përpjekjeje për të dëshmuar se askush më në Kroaci nuk është mbi ligjin, ishte akuza dhe arrestimi i ish-kryeministrit Ivo Sanader, pa dyshim njërit prej politikanëve që luajti rolin kryesor në procesin e anëtarësimit të Kroacisë në BE.

Sanader ishte i përkëdheluri i Perëndimit, i kancelares Merkel, i kryeministrave evropianë dhe liderëve të institucioneve të BE-së. Gjatë mandatit të tij Kroacia nisi negociatat e anëtarësimit dhe i përbushu shumicën e kushteve. Si ironi u duk në fund të procesit se edhe arrestimi i tij u duk si një lloj flijimi në altarin e BE-së si dësh-

mi që kërkonte BE-ja se askush në Kroaci nuk është mbi ligjin. Dhe dëshmimi se askush nuk është mbi ligjin është i domosdoshëm për të dëshmuar se procesi i gjyqësorit është i pavarur nga ndikimi i politikës dhe se vetëm atëherë mund të thuhet se ai shtet është shtet i së drejtës. Por, me anëtarësimin e Kroacisë në BE nuk përfundoi lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Këtu bëhet dallimi mes shoqërive të pjekura, shteteve funksionale dhe atyre që nuk janë të tilla. Edhe në Kroacinë e pasanëtarësimit në BE mbeten shumë afera korruptuese. Dhe lufta nuk u ndal, por ajo vazhdon. Sepse ata të cilët janë arrestuar dhe akuzuar kanë mbrojtje ligjore, kanë struktura që u ndihmojnë dhe në shumë raste kanë arritur të ngadalësojnë drejtësinë. Për Kroacinë procedimi i politikanëve të dyshuar për korrupsion dhe krim të organizuar duket se ka qenë një kafshatë e lehtë krahasuar me atë që po ndodh tani. Në kohën kur vërtet në Kroaci asnjë politikan nuk ishte i paprekshëm, mediat pa problem raportonin për politikanët, për kriminelët, por pakkush guxonte të publikonte qoftë edhe ndonjë lajm të keq për familjen Todoriq, për kompaninë “Agrokor”,

kompaninë më të madhe jo vetëm në Kroaci e Ballkan, por në tërë Evropën Juglindore. Jo që nuk raportonin për këtë kompani, por raportonin tepër shpesh për sukseset e saj, për talentin e menaxherëve që udhëhiqnin me sukses këtë gjigant.

“Agrokor” ishte një tregim së pari i thjeshtë i pasurimit përmes transicionit. Nga një kompani e vogël për kultivimin e luleve e krijuar në kohën e komunizmit, familja Todoriq krijoi një konglomerat të madh që vetëm në Kroaci punëson mbi 60 mijë njerëz. Kjo kompani u bë inkubator i politikanëve të ardhshëm (disa menaxherë kompanie hynin në Qeveri) e në të njëjtën kohë ishin strehë kur politikanëve u skadonte mandati dhe gjenin punë me paga të majme në “Agrokor” si këshilltarë. Edhe në Kroaci sukcesi i kësaj kompanie dëshmonte se si në transicion më i rëndësishëm se talenti në biznes apo trashëgimia e pasurisë janë lidhjet politike. Sepse me ndikimin që kishte “Agrokor” siguronte që ligjet t’i përshtatën kompanisë e jo veprimet e kompanisë të jenë sipas ligjit. Kur kishte edhe ndonjë problem politik, që mund të shkactohej me falimentimin e ndonjë kompanie, “Agrokor” i

blinte ato dhe kështu për pushtetin i blinte edhe stabilitetin dhe paqen sociale. Në këtë mënyrë “Agrokor” u bë “tepër i madh për të dështuar”, sepse dështimi kuptohej si një katastrofë për tërë shtetin dhe më gjerë. Pa rezerva politikanët thoshin se “kur kollitet ‘Agrokor’ tërë Kroacinë e zë gripi”. Me ndjenjë të tillë se janë të paprekshëm familja Todoriq, Ivića me dy djemtë, vajzën, dhëndrin, kumbarët dhe të tjerët vazhdonin të rriteshin. Pasi blenë pothuajse gjithçka që ekzistonte në Kroaci, nga agrobiznesi e deri tek kioskat për shitjen e gazetave, ata u shtrinë edhe në rajon duke blerë kompani të mëdha në Serbi dhe në Bosnjë-Hercegovinë. Në fund blenë edhe zinxhirin më të madh të vetëshërbimeve në Slloveni “Merkator”. Për këtë morën borxhe dhe ky borxh u rrit së tepërmi. Derisa mediat në Kroaci dhe politikanët duhej gjithçka të paraqisnin si suksese të “Agrokorit” dhe me këtë edhe të tërë Kroacisë, jashtë shtetit filuan që të dilnin të dhënat se “Agrokorit” po i zvogëlonte rejtungu kreditor, se po e kanë gjithnjë e më të vështirë të gjejnë kredi, sepse kanë problem me likuiditetin. Furnizuesit e “Agrokorit”, kryesisht prodhues të vegjël në

Kroaci, nuk guxonin të ankoheshin pse mallin nuk po ua paguanin as pas gjashtë muajsh, sepse, nëse jo në “Agrokor”, nuk do të kenë ku ta shesin mallin e tyre.

Dhe kur në tregun evropian perëndimor financiar nuk gjen më bu dallenj të kreditojnë një kompani të tillë jolikuide, atëherë kërkohen rrugë të tjera. Kështu Todoriq mori kredi nga banka ruse “Sberbank”, por me kamata marramendëse. Dhe kur u pa se nuk mund të paguanin më kredi, se shteti nuk mund të ndihmonte më, sepse një ndihmë të tillë nuk e lejon Bashkimi Evropian pasi garantohet barazia në garën tregtare, vitrinat e dyqaneve nga konglomerati “Agrokor” filluan të mbeteshin gjysmë të zbrazëta. Ishte e qartë se Kroacia ekonomikisht ndodhej para një goditjeje të rëndë, ndoshta edhe fatale, në momentin kur sapo kishte dalë nga recesioni. Sa është i madh “Agrokorit” për Kroacinë, më së miri e dëshmojnë numrat. Kjo kompani në momentin kur shpërtheu kriza kishte borxh hiç më pak se 6 miliardë euro (tri herë më shumë se buxheti vjetor i Kosovës). Kjo kompani me mbi 60 mijë të punësuar, nga e cila jetojnë edhe qindra e mijëra njerëz të tjerë në zinxhirin prodhues e furnizues, ka



Xheladin MURATI

# Kohë e ndryshimeve: Arsimi nuk mund të mbetet në të kaluarën

Rruga e arsimit asnjëherë nuk duhet të qëndrojë në vend, arsimi i vërtetë është gjithmonë në lëvizje, në kërkim të së resë, të zhvillimit dhe ngritjes. Jetojmë në një kohë, në të cilën ndryshimet janë shumë të shpejta e të papritura, intensive dhe të thella. Njerëzit i perceptojnë këto ndryshime. Ndërsa arsimi mund të jetë në gjendje të lidhë, të sugjeroj, të propozoj ndryshime, por edhe i aftë për të ndryshuar dhe realizuar ndryshimet. Në arsim nuk mund të mbetesh me të kaluarën, por jo çdo

**Mësuesi i arrin objektivat dhe synimet falë punës dhe përkushtimit e përlulësisë. Nxënësit si subjekt apo objekt edukimi dhe si protagonist të procesit mësimor janë shumë më afër tij**

proces arsimor fillon nga e reja, thjesht ai mbindërtohet. Pra, nëpërmes arsimit aspirojmë që të fito-

jmë gjithnjë njohuri të reja, të distancuara nga e kaluara. Objektivat duhet të vihen aq lartë sa të jetë e mundur dhe të përpiqemi gjithnjë të përfitojmë njohuri të reja, të mposhtim rekordet e aritura, apo të mposhtim dijet e paraardhësve tanë, që kanë mësuar e kanë punuar më parë. Mësuesi në këtë kontekst është çelësi që e drejton dhe dozon përbajtjet arsimore dhe ai do të jetë i suksesshëm nëse arrin të përcjellë gjithë talentin që ka në procesin e punës mësimore me nxënësit. Ai

duhet të menaxhon mesimdhënien me nxënësit që nuk është punë e lehtë. Mesimdhënia është një vendtakim, ndikim dhe ndërveprim për të ndryshuar

Mësuesi i arrin objektivat dhe synimet falë punës dhe përkushtimit e përlulësisë. Nxënësit si subjekt apo objekt edukimi dhe si protagonist të procesit mësimor janë shumë më afër tij. Që arsimi mos mbetet në të kaluarën por të shikon përpara mësuesi mbështetet në ambiciet e tij dhe të nxënësve. Ambi-

ciet e tij? Ambiciet e tij shikojnë përpara, pjesa e kaluar duhet të ketë qenë shumë e mire, që paraqet përvojë progresive për arsim modern. Mësuesi duhet të ketë dëshirë për punë e nxënësit uri për të vazhduar marrjen e diturive. Sot arsimi është në vështirësi të mëdha dhe në pritje të mëdha. Njerëzimi është larguar nga dinjteti i tij natyror, nga qëllimi i tij. Kur dikujt i dështon qëllimi, arrin rezultate të padëshirueshme. Kjo mbase arsimi duhet të jetë në favor të njeriut,

paqes e shoqërisë, ai duhet të ofroj dituri moderne, njeriu duhet të jetë në qendër të tij. Arsimi duhet t’u përshtatet kërkesave të reja, atyre që promovojnë ardhmërinë. Për këtë arsye arsimi duhet të jetë gjithnjë në hap me kohën dhe ai mban përgjegjësi për dy arsye: së pari, duhet të zgjedh rrugë në favor të një të nesërme, dhe së dyti, të sugjeroj veprime dhe vendimmarrje bashkëkohore.

Koha është për ndryshime ndërsa arsimi duhet të ofroj dhe sfida



garkullim vjetor sa 17 për qind të bruto prodhimit vendor të Kroacisë, pra pothuajse sa edhe e tërë industria e turizmit.

Një krizë e madhe e "Agrokorit", në prag të një sezoni turistik më të madh në histori, frika nga humbja e mijëra vendeve të punës, bëri që Qeveria e Kroacisë të miratonte me shpejtësi një ligj të posaçëm për kompanitë me interes strategjik për vendin. Në bazë të këtij ligji, që mori emërtimin "Lex Agrokori", me pajtimin e menaxhmentit dhe pronarit, shteti vendosi udhëheqjen e re në kompani, e cila tash vazhdon procesin e ristrukturimit të "Agrokorit". Bashkimi Evropian me kujdes vëzhgon zhvillimet në "Agrokori" dhe pret që procesi i ristrukturimit të jetë gradual dhe nën kontroll. Në rast se vazhdon në mënyrë të rregullt ndikimi negativ në ekonominë e Kroacisë, do të jetë i kufizuar. Por, në rast se do të ndodhin tërmete dhe falimentime të pakontrolluara, atëherë ndikimi në ekonominë e Kroacisë do të jetë fatal. Qeveria kroate aktualisht mburret me mënyrën se si e ka parandaluar një katastrofë ekonomike, ka shpëtuar sezonin turistik (vërtet sikur të falimentonte "Agrokori" as turistët nuk do të kishin ku të blinin gjëra gjatë qëndrimit në Kroaci) dhe ka krijuar kushte për ristrukturim, i cili do të përfundojë me marrëveshje mes kreditorëve dhe disa segmenteve të kompanisë, shumë prej të cilave janë në gjendje të këndellen. Dhe kur në "Agrokori" erdhi një udhëheqje e vendosur nga shteti ata zbuluan shumë gjëra. Auditimet e pavarura edhe më shumë. Doli

në shesh se në këtë kompani me vite janë falsifikuar raportet dhe bilancet financiare, janë mashtruar në këtë mënyrë edhe kreditorët edhe aksionarët. Nga kompania janë nxjerrë përmes makinacioneve të ndryshme miliona euro që kanë përfunduar nëpër kontot private të pronarëve. Dhe si pasojë u akuzuan hiç më pak se 15 menaxherë kryesorë të kësaj kompanie, përfshirë edhe Ivica Todoriqin, presidentin e kompanisë, i cili është në arrati, porosi se do të mbrohet dhe akuzat ndaj tij i quan "proces të montuar politik".

Menaxherët e tjerë, për të cilët me vite mediat raportonin se janë "më të mirët", "më të talentuarit" dhe merrnin edhe shpërblime, tash mbrohen duke thënë se "nuk kanë lidhje me financat", se ata "nuk i kuptojnë fare raportet financiare" dhe nuk i kanë lexuar asnjëherë. E Ivica Todoriq është bërë vërtet objekt i sulmeve të paskrupullta të mediave, të njëjtave që deri vonë i thurnin lavde për kapacitetet e tij si lider i madh. Tash të njëjtat shkruajnë se ai po ikën nga drejtësia me ndihmën e një biznesmeni nga Serbia, Mishkoviq, se strehohet në Londër, në vilat e Mishkoviqit, apo është në jug të Zvicrës.

Afera "Agrokori" në Kroaci, që është sfida më e madhe për këtë shtet që nga lufta atdhetare, po dëshmon se pasojat e transicionit, gjatë së cilit u krijua një klasë e pasuruar përmes procesit të privatizimit, mund të jenë fatale për tërë një shtet. Monopoli i "Agrokorit", kompanisë më të madhe në tërë Evropën Juglindore, duhet të shërbejë

edhe për vendet e tjera të rajonit që të mos lejohet që një ekonomi e një shteti të varet aq shumë nga një kompani, një familje apo edhe një person. Ivica Todoriq, njeri deri tash i paprekur dhe i përkëdhelur, është tash i arratisuri numër 1 në Kroaci. Por përndjekja gjyqësore dhe procesi në gjykata që do të zgjasin disa vjet, sepse është më i madhi në histori për nga volumi i materialeve, nuk kënaq opinionin kroat. Kërkohej që të bëhen hetime përmes një komisioni parlamentar që do të punonte në mënyrë transparente edhe për lidhjet e Todoriqit dhe "Agrokorit" me të gjitha qeveritë e deritashme në Kroaci, sepse pakkush beson se "Agrokori" ka mundur të bëjë aq i madh pa ndihmën e politikanëve. Dhe ndaj hetimeve të tilla ka më shumë rezistenca nga strukturat politike sesa ndaj proceseve gjyqësore.

Kur sheh rastin e "Agrokorit" dikush mund të thotë se "ja edhe në vendet e BE-së ka korrupsion". Por edhe ky rast dëshmon se dallimi mes këtyre vendeve, ku funksionon ligji, dhe atyre në Ballkan, ku shumë shtete kanë një gjyqësor të kapur nga krimi dhe politika është se çfarë ndodh kur zbulohet. Dhe këtu jo vetëm gjyqësori, por edhe shoqëria në Kroaci dëshmon se është më e pjekur sesa në vendet e Ballkanit Perëndimor që duan ta ndjekin rrugën e Kroacisë për t'u bërë një ditë anëtare e Bashkimit Evropian. E pikërisht kompanitë si "Agrokori" dhe biznesmenët që krijojnë monopol falë lidhjeve politike, janë humbësit më të mëdhenj të anëtarësimit në BE. (koha.net)

## Departamenti amerikan i Shtetit drejtohet si ndërmarrje biznesi



Zahir JANMOHAMED

Për një njeri në prag të humbjes së punës dhe të fajësuar për gërryerjen e fuqisë së diplomacisë amerikane, sekretari amerikan i Shtetit, Rex Tillerson ka ende humorin për të bërë shaka. Gjatë një fjalimi të fundit në Uashington, D.C përpara turit aziatik, Tillerson u uroi të gjithëve "Gëzuar Divalin", një festival hindu që shpesh shënohet me fishkëzjarre, dhe më pas e plotësoi: "Nuk kam nevojë për fishkëzjarrë. Kam shumë të tilla që shpërthejnë rreth meje, që tani". Të gjithë qeshën, përfshirë edhe vetë Tillersonin, dhe për një arsye të mirë. Është një mjaft e lehtë të gesh anë humoristike në parashtrimin e Tillerson. Ai është akuzuar se e ka quajtur presidentin Trump "hajvan" – diçka që nuk e ka mohuar. Kreu republikan i Komitetit të jashtëm të Senatit, Bob Corker, e ka akuzuar Trump se e ka "tredhur" Tillersonin, një akuzë që nxiti menjëherë sekretarin e Shtetit të deklarojë në televizionin kombëtar: "Kontrollova. Jam tërësisht në rregull". Për ata që mbajnë shënime, ai është emëruari i dytë i Trump që i është referuar anatomisë mashkullore për të mbrojtur rolin e tij në qeveri. Sidoqoftë, mjaft të zhveshin spektaklin e mbajtjes së shkurtër të detyrës nga ana e Tillerson dhe del një panoramë e një administrate Trump që po zgërfaq Departamentin e Shtetit, duke vënë në sfidë edhe arsyen e ekzistencës së saj, duke lënë mënjanë ekspertët e politikës së jashtme në favor të drejtuesve ekzekutivë dhe duke ripërcaktuar qasjet diplomatike që do të duan vite të tëra të zhbëhen, edhe nëse Tillerson largohet. Burime të afërta me Tillerson thonë se ai nuk do të mbijetojë në detyrë pas janarit 2018. Madje, nëse ai largohet më shpejt, dëmi është bërë. Në shtator, Tillerson njoftoi planet për të krasitur buxhetin e Departamentit të Shtetit me afërsisht 30 për qind dhe reduktimin e 1300 vendeve të punës nga shërbimi civil. Tillerson dëshironte të hiqte edhe më shumë pozicione por ai mësoi se nuk mund të pushonte punonjësit qeveritarë me kaq lehtësi.

Në vend të kësaj, ai vendosi të mbajë vakante disa pozicione, si p.sh i dërguari special për monitorimin dhe luftën anti-semitizmit – ashtu si edhe gjysmën e pozicioneve të kësaj kategorie. Pozicione të tjera që mbeten bosh: ambasadori amerikan në Korenë e Jugut – një gjë e çuditshme, duke qenë se Shtetet e Bashkuara dhe Koreja e Veriut mund të nisin luftën. Sot, zyrat brenda Departamentit të Shtetit që shkruajnë raportet kritike për të drejtat e njeriut, liritë fetare, të drejtat e komuniteteve dhe krimet e luftës janë veçse hije të asaj që ishin dikur ose janë mbyllur fare, që do të thotë se avokatët dhe aktivistët e të drejtave të njeriut që mbështeten tek këto byro do të kenë shumë vështirësi në mbrojtjen e komuniteteve vulnerabël. Por, Trump nuk është vërtet i interesuar për Departamentin e Shtetit, nëse ai funksionon apo ia del mirë. Ai dëshiron një Depar-

**Në shtator, Tillerson njoftoi planet për të krasitur buxhetin e Departamentit të Shtetit me afërsisht 30 për qind dhe reduktimin e 1300 vendeve të punës nga shërbimi civil**

tament Shteti, kultura e të cilit është ripërcaktuar dhe fuqia e të cilit është zvogëluar kështu që ai të mund të krahasojë rëndësinë e vet – dhe të vazjë së tij, Ivanka e dhëndrit Jared Kushner. Merrni për shembull, çështjen e kujtesës institucionale brenda komunitetit diplomatik amerikan. Departamenti i Shtetit funksionon mbi trashëgiminë apo traditën – njerëzit që mbartin të shkuarën janë nga administrata të mëparshme të të dyja partive. Ata janë ende aty për të siguruar që politikë amerikane të kenë vijueshmëri. Sidoqoftë, ekipi Trump u tha diplomatëve të mos kenë kontakt me ekipin e Obamës. Kjo është sikur të blesh një dyqan mjetesh dhe të mbyllësh veshët kur pronari i mëparshëm përpiqet të të ofrojë këshilla për ta mbajtur të sigurt vendin që ke në zotërim. Është e habitshme: Trump e ka mbushur kabinetin me njerëz që në shumë mënyra do t'u pëlqente t'i shihnin departamentet që drejtojnë të eliminohen. Tillerson nuk është ndryshe. Ai e ka pranuar se madje, nuk e dëshironet detyrën dhe në intervista është ankuar sesa shumë e përçmon Uashingtonin. Medlin Ollbrajt, ish-sekretare amerikane e Shtetit nën presidentin Bill Clinton, së fundmi tha se ajo që e shqetëson atë në lidhje me Tillerson është se ai duket se nuk merr kënaqësi nga puna e tij.

Rezultati është një departament Shteti në pikën e vet më të dobët në vite. Gjatë administratës së Xhorxh Bushit, Departamenti i Shtetit u anashkalua në favor të departamentit të Mbrojtjes, që drejtonte diplomacinë kur SHBA luftonin në Irak. Por, Bushi asnjëherë nuk e cenoi departamentin e Shtetit duke shkruar në Twitter apo e mbajtur atë jashtë takimeve për politikën e jashtme, si raportohet të ketë bërë Trump me ekipin e Tillerson. Pas së gjithash, Trump duket se vë në dyshim përse ai duhet të ketë nevojë për një aparat të kushtueshëm si departamenti i Shtetit, kur mund të dërgojë mendimet e veta drejt "Njeriut të vogël raketë" të Koresë së Veriut drejtpërdrejt nga Twitteri. Unë kam punuar për një projekt të Departamentit të Shtetit në fillim të viteve 2000 dhe ndërsa kishte tension në atë kohë midis departamentit të Shtetit dhe Shtëpisë së Bardhë, kurrë nuk kam parë një rrëmujë si kjo që ka krijuar Trump. Tillerson, kam përshtypjen se do të argumentojë se dëshitoi për shkak të Trump. Në disa anë, ai ka të drejtë. Në disa intervista, Tillerson-it i pëlqen të luajë rolin e njeriut të jashtëm, të dikujt që nuk e kupton vërtet Uashington, DC. Kjo mund të jetë e vërtetë. Ai nuk e kupton Uashington, DC. Po a është përpjekur ndonjëherë ta kuptojë? Dhe a ka dashur vërtet Trump ndonjëherë që sekretari i Shtetit ta bënte këtë përpjekje? (tesheshi.com)

(Zahir Janmohamed është redaktori i lajmeve të revistës "Hyphen". Ai ka punuar si ndihmës i lartë për politikën e Jashtme në Kongresin Amerikan dhe drejtor avokacie për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut në Amnesty International)

ndryshime, njeriut t'i ofron shpresë, se diçka do të ndryshojë në të mirë. Sado që ndryshimet sjellin risi, njeriu ndjen emocione të dyfishta, e para, pakënaqësi sado që ndryshimet të jenë pozitive, dhe e dyta, se çdo gjë ndryshon dhe nuk mund të arrihet ajo që dëshiron. Arsimi duhet ta aftëson njeriun për akceptimin e ndryshimeve dhe të risive, pavarësisht se çdo gjë ndryshon, dhe ndryshimet janë relative, se çdo gjë që vjen, mbetet pak dhe shkon. Kjo mbase bota vazhdimisht ndryshon.

Duhet ta pranojmë se edhe përkundrejt faktit që çdo kohë sjell trende të reja, filozofi të re jete, çdo gjeneratë e promovon pikëpamjen e tij mbi jetën, megjithatë disa vlera universale mbeten, si të përhershme që duhet zhvilluar e përsosur siç janë puna, e vërteta, respekti i tjetrit, dashuria. Dituria ndryshon, plotësohet. Prandaj arsimi kërkon risi mbase nuk mund të

mbetesh me të kaluarën. Prandaj arsimit duhet të ndryshojë tërësisht dhe ndryshimet në konceptimin e tij duhet të jenë radikale dhe përmbytësore në disa drejtime, si: reduktimin në maksimum të programeve nga elementet tradicionale me natyrë ideologjike e historike, ndryshime nga forma dhe organizimi, ndryshime në strukturë dhe përmbytje e të ngjashme.

Çdo gjë që ndodh, ndodh në kohë të caktuar, në bazë të ligjit të ngritjes dhe rënies. Nëse nuk ndodhin ndryshime nuk mund të presim diçka të mirë nga ardhmëria. Ndryshimet në jetë e gjetiu na vënë para testit madhor: t'i testojmë iluzionet tona, supozimet, ambiciet, por para së gjithash duhet të jemi të vetëdijshëm se i tërë realiteti qëndron në të tashmen dhe këtu, jo në ndonjë vend e kohë që nuk ekziston apo të imagjinuar. Megjithatë diçka ekziston në kokat tona, në mendjet, në en-

drat. Thjesht gjithnjë në jetë diçka humbim që të fitojmë diçka tjetër.

Arsimi sot është shqetësues dhe ka kup-tim vetëm në ndryshimet që bëhen.

Prandaj nuk duhet të harrojmë se ne nuk jemi këtu për shkak të arsim-it por arsimi ekziston për shkak tonin. Arsimit duhet të përcjellë ndryshimet që ndodhin në rrjedhën e kohës dhe ato ndryshime e ngjarje duhet t'i pranojmë nëse kemi caktuar objektiva ku duhet të arrijmë. Në këtë kontekst, arsimi është garë i cili hap shtigje të arritjes, madje arritje të shpejt e të saktë. Për të realizuar një arsim modern i mbështetur në ndryshime duhet vendime, imagjinatë dhe kontroll. Kjo edhe për arsye se arsimi është fushë intriguese dhe mjaftë sfiduese. Edukimi dhe arsimi ofrojnë mundësi të përhershme zhvillimi, janë fusha ku hulumtimet dhe kërkshëria profesionale nuk duhet të mungojnë asnjëherë.





# SHPRESË DHE FRIKË NË RRUGËN

**Refugjatët dhe emigrantët që kanë marrë rrugën e gjatë dhe të rrezikshme drejt Bashkimit Europian, tregojnë jetën e tyre të përditshme të tranzitit për në "tokën e premtuar"**

Pas më shumë se një viti të kaluar në rrugë me bashkëshortën dhe gjashtë fëmijët që prej largimi i tyre nga Siria, Ali ishte vendosur në kampin tranzit të Suboticës në Serbinë veriore. Ata ia kishin dalë të kalonin male dhe detin, por ngecën në Serbi prej mbylljes së rrugës në veri. Aliu dhe familja e tij kishin aplikuar për azil në Hungari dhe pas një pritje prej gjashtë muaj, në fund u përzgjedhën për të kaluar kufirin.

Megjithatë, kjo nuk ndodhi menjëherë pas marrjes së vendimit; ato u transferuan në kampin e refugjatëve në Suboticë dhe pritën rreth dy javë të tjera derisa kaluan kufirin. Në mars të vitit 2017, parlamenti hungarez miratoi një ligj të ri, i kritikuar gjerësisht nga organizatat e të drejtave të njeriut në Europë dhe më gjerë. Ligji lejon ndalimin e njerëzve që



kërkojnë azil në Hungari. Qeveria hungareze filloi të ndërtojë dy kampe me kontenerë të rrethuar nga një gardh me gjemba ku tani strehohen ata që kërkojnë azil në Hungari. Një mëngjes të ngrohtë, pas dy javësh të gjata pritje, Aliu u informua për ditën e nisjes me familjen. Ata do të hynin në territorin hungarez të nesërmen në mëngjes.

Pas drekës, ata morën një taksë në pikën e transitit të Kelebijave në kufi, ku qëndruan gjatë natës dhe pritën të kalonin në Hungari

në orën 8 në mëngjes. Naser Sherida, vëllai i Aliut, shkoi për t'i përcjellë duke shpresuar se në të ardhmen e afërt, ai, gruaja e tij shtatzënë dhe dy fëmijët do të jetë një nga familjet e zgjedhura për të kaluar në anën hungareze dhe të mirëpritët nga vëllai i tij. Mjerisht, bashkimi do të jetë në një kamp të izoluar. Megjithëse nuk e mendonin Hungarinë si një destinacion kur u larguan, ka një mundësi për një jetë normale për fëmijët e tyre, ndryshe nga Siria. Vëllai i

Aliut, Naseri shpreson se së shpejti do të takohen në Hungari në kampin e izoluar. Pasi jetoi për dy vjet nën regjimin e ISIS, Naseri nuk shprehet i zhgënjyer nga kjo perspektivë.

"Është e përkohshme", thotë ai me shpresë.

Ai arsyeton se është gjithsesi një perspektivë më e mirë për të ardhmen e fëmijëve të tij: "Nuk mund të bësh jetë normale në Siri tani. Situata mes dy fraksioneve është aq e tensionuar, sa detyrohesh të mbaja armë dhe të merrja

pjesë në luftime," thotë ai.

Në pikën kufitare Kelebija, Mustafa, një azilkërkuës i ri irakian dhe dy shokë të tij veprojnë si një urë jofor-male komunikimit midis Zyrës Serbe të Migracionit dhe autoriteteve hungareze.

Çdo mëngjes, ata marrin një listë nga autoritetet hungareze me emrat e familjeve ose njerëzve që do të lejohen të kalojnë ditën tjetër.

Ata përgatisin me kujdes një kënd të vogël për të sapoardhurit brenda një ndërtese të braktisur pa energji elektrike ose ujë, që

ndodhet 20 metra nga kalimi. Ushqimi, uji dhe batanijet ofrohen çdo ditë nga agjencia e OKB-së për refugjatët dhe Kryqi i Kuq. Sot Mustafa, i cili u largua nga qyteti i Dohuk në Kurdistanin e Irakut pothuajse dy vjet më parë, do të ketë një surprizë të bukur. Disa anëtarë të familjes së tij, të cilët jetojnë në një kamp në Serbinë veriore, vijnë në Kelebija për të shijuar një darkë me të. Një fuçi e madhe me dru zjarri, një copë e vjetër skare, tre tiganë dhe kuzhina në natyrë është gati







# N BALLKANIKE TË EMIGRANTËVE



për punë. Burrat po gatuan një pulë me oriz dhe sallatë të freskët. Por pavarësisht ambientit familjar dhe ushqimit, 'dhoma e ngrënies' së tyre pasqyron gjendjen ku janë.

Kamionët kalojnë gjithë kohën majtas përtej gardhit me gjemba dhe një zë kërcënues nga një altoparlant bërtet në hungarisht. Midis të qeshurave dhe kujtimeve, nganjëherë biseda pengohet. Mustafa e lidh celularin me interneti dhe fillon të luajë një video të Vitit të Ri kurd të Novruzit, duke u

përpjekur të ngrejë humorin.

Përpjekja për të arritur në tokën e premtuar europiane në rrugë ligjore mund të rezultojë e dhimbshme, depresionuese dhe mund të marrë më gjatë nga sa e mendonin Ali dhe Mustafa.

Por ka gjithnjë një alternativë për ta arritur destinacionin e ëndrrës. Muhamedi, një i ri nga Pakistani, është i bindur për mundësinë e kalimit në mënyrë të paligjshme në Hungari. Për më shumë se katër muaj, ai ka jetuar në një fabrikë të

braktisur në Suboticë. Ai e ndan strehimin me më shumë se 20 shtetas të tjerë pakistanezë, në pritje të kontaktit me një trafikant.

Kur moti është i ngrohtë, Muhamedi dhe shokët e tjerë organizojnë ndeshje kriket. Muhamedi i përshkruan këto momente si një mënyrë për të kujtuar atdheun e tyre dhe për të harruar rrugën e gjatë dhe të dhimbshme përpara. Duke qenë se jeton ilegalisht nuk ka qasje në aktivitetet e ofruara në kampet zyrtare, jeta e përditshme

bëhet më e lodhshme. Çdo ditë, pranë linjës lokale të trenit, organet humanitare si vijnë për të ofruar ndihmë mjekësore, furnizime ushqimore dhe dushe portative. Ndërsa presin, emigrantët përpiqen të jetojnë një jetë normale. Ata e bëjnë ushqimin së bashku, kujdesen për njëri-tjetrin dhe ndajnë punët e përditshme. Një tigan i madh, i mbushur me pulë, patate dhe disa perime, është banketi i tyre. Ka buzëqeshje mes timit të drurit, madje edhe disa shaka dhe të qeshura përpara

vaktit të mbrëmjes. Kur do të kontaktohen nga trafikanti, si i ka rrahur policia hungareze ata dhe shumë e parave që nevojiten për të kaluar kufirin – këto janë vetëm disa nga temat që diskutohen gjatë darkës.

Çaste pas ushqimit, Muhamedi shkon për një shëtitje përgjatë vijës së trenit me shokët e tij, ku tregon rastin kur kaloi kufirin me trafikantë dhe 23 të tjerë por u kap dhe u kthye në Serbi. Sipas Muhamedit, çmimet e trafikantëve janë të negoci-

ueshme (1.000 deri në 1.600 euro për person) pa marrë parasysh sa shumë përpjekje duhen për të kaluar. Paratë i jepen një pale të tretë (një anëtar i familjes në atdhe) dhe në çastin kur klienti mbërrin në destinacion, bëhet transfera në llogarinë bankare të kontrabandistit. Aliu, Mustafa dhe Muhamedi janë vetëm tre shembuj nga rreth 4000 refugjatë dhe emigrantë që janë aktualisht në Serbi dhe ende shpresojnë të arrijnë "tokën e premtuar" të Europës Perëndimore.







Deputeti Deda shpreh mendimin se nuk ka sinjale që ekzekutivi aktual është i përkushtuar ndaj procesit të integritimit evropian. Sipas tij, një gjë e tillë është e dukshme edhe për shkak të mënyrës se si janë ndarë mjetet nga buxheti i Kosovës

**Kryetarja e Komisionit parlamentar për Integritim Evropian, Blerta Deliu-Kodra, thotë se pas zgjedhjeve parlamentare dhe lokale, të cilat u mbajtën në Kosovë, ku vëmendja e partive politike ka qenë tek agjendat elektorale, tashmë pritet një përqendrim më i madh i institucioneve të Kosovës për një dinamikë më të shtuar të procesit të integritimit**

Perspektiva evropiane dhe procesi i integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, në vazhdimësi mbetet pjesë e diskutimit të zyrtarëve të institucioneve të Kosovës, si edhe të zyrtarëve të vetë BE-së, por dinamika e këtij procesi ende nuk i ka përmbyshur zotimet e të dyja palëve lidhur me këtë proces, vlerësojnë deputetët e Kuvendit të Kosovës, të pozitës dhe opozitës. Kryetarja e Komisionit parlamentar për Integritim Evropian, Blerta Deliu-Kodra, deputete e Partisë Demokratike të Kosovës, parti kjo brenda koalicionit qeverisës, thotë për Radion Evropa e Lirë se pas zgjedhjeve parlamentare dhe lokale, të cilat u mbajtën në Kosovë, ku vëmendja e partive politike ka qenë tek agjendat elektorale, tashmë pritet një përqendrim më i madh i institucioneve të Kosovës për një dinamikë më të shtuar të procesit të integritimit. Sipas saj, legjislatura e tashme duhet të punojë shumë që Kosova të përafrohet me legjislacionin e Bashkimit Evropian. "Ligjet, të cilat kërkohen, si dhe ndryshimet ligjore, të jenë në përputhje me direktivat e Bashkimit Evropian, por gjithsesi të jenë në për-



puthje me legjislacionin e Kosovës dhe të kapshme për qytetarët e Republikës së Kosovës. Në anën tjetër, sapo është formuar komisioni i Kuvendit, që do të merret me zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, si njëra prej marrëveshjeve të para kontraktuale ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Grupet parlamentare kanë vendosur për deputetët që do të jenë, në njëfarë forme, gjatë gjithë kohës që ta monitorojnë këtë proces dhe do të shohin se ku janë sfidat dhe çka po bëjnë institucionet që t'i përmbyshin ato kritere që i parasheh kjo marrëveshje", tha Deliu-Kodra. Anëtar tjetër i Komisionit parlamentar për Integritim Evropian, Ilir Deda, deputet opozitar nga Alternativa, e cila është pjesë e grupit parlamentar të Lidhjes

Demokratike të Kosovës, duke folur për Radion Evropa e Lirë, thekson që Kosovës i është premtuar perspektiva evropiane, dhe kjo shfrytëzohet nga Bashkimi Evropian që të evitohet komplikimi nga mosnjohja e shteteve të BE-së. Por, sipas tij, lideri i Kosovës nuk e kupton se çfarë nënkupton perspektiva evropiane dhe Kosova çalon në dinamikën që kërkohet nga integritimi evropian. "Ajo ku Kosova çalon, është zbatimi i obligimeve, të cilat i kemi marrë në këtë proces. Kjo e bën Kosovën më pak kredibile karshi vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe institucioneve të BE-së, sepse ne nuk po i përmbyshim detyrat, të cilat i kemi marrë. Për shembull, konkretisht, sa i përket Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit, e cila është një e

parësore e institucioneve të Kosovës dhe që ne të punojmë që qytetarët e Republikës së Kosovës të lëvizin lirshëm, sepse Kosova është një prej shteteve, që qytetarët e saj nuk e kanë të sigurt lirinë e lëvizjes". Por, deputeti Deda shpreh mendimin se nuk ka sinjale që ekzekutivi aktual është i përkushtuar ndaj procesit të integritimit evropian. Sipas tij, një gjë e tillë është e dukshme edhe për shkak të mënyrës se si janë ndarë mjetet nga buxheti i Kosovës. "Më shumë po del të jetë buxhet për financim të strukturave korruptive dhe buxhet për zhvillim dhe për realizimin e kërkesave nga ana e BE-së. Institucionet e Kosovës arkanë të qartë se cilat janë ato hapa, vendime dhe veprime, të cilat duhet të ndërmerren, që në pranverën e vitit 2018, pasi që të bëhet raporti i ri për Kosovën, të dalë që Kosova është e përkushtuar. Por, ne nuk jemi atje, për shkak të mungesës së dijeve dhe të kuptimit të bartësve institucionale se çka në të vërtetë do të thotë reforma e kërkuar nga ana e BE-së". Deda shton se në rast se Kosova edhe më tej nuk tregon leadership në procesin e integritimit evropian, atëherë Bashkimi Evropian do të shpikë mekanizma apo dokumente të ndryshme, të cilat do ta bëjnë Kosovën të vendnumërojnë në këtë proces.

# Rruga e ngadalshme e Kosovës drejt BE-së



## Të legalizojmë drogat e lehta, Shqipëria burimi kryesor

Prokurori i Përgjithshëm i Antimafias italiane, Franco Roberti, i ka kërkuar zyrtarisht qeverisë që të miratojë legalizimin e drogave të lehta, pasi do të ishte një goditje për klanet kriminale. "I kemi kërkuar Parlamentit dhe Qeverisë një zgjedhje, që mund të jetë legalizimi i drogave të lehta. Kemi vënë në dispozicion të gjitha burimet tona për të luftuar trafikimin e drogave të lehta, ose t'i japim shtetit monopolin e prodhimit e shitjes së drogave të lehta, duke njohur mungesën e vlerës morale të përdoruesit të saj. Por, qëllimi i një ligji është që të mposhten fuqitë kriminale në mënyrë që të mos jenë më së bashku", ka thënë Franco Roberti i ftuar në kongresin vjetor të Organizatës Kombëtare të gjyqtarëve italianë. Roberti ndër të tjera tha se "drogat e lehta kanë pushtuar vendin, duke shkakuar viktima siç ndodhi në San Marco in Lamis, në provincën e Foxhias, e rrjedhë e trafikut të drogave të lehta nga Shqipëria", shkruajnë mediat italiane. Ai tha se, është zvogëluar sasia e drogave të forta në treg italian, por furnizimi i drogave të lehta është rritur në mënyrë eksponenciale, pavarësisht përpjekjeve. Kjo është arsyeja pse ne i kërkojmë Shtetit të marrë një vendim. Sipas tij, shteti duhet të prodhojë e shes drogë të lehta të cilësisë më të mirë e me çmime më konkurruese se ato të trafikuar nga klanet kriminale.

## Pse Kosova s'duhet të jetë në preambulën e Kushtetutës së Serbisë?

Presidenti i Lëvizjes Evropiane në Serbi prof. Mihailo Crnobraj, është i bindur se ndryshimet e ardhshme në Kushtetutën e Serbisë kanë që për qëllim konsolidimin e sistemit juridik, janë të rëndësishme për perspektivën evropiane. Në këtë kontekst, Crnobraj tha se sh-

preson që Kushtetuta nuk do të lërë preambulën që thotë se Kosova dhe Metohia janë pjesë integrale e Serbisë, shkruan Blic serb. "Kjo nuk është legale, por një çështje politike. Unë shpresoj se nuk do të ndodhë që të vazhdojmë ta mbajmë preambulën dhe se në fakt preambula

është lidhja e vetëm me praninë tonë në Kosovë", ka thënë ai. Kushtetuta e Serbisë nuk ndryshon, tha ai, për të qenë në përputhje me BE-në sepse kjo organizatë nuk e ka kushtetutën e vet, por më tepër duhet t'i përmbahemi vlerave evropiane, transmeton lajmi.net. "Kam

ndryshuar pesë kushtetuta për jetën time, ne luajmë me Kushtetutën sikur të ishte një lodër. Mirëpo këtë herë duhet të jetë ndryshe duke ndryshuar gjithë sistemin ligjor për t'u konsoliduar me atë që është e rëndësishme për perspektivën evropiane", është shprehur Crnobraj.

## Habilajt në 4 vjet trafikuan 30 tonë kanabis

**ABC News ka mësuar nga dosja sekrete e mbërritur në Prokurorinë e Krimeve të Rënda se grupi kriminal i Moisi Habilajt ka dërguar në brigjet italiane nga vitit 2013-2017 rreth 30 tonë drogë kanabis sativa**

Grupi kriminal i drejtuar dhe i organizuar nga vëllezërit Habilaj kanë trafikuar nga brigjet shqiptare drejt atyre italiane rreth 30 tonë kanabis sativa. Në këtë konkluzion kanë dalë hetuesit italian, ku ky aktivitet kriminal ishte kry-

er në harkun 2013-2017. Gjatë biseda të përgjuara dhe të bëra publike tashmë nga gjykata e Katani, anëtar të këtij grupi shqetësohen për mjetet të siguruar mjete të shpjeta lundruese me tre motor, të cilët konsiderohen edhe si gomone oqeanike. Vetëm në dy aksionet e fundit të kryera në Itali e në Shqipëri, grupit që udhëhiqej nga Moisi Habilaj e Florian Habilaj dhe anëtarëve të tjerë, Nezar Seiti, Meriadian Suluj e Armando Sulaj, iu sekuestruan në total rreth 8 tonë drogë. Fillimisht, në zonën e Brindisit u kapën rreth 3.5 tonë



kanabis dhe ishte dërguar nga banda e Habilaj me mjete lundruese gjatë muajit shtator. Por vijimi i aksionit edhe në territorin shqiptar çoi në zbulimin edhe të 4 tonëve të

tjera drogë të magazinuar dhe e gatshme për transport detar, në zonën e Babicës së Vogël në qytetin e Vlorës. Por ky aksion diskret, solli edhe përplasjen ndërmjet poli-

cisë dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ku deri në momentin e kryerjes së operacionit, uniformat blu u mbajtën larg nga frika e dokonspirimit. Gjithashtu, ABC News ka mësuar në dosjen e cila mbahet sekret nga organi qëndror i akuzës se, gjatë vitit 2014-2015, grupi kriminal i Habilajve ka dërguar në Itali ngarkesa me drogë edhe në rrugë ajrore, konkretisht në zonën e Akrenisë, po në Vlorë. Për këtë aktivitet kriminal, Prokuroria e krimeve të rënda në bashkëpunim me homologët e Katani, të cilët kanë kryer përgjimet

edhe në territorin Shqiptar, prangosjen e Deputetit Saimir Tahiri. Emri i ish-ministrit të Brendshëm ka dalë gjatë biseda me anëtarët grupit si edhe i ka ndihmuar këta të fundit të jenë të paprekshëm në qarkun e Vlorës. Aktualisht fati i deputetit Tahiri mbetet në dorën e ligjvënësve nëse do t'ia heqin apo jo mandatin e deputetit. Prokuroria kërkon burgosjen e Tahirit, pasi ai akuzohet për "trafik të narkotikëve e kryer në grupin e strukturuar kriminal" dhe "korrupsionit pasiv i zyrtarëve të lartë".





"Në Arakan bëhet fjalë për arrestime arbitrare të muslimanëve. Ushtria e Mianmarit ka në objektiv të rinjtë dhe të arsimuarit nga muslimanët e Arakanit", tha Kyaw

# Luftë për mbijetesë e muslimanëve të Arakanit

Muslimanët e Arakanit luftojnë për mbijetesë në të dyja anët e kufirit midis Mianmarit dhe Bangladeshit teksa vazhdojnë edhe sulmet ndaj tyre nga ushtria e Mianmarit dhe budistëve fanatikë, shkruan Anadolu Agency (AA). Ushtria e Mianmarit filloi masakrat kundrejt civilëve si dhe shkatërrimin dhe djegien e vendbanimeve ku jeton pakica muslimane duke gjetur si arsytim sulmet e njëkohshme të ndërmarra më 25 gusht ndaj stacioneve policore në qytetin Maungdaw ku jetojnë kryesisht muslimanët. Muslimanët e Arakanit të cilët kanë marrë rrugën drejt Bangladeshit për të shpëtuar jetët e tyre për të kaluar në këtë vend ata bëjnë një udhëtim të vështirë dhe të rrezikshëm duke kaluar nëpërmjet rajoneve malore, lumit Naf ose nëpërmjet detit.

Në deklaratën e fundit të Kombeve të Bashkuara (OKB), thuhet se numri i muslimanëve të Arakanit që janë strehuar në Bangladesh që nga 25 gushti ka tejkaluar numrin prej 600 mijë. Ndër të tjera OKB-ja ka bërë të di-



## ISHULLI ËSHTË TËRËSISHT NËN UJË NGA SHIRAT MONSUN

Ndërsa një burim lokal i cili nuk dëshiron të identifikohet, në lidhje me ishullin Thengar Char ku është planifikuar vendosja e muslimanëve të Arakanit tha se "Ky ishull nuk është i përshtatshëm për jetesë, është shumë i ulët dhe në periudhën e shirave monsun mbetet plotësisht nën ujë. Gjithashtu është një ishull i izoluar tërësisht". Pasi ka tërhequr vëmendjen se Qeveria e Bangladeshit ka gjetur këtë rrugë për shkak se dëshiron të parandalojë vendosjen dhe përhapjen në vend të muslimanëve të Arakanit, burimi ka thënë se "Këtë mendim nuk e shoh të drejtë. Muslimanët e Arakanit duhet të rikthehen në territoret e tyre në vend që të mblidhen në një ishull". Ndër të tjera burimi ka bërë të ditur se Qeveria e Mianmarit do të jetë e kënaqur nëse muslimanët vendosen në ishull, dhe se kjo situatë do të inkurajojë Mianmarin që të detyrojë muslimanët e Arakanit të emigrojnë në Bangladesh.

tur se dhjetëra mijëra të tjerë janë rrugëve të migrit. Ushtria dhe budistët fanatikë janë duke djegur fshatrave që u përkasin muslimanëve të

Arakanit. Në imazhet e marra nga organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut nga satelitët u zbulua se gati 300 banorë muslimanë e kanë humbur jetën si pasojë e djegies së fshatrave të tyre në Arakan. Ministri i Jashtëm i Bangladeshit Hasan Mahmud Ali njoftoi më 10 shtator se të paktën 3.000 muslimanë Rohingya u vranë në rajonin Arakan të Mianmarit. Ndërsa numri i civilëve të vrarë nuk mund të përcaktohet saktësisht për shkak se qeveria e Mianmarit nuk lejon hyrjen dhe daljen në zonë. Teksa muslimanët e Arakanit mbërrijnë të lodhur e të uritur në rajonet pranë kufirit, gjithashtu thuhet se edhe situata në kampe po përqehsohet çdo ditë, pasi kushtet e kampeve në Bazar të Cox në Bangladesh janë të pamjaftueshme dhe shtohen të sapoardhurit. Kryetari i Këshillit Arakan Rohingya (ERC) Dr. Hla Kyaw ka bërë disa vlerësime për gazetaren e AA-së në lidhje me situatën e fundit të muslimanëve të Arakanit. Pasi ka tërhequr vë-

mendjen se muslimanët e Arakanit të cilët nuk kanë mundur të kalojnë në Bangladesh janë në rrezik në Mianmar, Kyaw tha se "Në Arakan bëhet fjalë për arrestime arbitrare të muslimanëve. Ushtria e Mianmarit ka në objektiv të rinjtë dhe të arsimuarit nga muslimanët e Arakanit". Dhe duke vënë theksin se ushtria dhe budistët fanatikë po përpiqen të largojnë të gjithë muslimanët e Arakanit nga trojet e tyre, Kyaw ka bërë të ditur se këta njerëz jetojnë me frikë. Ai thotë se komuniteti ndërkombëtar duhet të nxjerrë para drejtësisë gjeneralët përgjegjës për situatën e përjetuar në Arakan. "Nëse këta nuk nxirren para drejtësisë Mianmari duke gjetur arsytime të tjera do të largojë nga territoret e tyre muslimanët e Arakanit dhe nuk do të lejojë kthimin e tyre. Komuniteti ndërkombëtar duhet të sigurojë që qeveria e Mianmarit të ofrojë rikthimin e sigurt dhe në mënyrë të denjë në territoret e tyre për muslimanët e Arakanit", tha Kyaw.

Lidhur me planin e Qeverisë së Bangladeshit për të vendosur muslimanët e Arakanit në ishullin Thengar Char, Kyaw tha se "Ky nuk është një hap i drejtë. Mendoj se Qeveria e Bangladeshit nuk do ta bëjë këtë sepse ishulli nuk ofron një ambient të përshtatshëm për jetën njerëzore".



## Fillon me detyrë ministri i parë në botë i Inteligjencës Artificiale

Emiratet e Bashkuara Arabe (EBA) formuan një dikaster të ri në kabinetin qeveritar, në krye të të cilit emëruan një ministër "përgjegjës për inteligjencën artificiale". Sipas postimit të bërë në llogarinë e tij në Twitter, ndihmëspresidenti dhe kryeministri i Emirateve të Bashkuara Arabe dhe njëkohësisht edhe Emiri i Dubait, Sheik Muhammed bin Rashid Al-Maktum, njoftoi se ka emëruar 27-vjeçarin Omar bin Sultan Al-Olama si ministër të parë të EBA të Inteligjencës Artificiale. Në mesin e detyrave të ministrit 27-vjeçar, i cili më herë ndodhej në detyrën e "drejtorit përgjegjës për të ardhmen" në Kryeministri, do të jenë edhe monitorimi nga afër i zhvillimeve në teknologjinë e inteligjencës artificiale, fushat e përdorimit të saj dhe siguria e kësaj teknologjie. Emiratet e Bashkuara Arabe më herët publikuan edhe strategjinë e tyre të inteligjencës artificiale deri në vitin 2031. Ky vend, i cili krahas vizionit të ri dhe inteligjencës artificiale, në strategjinë e saj ka përfshirë edhe çështjet si robotët, makinat autonome (pa pilot), dronët dhe kolonizimin e Marsit, synon që deri në vitin 2021 të digitalizoj të gjitha veprimet që kryhen me letra, deri në vitin 2030 ta automatizoj 25% të rrjetit të transportit në Emirat me makina autonome, deri në vitin 2050 të prodhoj 75% të energjisë nga burimet e pastra dhe madje deri në vitin 2117 ta kolonizoj Marsin.

## Gjykata amnistion kompaninë "Bin Laden Group" që la të vdekur 111 njerëz

Një gjykatë saudite e ka shpallur si të pastër nga përgjegjësia një kompani ndërtimi, pasi vinçi i asaj kompanie u rrëzua dhe vrau 111 njerëz. Kompania saudite ishte duke renovuar një pjesë të Xhamisë së Madhe në Mekë. Gjykata saudite deklaroi se kompania "Bin Laden Group", një nga firmat më të mëdha të ndërtimit në rajon, nuk ka nevojë të kompensojë viktimat, e as të paguajë dëmet në Xhaminë e Madhe, pasi sipas gjykatës, fatkeqësia

nuk ishte shkaktuar nga gabimi njerëzor. Më 11 shtator 2015, ndodhi tragjedia pikërisht në kohën kur qyteti i shenjtë po përparonte për pelegrinazhin e Haxhit. Viktimat ishin prej dymbëdhjetë nacionaliteteve të ndryshme, njëzet e pesë nga Bangladeshi dhe njëzet e tre egjiptianë. Nga të plagosurit ishin 51 pakistanezë dhe 42 indonezianë. Aksidenti është konsideruar si më vdekjeprurësi në historinë moderne.



## Xi Jinping njësoj si Mao Ce Dun

Partia Komuniste e Kinës ka votuar për të ruajtur emrin dhe ideologjinë e presidentit aktual Xi Jinping në Kushtetutën e saj, duke e ngritur atë në nivelin e themeluesit Mao Ce Dun. Votimi unanimit për të përfshirë "Mendimin e Xi Jinping" erdhi në fund të Kongresit të Partisë Komuniste, që konsiderohet si aktiviteti më i rëndësishëm politik i Kinës. Xi Jinping ka rritur në mënyrë të vazhdueshme kontrollin e tij në pushtet që nga viti kur u bë lider në 2012. Kjo lëvizje do të thotë se çdo sfidë ndaj tij tani do të shihet si një kërcënim për sundimin e Partisë Komu-



niste. Më shumë se 2,000 delegatë u mblodhën në sallën e madhe të Pekinit për procesin e miratimit përfundimtar për të ruajtur "Mendimin e Xi Jinping mbi

socializmin me karakteristika kineze për epokën e re", të gjitha këto të shkruara në Kushtetutën e Partisë Komuniste të Kinës. Në fund të procesit, delegatët

u pyetën nëse kishin ndonjë kundërshtim, ndaj të cilëve ata u përgjigjen me zë të lartë se nuk kishin asgjë kundër. Udhëheqësit e mëparshëm të Partisë Komuniste të Kinës i kanë përfshirë ideologjitë e tyre në Kushtetutë ose mendimin e partisë, por asnjë, përveç themeluesit Mao Ce Dunit, nuk e ka quajtur filozofinë e tyre si "mendim", i cili vendoset në krye të hierarkisë ideologjike. Vetëm Mao dhe Ceng Shiaoping kanë pasur emrat e tyre të bashkangjitur me ideologjitë e tyre dhe emri i Ceng u shtua në Kushtetutë vetëm pas vdekjes së tij.





**I cilësuar si njeriu më i fuqishëm në botë, Xi Jinping vjen nga fshatrat e varfra të Kinës. Vendi ku ai është rritur, shpella, sot është kthyer në një vend pelegrinazhi që vizitohet nga mijëra persona në vit**

Xi Jinping u afirmua si kryetari më i fuqishëm i 40 viteve të fundit në Kinë. Mendimi i tij për socializmin kinez të epokës së re hyri në Kushtetutën e Partisë Komuniste Kineze (PKK). Në këtë mënyrë, ai u barazua me themeluesin e regjimit komunist, Mao Ce Dun.

Të mbledhur që prej javës së kaluar në Kongres në Pekin, më shumë se 2300 të deleguar të ardhur nga i gjithë vendi miratuan futjen në kartën e Partisë "Mendimin e Xi Jinping për socializmin kinez të epokës së re".

Një koncept që përbën një guidë veprimi për partinë më të madhe në botë (89 milionë anëtarë). Sipas politologëve vendas, Xi Jinping do të ketë një autoritet të jashtëzakonshëm tani. "Ai mund të bëhet njësoj si Mao, drejtues i përjetshëm për sa kohë të jetë në shëndet të mirë", deklaroi Willy Lam, politolog i Universitetit kinez të Hong Kongut.

Asnjë drejtues që prej Maos nuk ka parë qasjen e tij teorike të bashkohet me ideologjinë gjatë kohës që ka qenë në funksion. Emri i Deng Xiaoping, që ishte artizani në fund të viteve 1970 të reformave që e bënë Kinën fuqinë e dytë ekonomike në botë, hyri në këtë Kushtetutë të partisë vetëm pas vdekies, në vitin 1997.

Por në çfarë konsiston "Mendimi i Xi Jinping"?

"Në radhë të parë, rilindja e madhe e kombit, pra riafirmimi i Kinës si fuqi e pasur dhe e respektuar, pas më shumë se një shekull e gjysmë rënie, mundime dhe poshtërimi" – deklaroi lideri suprem kinez para kongresit.

Për këtë, Xi Jinping premtonte se do të ndërtojë një ushtri që të jetë e para në nivel botëror deri në vitin 2050, të përmirësojë mbrojtjen sociale dhe mjekësore, shtetin e së drejtës socialiste, si dhe të garantojë bashkëjetesën në harmoni mes njeriut dhe natyrës.

Por të gjitha këto nuk do të sjellin asnjë liberalizim politik.

"Gjithçka duhet të vendoset nën drejtimin e PKK-së. Organizimi i PKK-së, qeveria, ushtria, shoqëria civile dhe cilido qoftë vendi ku ne gjendemi" – u shpreh Jinping.


Lideri 64-vjeçar, në krye të Partisë që prej fundit të vitit 2012, pa asnjë dyshim do të zgjidhet për një mandat të ri pesë vjeçar si sekretar i përgjithshëm, si dhe do të marrë titullin e drejtuesit suprem në vend.

Është "The Economist" ajo që i kushtuar një analizë biografike Xi Jinping, liderit të Partisë Komuniste Kineze. Këtë javë do



Fuqi absolute mbi Kinën

# Xi Jinping barazohet me Mao Ce Dunin



zhvillohet Kongresi Kombëtar në Kinë dhe Xi Jinping sipas të gjitha gjasave do zgjidhet sërish si Sekretar i Përgjithshëm në një mandat 5-vjeçar.

I cilësuar si njeriu më i fuqishëm në botë, Xi Jinping vjen nga fshatrat e

varfra të Kinës. Vendi ku ai është rritur, shpella, sot është kthyer në një vend pelegrinazhi që vizitohet nga mijëra persona në vit.

Xi gjithashtu po projektonte që Kina të kthehet në fuqi e pashembullt ushtarake jashtë vendit.

Këtë vit ai hapi bazën e parë ushtarake të vendit, në Xhibuti. Ai ka dërguar marinën kineze gjithnjë e më larg në manovra, duke u përfshirë në korrik në pragun e NATO-s në Detin Baltik së bashku me flotën e Rusisë.

Kina zyrtare thotë se kurrë nuk do të pushtonte vendet e tjera për të imponuar vullnetin e saj (përveç Tajvanit, të cilin nuk e konsideron një vend). Përpjekjet e saj për ndërtimin e bazës është që të mbështesë misionet

paqeruajtëse, anti-piraterike dhe humanitare.

Ndryshe nga Vladimir Putin, presidenti i Rusisë, zoti Xi nuk është për një ndërhyrje globale që kërkon të shkatërrojë demokracinë dhe të destabilizojë Perëndimin.





Artet pamore

# Shqipëria brenda kornizave të realizmit socialist

Fytyra të qeshura, faqe bojëroze, fëmijë të gëzuar, që argëtohen duke luajtur "luftash" me një pushkë druri në krah, minororë me shpatulla të gjera që rrokjin shkëmbin, ushtarë shtatlartë e sypatrembur, çifte të lumtura që shkojnë në plazh...

Alma MILE

Një "parajsë mbi tokë", Shqipëria socialiste. Konsideruar si pjesë shumë e rëndësishme e propagandës, arti dhe artistët u shfrytëzuan maksimalisht nga regjimi komunist, për të ofruar një imazh plot dritë të Shqipërisë; për të lartësuar Luftën Antifashiste nacionalçlirimtare, për të "justifikuar" ardhjen në pushtet të komunistëve, për të "reklamuar" ndërtimin e socializmit dhe për krijimin e "njeriut të ri socialist". Ishte një periudhë e gjatë, në të cilën arti duhet t'i nënshtrohej dogmës së realizmit socialist, nën shembullin më të mirë të "vëllait të madh", Bashkimit Sovjetik. Në metodë, që u huazua dhe u instalua në Shqipëri, duke iu imponuar me dhunë çdo artisti. Por pavarësisht kornizës, pavarësisht normës, artistët u përpoqën të bëjnë art, ndonjëherë edhe duke shkelur normat, ndonjëherë edhe duke pësuar. Madje kishte edhe nga ata që u dënuan pikërisht për këtë... Më qartësisht na e shpjegojnë historinë e realizmit socialist në Shqipëri, artet pamore, që sot trajtohen edhe si kërshëri për turistët e huaj. Dëshmi mbi aplikimin e metodës së realizimit socialist në artet pamore na ofron katalogu "Realizmi socialist shqiptar", një produkt i Galerisë Kombëtare të Arteve, i përgatitur nga dr. Ermir Hoxha, pedagog pranë Universitetit të Arteve, firmën e të cilit mbajnë tekstet shoqëruese të katalogut, por edhe përzgjedhja e imazheve. Katalogu përfshin një gamë të gjerë veprash, por pa pretenduar të jetë shterues.

Për drejtorin e GKA, Artan Shabani, njëkohësisht drejtues i këtij projekti, "realizimi i këtij katalogu për periudhën, ndër-tuar mbi analizën e disa prej medimeve ku ai u përqendruar, është një nga ofertat më domethënëse të këtij institucioni për të kuptuar mirë një nga periudhat më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të vendit tonë".

## Katalogu

Katalogu është mbështetur kryesisht mbi veprat e koleksionit të Galerisë Kombëtare të Arteve, e megjithatë autori ka dalë edhe përtej mureve të GKA, në koleksione private, në terren



dhe në medime të tjera, që nuk janë shfrytëzuar më parë si përfaqësuese në artet pamore. Realizimi socialist shihet i mishëruar edhe në monumente të vendosura anë e kënd Shqipërisë, në lapidarë, në murale, afreske, në postera, fotografi që zinin kopertinat e revistave të kohës. Piktori Gazmend Leka, recensues shkencor i katalogut, e vlerësoi botimin e katalogut të vlefshëm për artistët dhe studentët.

Është një katalog serioz dhe i plotë dhe vjen si një vlerë e shtuar në të gjitha botimet kushtuar artit figurativ në Shqipëri. Nuk mendoj se është shterues dhe kjo është e mira e artit, pasi më herët kanë shkruar dhe do të vazhdojnë të shkruajnë. Ky është terren shumë i rëndësishëm për të gjithë artistët, por më vjen mirë që do të mund ta shfrytëzojnë edhe studentët e arteve pamore. Përmes një teksti disa faqesh, Ermir Hoxha na shpjegon si ç'është metoda e realizimit socialist, si u huazua dhe u zbatua ajo në Shqipëri, se si shërbeu për të ngritur kultin e Enver Hoxhës, por edhe imazhin e "njeriut të ri", si u krijuan stereotipat e punëtorit/punëtore, partizanit/partizanes, fëmijës, por edhe personazheve "negativë".

Gjithashtu, Hoxha ndalet edhe te huazimet, duke na pranëvënë tablo të njohura të realizimit socialist shqiptar me kryevepra botërore, të cilat ato janë mbështetur apo frymëzuar ("Zëri i masave", Sali Shijaku/"Las Meninas", Diego Velaskes; "vallëzo Shqipëri", Abdurrahim Buza"/"Kërcimi", Henry Matisse, etj. Sigurisht, pjesa më e rëndësishme është ajo e veprave, të cilat Hoxha i ka renditur, jo në mënyrë kronologjike, por të ndara në etapa.

"Çdo periudhë ka temat e veta dominante, sipas rëndësisë së kohës. Për shembull, në vitet '45-'60 tema që dominon është lufta, sepse legjitimitet fituesit dhe pushtetmbajtësit, pastaj vjen transformimi i partisë komuniste në parti pune e më tej rindërtimi", shpjegon Hoxha, për të vijuar më tej me të tjera periudha, që shënojnë edhe "ulje-ngritjet" e realizmit socialist.

## Etapat


Etapa e parë titullohet "Parathënia e një triumfi 1945-1960", që karakterizohet nga fryma e ngritjes së vlerave të Luftës Antifashiste, për të vijuar me hapat e parë të ngritjes së vendit. Në të përfshihen vepra si "Monumenti i ushtarit të panjohur" nga Andrea Mano, "Kalimi i divizionit I në veri" nga Sadik Kaceli, "Tregime nga Lufta nacionalçlirimtare" e Nexhmedin Zajmit, "Shqiponjat partizane" të Kel Kodhelit, "Portret" nga Foto Stamo, "Monumenti i Stalini" nga Odhise Paskali, "Pyllëzimi" nga Kristina Koljaka, "Heroi i Popullit, Qemal Stafa" dhe "Skënderbeu" të Janaq Paços, "Gruaja e ulur" nga Darnish Jukniu, e shumë të tjera.

Etapa e dytë, në të cilën shquhen më qartë kornizat e metodës së re, titullohet "Importimi i realizmit socialist 1961-1969", me vepra si "Më tej" nga Shaban Hysa, "Revolucionarizimi" i Pandi Meles, "Shkojmë në punë" nga Zef Shoshi, "Leximi" nga Jani Nathanaili, "Portret punëtori" nga Guri Madhi, "Mjelsja" nga Jakup Kerraj, "Tekstilistja" nga Hasan Nallbani, "Versniku i Republikës" nga Kristaq Rama, "Lart Frymën Revolucionare" nga Muntaz Dhrami, "Enver Hoxha" i Odhise Paskalit, "Ditë fluturi-

mi" nga Spiro Kristo, "Në repartin ushtarak" nga Isuf Sulovari, "Vojo Kushi" nga Sali Shijaku, "Dy muzikantë" nga Maks Velo, etj., si edhe një seri pllakatesh të realizuara nga Safo Marko, Lllazar Taçi, Pandi Mele e Shyqyri Sako si edhe fotografi që mbajnë kryesisht firmën e Petrit Kunit.

Periudha e tretë, që karakterizohet edhe nga një frymë liberalizmi në artet pamore, titullohet "Formalizëm vs realizëm 1969-1973". Ajo hapet me "Epika e Yjeve të mëngjesit" nga Edison Gjergo, për të vijuar me "Aksionistet" nga Bajram mata, "Brigadieret" e Vilson Kilicës, "Yje të pushuar" nga Isuf Sulovari, "Mbjellja e pemëve" të Edi Hilës, "Tej dritares" nga Pandi Mele, "Selvitë" nga Maks Velo, "Vajza që këndon" nga Thoma Thomai, "Në pultin e komandimit nga Llambi Blindo, "Satira në skulpturë" nga Uran Hajdari, "Portret punëtori" nga Alush Shima, "Enver Hoxha", Isuf Sulovari, "Pas qitjes" nga Dhimitraq Trebicka, etj. Etapa e katërt, "Shkëlqimi dhe rënia e realizmit socialist", përfshin vitet 1974 dhe përshkruhet përmes veprave "Montatori" nga Petro Kokushta, "Punëtori i hidrocentraleve" nga Arben Basha, "Naftëtarët" nga Agim Shami, "Metalurgu" i Fuat Dushkut, "Buka e duarve tona" nga Skënder Kamberi, "Aksionistja" nga Hasan Nallbani, "Dritë në malësi" nga Abdurrahim Buza, "Njerëzit e ditëve tona" nga Minella Saro, "Zëri i masave" dhe "Mic Sokoli" nga Sali Shijaku, "Luftërat iliro-romake" nga Zef Shoshi, "Besëlidhja" nga Fatmir Haxhiu, "Komunistët" nga Vilson Kilica, një seri grafikash mbi Eposin e Kreshnikëve nga Gazmend Leka.

Katalogu mbyllet me një periudhë që rrok pesë vite "Në



kërkim të kohës së humbur 1985-1990". Në të përfshihen vepra si "Mbrëmje" nga Agron Bregu, "Lutja e Ikarit dhe Dedalit" nga Gazmend Leka, "Perseu" nga Edi Hila, "Legjenda e tokës" nga Edi Rama dhe Vladimir Myrtezai, "Montatori" nga Kreshnik Xhiku "Shëtitje pranverore" nga Bashkim Ahmeti, "Nën pemën e qershisë" nga Kujtim buza, "Pas mësimi" nga Anastas Kostandini, "Karnavale" nga Maks Velo, "Pranverë" nga Edi Rama, "Piramida" e Lumturi Blloshmit, "Portret" nga Zihni Veshi, "Onufri" nga Mikel Temo, etj, për t'u mbyllur me fotografinë mitike të Roland Tashos, "Patkoi i fatit", 29 maj 1991. (panorama)





Natyra e dyfishtë e iluminizmit është eksploruar në projektin artistik në "33rd Kaldor Public Art Project", "The Last Resort" të Anri Salës. Kombinimi i lokacionit spektakolar (në "Observatory Hill) dhe instalacioni i konceptuar në mënyrë brilante, e bën këtë një prej projekteve më të paharrueshme të Kaldor, shkruan The Sydney Morning Herald

Historianët asnjëherë nuk mund të pajtohen me të ashtuquajturën "Epokë të iluminizmit". Përkufizimi i ngushtë i ka fillet te vdekja e Luigjit XIV në vitin 1715 dhe te fundi me Revolucionin Francez në vitin 1789. Versioni i gjatë nis diku në fundin e viteve 1600 dhe dështon më 1815 me mundjen e Napoleonit në Waterloo- kështu nis tekstin, The Sydney Morning Herald, kushtuar punës së artistit shqiptar, Anri Sala.

Ashtu sikurse datat, kontestohen po ashtu edhe arritjet e asaj epoke kur shkenca dhe filozofia avancuan goxha. Jemi mësuar të mendojmë për iluminizmin si pikë referimi në historinë e civilizimit, por vazhdimisht po shikohet si lëvizje eurocentrike që frymëzoi sjelljet imperialiste karshi pjesës tjetër të botës. Natyra e dyfishtë e iluminizmit është eksploruar në projektin artistik në "33rd Kaldor Public Art Project", "The Last Resort" të Anri Salës. Kombinimi i lokacionit spektakolar (në "Observatory Hill) dhe instalacioni i konceptuar në mënyrë brilante, e bën këtë një prej projekteve më të paharrueshme të Kaldor, shkruan The Sydney Morning Herald.

Sala u lind në Shqipëri në vitin 1974, i cili kaloi 11 vjet të jetës së tij nën diktaturën e Enver Hoxhës, një eksperiencë që ndoshta mund të përshkruhet si formuese e karakterit. Në vitin 1996 ai la Shqipërinë dhe shkoi në Paris për studime dhe

The Sydney Morning Herald për Anri Salën

# "The Last Resort", një model i artit publik



brenda pak vitesh u bë i njohur në qarqet e artit bashkëkohor.

Sala nisi të vlerësohet për punën e tij me seritë e videove që kombinojnë refleksionet mbi natyrën e muzikës, arkitekturën dhe politikën. Këto janë tema pothuajse të pazakonta për artistët e sotëm, por ishte mendimi i mprehtë i Salës prapa secilës vepër që e bëri atë të dallohet. Duke mos menduar për përmbajtjen që i prezanton audiencës, ai ka hulumtuar secilin projekt duke krijuar vepra shumë-shtresore që fokusohen në marrëdhëniet e kontradiktat dhe jo në rregullimin e ideve.

Në të kaluarën Sala ka përdorur muzikë të ndryshme si "Transfigured Night" i Schonbergut dhe "Should I Stay or Should I Go" i Clash. Për "The Last Resort" ai ka marrë një prej kryeveprave të iluminizmit, kohën "Adagio"

prej veprës "Clarinet concerto in A major" të Mozartit. Sala ka zëvendësuar tempin origjinal prej veprës së Mozartit me instruksione të reja të bazuara në kushtet atmosferike të përshkruara nga marinari James Bell, në një ditar privat të udhëtimit të tij në Australi në vitet 1838-1839. Vepra e riaranzhuar, e incizuar nga "Munchener Kammerorchester", gërhet, fishkëllen dhe me shpejtësi vjen prej altoparlantëve të vendosur në objektin e rrumbullakët. Secila notë shkakton një ritëm të caktuar prej 38 daulleve që kanë të ngjitur nga një palë shkopinj, të cilat qëndrojnë të përmbysura në tavan. Artisti thotë se ai është frymëzuar pasi ka parë lakuriqët e natës duke dremitur në "Royal Botanic Gardens".

Rezultati nuk është kakofoni po bashkëpunim mes Mozartit dhe elemen-

teve. Kur moti është i mirë muzika sistemohet në modele të harmonizuara me daulle që tingëllojnë sikur bubullima që vijnë nga larg. Sala i referohet procesit si "çoroditje" e veprës origjinale, ndoshta të shkaktuar nga distanca që është dashur të bëjë për të udhëtuar prej botës së vjetër në të rene. Duke lënë erën që të diktojë, tempi bëhet i përshatshëm për një koncert të kompozuar për instrumente frymore. Miraton në njëfarë mënyre luftën midis natyrës dhe kulturës, në mes të ëndrrës së iluminizmit të kontrollit perfekt e të kuptuarit, dhe ndërhyrjet e paparashikuara të motit. Dikush mund ta lexojë këtë si metaforë për mënyrën se si kolonitë britanike kërkuan të imponojnë një ideal të civilizimeve në një tokë të re dhe te banorët e saj. Nuk ka pasur njohje se jeta aborigjene prezanton-

te formë tjetër të kulturës që ia vlen të respektohet. Kolonistët e aborigjenëve ishin të egër, jetët e të cilëve mund të përmirësoheshin vetëm me përshtatjen e mënyrës perëndimore të jetesës. Në rastin më të mirë, të ndiqnin konceptin tjetër të Jean-Jacques Rousseau, se ata mund të jenë "fisnikë të egër" që jetojnë në harmoni me natyrën në mënyrë që ishte e pamundur më për evropianët. Ky vërtetim për shoqërinë indigjene kishte disa pasoja praktike. Edhe vrojtuesit më simpatikë besonin se racat aborigjene ishin të destinuara që të zhduken. Pushtuesit e racës së bardhë vetëm mund të praktikonin kujdes të përkohshëm derisa progresi mori drejtimin e vet të paevitueshëm. Ishte pikëpamje që do të konfirmohej nga darvinizmi social në vitet më vonë.

Krejt kjo nënkuptohet në deformimet e koncertit

të Mozartit, por edhe vendosja është njësoj e rëndësishme. "Observatory Hill" ishte pika më e lartë në Sidney. Ishte vendi ku kolonialistët shkonin për të shikuar yjet, të parashikonin motin dhe të shikonin anijet që vinin. Ishte vend me rëndësi të madhe për shkencëtarët dhe sigurinë e kolonisë. Objekti i rrumbullakët është hapësirë për pamje, muzikë dhe ndeja, por gjithashtu shërben si pikë vrojtimi. Në fushën e vet 360-shkallëshe jehon modeli i filozofit të iluminizmit, Jeremy Bentham, të cilin ai e rekomandoi si vend për të shikuar të burgosurit. Sugjeron një ndarje mes kënaqësive romantike të pamjes dhe pajisjes për kontroll social. Na kujton se edhe ligjet e zakonet më "iluminuese" janë të vendosura ideologjikisht dhe të mbështetura nga kërcënimi i dhunës. Daullet e grumbulluara janë reminishencë e bandës ushtarake. Edhe shumë më shumë mund të thuhet për "The Last Resort". Është Sala që thotë se Australia ishte resorti i fundit për sistemin e drejtësisë së britanikëve që kërkon një vend të ri për klasat e veta kriminale, apo ai sugjeron se civilizimi i çoroditur dhe i lodhur është dashur të shikohet përtej kufijve të vet për të kërkuar rilindje. Është po ashtu ideja për Australinë si "resort" ku turistët shkojnë për t'u rrelaksuar dhe për të bërë qejf. Me një fjalë ne e kuptojmë se si imazhi i një shteti ka pësuar metamorfozë prej burgut në park të kënaqësive. Si një vepër shembullore e artit publik, "The Last Resort" – që zë vend në Sydney prej 13 tetorit deri më 5 nëntor – na fton që të vlerësojmë bukuritë e portit dhe të koncertit të Mozartit, por gjithashtu nxit më shumë reflektime kritike. Na bën të mendojmë për vendin që e quajmë shtëpi, por nuk jep asnjë mesazh. Nëse ky qytet arrin që të ketë një diskutim të hapur dhe të ndershëm për rolin e artit publik, projekti i zgjuar i Salës atëherë është vendi ideal për ta filluar këtë debat.

Roberto Benigni

## Si të bëhesh poet

Mos filloni të shkruani menjëherë poezi dashurie, sepse janë më të vështirat, prisni të paktën nja 80 vjet që të shkruani.

Shkruani për tema të tjera, si deti, era, një kalorifer, për një tramvaj me vonesë.

Nuk ekziston aspak një gjë më poetike sesa një gjë tjetër.

Poezia nuk është jashtë, është brenda!

Poezia je Ti! Vishini mirë poezitë, kërkujini mirë fjalët.

Duhet t'i zgjidhni fjalët... ndonjëherë të duhen 8 muaj për të gjetur një fjalë të vetme.



Filloni ë zgjidhni, sepse bukuria ka filluar

kur dikush mësoi sesi të zgjedhë. Dashurohuni!

Dashurohuni, nëse nuk dashuroni është

gjithçka e vdekur!

Kur dashuron gjithçka bëhet e gjallë, lëviz, ndizet lumturia, shpërthen kënaqësia.

Jini edhe të trishtuar dhe të heshtur me madhësi.

Fryjini në fytyrë njerëzve lumturinë! Për të përcjellë lumturinë, duhet të jesh i lumtur.

Edhe për të përcjellë dhimbjen duhet të jesh... i lumtur!

Jini të lumtur! Duhet të vuani, të ndjeheni keq, të lëndoheni. Mos kini frikë të vuani, e gjithë bota vuan!

Edhe nëse nuk i keni mjetet e nevojshme për të

krijuar një poezi, vetëm një gjë është e nevojshme "Gjithçka".

Mos kërkoni "të renë"... E reja është gjëja më e vjetër që ekziston. E nëse nuk gjen pozicionin e duhur për të të ardhur varget... shtrihuni në tokë... Sepse, shtrirë vështrohet qielli. Shikoje çfarë bukurie...! Poetët nuk shikojnë... vërejnë, vështrojnë!

Bëjini fjalët të iu binden!

Nëse fjala "mur" nuk iu dëgjon... mos e përdorni më... për 8 vjet... që t'i bëhet mend për herën tjetër. Kjo është bukuria!





**Skuadra e Vardarit është debutuese njësoj si Skënderbeu dy vite më parë. Shija që ata po lënë nuk është e mirë dhe për të gjithë Evropën janë për momentin shënjestër dhe tabelë qitjeje. Skënderbeu ka pësuar vetëm 2 gola në 6 ndeshjet e këtij edicioni në fushën tonë, Vardar 6 i pëson vetëm në një ndeshje**

# Kur sheh Vardarin e kupton se kush është Skënderbeu



Shkup, 25 tetor - Në Shkup investimet në futboll janë të rëndësishme bën të ditur gazeta "Sportekspres", transmeton gazeta KOHA. Pasi ndërtuan një stadium kombëtar, prej tre vitesh janë përqendruar te KF Vardar. Një klub i organizuar deri në detaje, një kompleks stërvitor jashtë logjikës së këtij shteti, biznese ruse që financojnë dhe një buxhet prej të paktën 3 milionë euro në sezon. Në Liga Evropë deri tani kanë qenë një dëshitim. 3 humbje dhe 14 gola të pësuar, skuadra më e dobët që merr pjesë. Ndryshe, në këtë aktivitet nuk ka asnjë skuadër boshnjake e malazeze. Nuk janë as sllovenët, ndërkohë që nga kroatët ka rezistuar vetëm Rijeka.

Sipas "Sportekspres", Skënderbeu të duket një super ekip. Patjetër që gjithkush ka të drejtë të kërkojë diçka më shumë, por 2 pikë pas 3 ndeshjeve dhe barazimet më shumë se dinjitoze kundër Jang Bojs dhe Partizanit të Beogradit janë tregues i qartë i faktit që kjo skuadër është rritur e pjekur në mënyrë të

jashtëzakonshme. Për më tepër duhet parë dhe si një krenari futbollistike kombëtare për momentin. Krahasimet duhen bërë me rajonin dhe këtu në "zonën" pranë nesh nuk jemi keq përkundrazi. AEK ka bërë diçka më shumë, me 5 pikë në 3 ndeshje, por grekët janë dhe kanë qenë gjithnjë një hap më parë. Sidomos

grekët që vijnë nga ekipet e Athinës. Kish dyshime nëse Skënderbeu ishte në nivelin e Partizanit të Beogradit dhe ky kuriozitet ishte i drejtë. Partizani i ka mësuar ata se ka lojtarë të fortë, janë një makineri për prodhimin e lojtarëve dhe luajnë një futboll agresiv. Ndeshja e fundit ndaj Partizanit konfirmoi se Skënderbeu sot për sot

është "kokë më kokë" në të gjithë elementët me skuadrën më të mirë serbe të pesë viteve të fundit. Skënderbeu është i barabartë në lojë, në skemë, në cilësi, në qarkullim topi, e madje dhe në sulm. Tauamba i Partizanit dhe Soue i Skënderbeut ngjanin si dy pika uji. Dhe të mendosh që buxheti i kampionëve

të Serbisë është të paktën 3-4 herë më i lartë. Progresi i Skënderbeut në arenën ndërkombëtare është i ndjeshëm. Atë që Skënderbeu po bën sot, klubet serbe, kroate e greke e kanë bërë të paktën 10 vite më parë në kupa të Evropës. Skuadra e momentit në Shqipëri i ka djegur etapat me shpejtësi dhe sot të gjithë kanë një lloj pendese që ende nuk kanë marrë asnjë fitore. 10 vite më parë nuk guxonte kush të mendonte se ne mund të ishim në këto nivele.

Me ndërgjegje duhet rikthyer te Vardari. Ata janë debutues njësoj si Skënderbeu dy vite më parë. Shija që ata po lënë nuk është e mirë dhe për të gjithë Evropën janë për momentin shënjestër dhe tabelë qitjeje. Skënderbeu ka pësuar vetëm 2 gola në 6 ndeshjet e këtij edicioni në fushën tonë, Vardar 6 i pëson vetëm në një ndeshje. Skënderbeu është një realitet. Kujtoni deklaratën e trajnerëve të Jang Bojs dhe Partizanit. Këtu në Shqipëri barazimi ishte jo vetëm rezultati më i drejtë, por madje dhe i kënaqshëm. Të shohim se ç'do bëjë Skënderbeu jashtë fushe. Ka ardhur moment të kalojë një tjetër hap në aventurën evropiane.



## Tare tregon se si e ka ndërtuar skuadrën e Lacios

Drejtori Sportiv i Lacios, Igli Tare ka treguar se si e ka ndërtuar këtë skuadër. Nuk ishin të largëta kohët kur qindra tifozë të Lacios prisnin mes polemikave presidentin Lotito dhe drejtorin Sportiv Igli Tare për t'i kërkuar llogari mbi rezultatet negative të ekipit. Kjo tashmë është arritur falë ish-sulmuesit të Kombëtares së Shqipërisë, Igli Tare, i cili ka ndërtuar një skuadër shumë të fortë, por ai thotë se duhet pritur fundin. "Duhet të na gjykojnë në një periudhë afatgjatë pasi do të ketë rëndësi për Lacion vetëm fundi. pikërisht për këtë është shumë gabim që të ekzaltohem që tani. Presidenti Lotito i ka ide të e qarta dhe e di se çfarë duhet të bëjë. Është menaxheri më i mirë në Itali për një shoqëri futbollit", tha Igli Tare. Shqiptari është konsideruar arkitekti i merkatos së Lacios, duke finalizuar blerje me çmime të ulëta dhe shitje të bujshme. "Përpiqem gjithmonë të vendos logjikën përpara të gjithave duke zgjedhur futbollistë që mund të japin rezultat në futbollin e sotëm. "Atë që blejmë, duhet të mendojmë nëse integrohet me të tjerët apo jo, pasi grupi është përpara individëve", përfundoi drejtori sportiv i Lacios.

## Mateus mohon se do ta drejtojë Kosovën


Legjenda gjermane e futbollit, Lotar Mateus, ka hedhur poshtë pohimet e kreut të FFK-së, Fadil Vokrri, se do ta drejtojë përfaqësuesen e Kosovës. Vokrri dhe Mateus janë parë bashkë në ceremoninë e ndarjes së çmimeve "FIFA Best Awards" në Londër. Dhe, kjo ka nxitur një sërë spekulimesh se Mateus mund ta drejtojë përfaqësuesen e Kosovës. Për këtë rapor-

tuan edhe mediat e Serbisë, gjë që bëri që lajmi të marrë jehonë ndërkombëtare. Sidom, tash është vet legjendari i Bajernit dhe Interit ai që ka mohuar një gjë të tillë. "E mohoj kategorikisht se do ta marr drejtimin e Kosovës. Nuk ka gjasa", deklaroi Mateus për "B92". Lidhjet e Mateus me Serbinë janë të njohura dhe të forta. Ai ka drejtuar skuadrën e Partizanit të Beogra-



dit, skuadër të cilën edhe e kualifikoi në

Ligën e Kampionëve. Vokrri konfirmoi interesimin për Mateus, por duket se ai vet nuk ka interesim për ta drejtuar përfaqësuesen e Kosovës. Kujtojmë se Albert Bunjaku i dha fund aventurës së tij në krye të përfaqësueses së Kosovës pasi përfaqësuesja nuk arriti të sigurojë asnjë fitore në kampanjën kualifikuese për Botërorin, Rusia 2019.



## Na lejoni të punojmë punën tonë

Shkup, 25 tetor - Komisioni i Arbitrave pran Federatës së Basketbollit të Maqedonisë, reagoi dje për shkrimet në disa media vendore për punën e arbitrave në basketbollin vendor bën të ditur "Alsat-M. "Konsiderojmë se nuk duhet të ketë presion në vendimin e komisioneve përkatëse të Federatës së Basketbollit vendor. Komisari i garave së bashku me Komisionin e Arbitrave, do të rishqyrtojë edhe njëherë sfidën Feni Industri - Ohrid dhe nëse konstatohet se ka gabuar arbitri, do të ketë sanksione përkatëse. Mirëpo, nuk do të ndikojë presioni nga jashtë në vendimin përfundimtar para fakteve dhe dëshmi", thuhet mes tjerash në kumtesën e Komisionit të Arbitrave pran FBK-së. Komisioni poashtu ka kërkuar nga skuadrat e Ligës së Parë të përbahen në njërin përqendrim dhe impenjim. Nga ana tjetër, internisti është si një palë tuta për punë. Në këtë rast, varet çfarë të pëlqen më tepër. Unë personalisht preferoj xhinset", ka deklaruar gazetari i "Sky Sport".

## Januzaj pret minutazhë më të madhe te Sociedadadi

Adnan Januzaj nuk është i kënaqur me minutazhën e tij të deritashme te Real Sociedadadi, por mesfushori e arsyeton këtë me disa lëndime të lehta që i ka pasur. Ai të martën për të përditshmen "Marca" ka thënë se tash i ka tejkaluar të gjitha dhe po ndihet shumë më mirë. Kështu që, ai është i bindur se tash e tutje minutazha e tij te ekipi spanjoll, do të jetë dukshëm më e madhe. "Nuk kam luajtur shumë deri më tani,

pasi kam pasur shumë lëndime të vogla dhe dy javët e fundit kam qenë i sëmurë. Besoj se tash do të kem më shumë minuta, pasi po ndihem më mirë dhe po punoj për të arritur formën time më të mirë", është shprehur Januzaj. Mesfushori 22-vjeçar, para fillimit të këtij edicioni iu bashkua Sociedadadi nga Mançester Junajtedi. Ai deri më tash, ka regjistruar shtatë paraqitje në të gjitha garat.



## "Sky Sport": Hysaj është si një palë xhinse

Paraqitjet e shqiptarit në Serinë A kanë qenë gjithmonë të lavdërueshme dhe Elseid Hysaj është bërë prej dy vitesh i pazëvendësueshëm në skuadrën që është duke tentuar fronin e futbollit italian. Pas ndeshjes Napoli-Inter, gazetari i "Sky Sport", Alessandro Alçato, ka bërë një krahasim mes mbrojtësit të Kombëtares shqiptare me atë



të kombëtares italiane. brozio? Shqiptari është si një pale xhinse. I vesh "Hysaj apo D'Am-

në të gjitha rastet. Edhe nëse bëhet fjalë për të luajtur në ndeshjen Empoli-Salernitana, edhe nëse bëhet fjalë për Mançester Siti-Napoli, ka të njëjtin përqendrim dhe impenjim. Nga ana tjetër, internisti është si një palë tuta për punë. Në këtë rast, varet çfarë të pëlqen më tepër. Unë personalisht preferoj xhinset", ka deklaruar gazetari i "Sky Sport".





Doja të fitoja në Austin, por duhet të pranojmë që kemi probleme. Sot po paguajmë problemet që kemi pasur gjatë kësaj periudhe dhe tani duhet të ishim më lart në renditje

NBA

# Aaron shënon 41 pikë në fitoren e Orlandos

Po tregon një formë të shkëlqyer në këtë fillim sezoni Orlando Mexhik, që i rrëmbeu fitoren në gjysmën e dytë të periodës së fundit Bruklin Nets me rezultatin përfundimtar 125-121. I mrekullueshëm Aaron Gordon me 41 pikë, dy asistime dhe plot 14 rikuperime



tabelë. Kevin Love shtoi 20 pikë të tjera për Kavs, ndërsa në radhët e Bullsave statistikat më të mira i regjistroi Holiday, që shënoi 25 pikë. Për Çikago Bulls kjo ishte humbja e tretë radhazi në po

kaq ndeshje. Po tregon një formë të shkëlqyer në këtë fillim sezoni Orlando Mexhik, që i rrëmbeu fitoren në gjysmën e dytë të periodës së fundit Bruklin Nets me rezultatin përfundimtar 125-121.

I mrekullueshëm Aaron Gordon me 41 pikë, dy asistime dhe plot 14 rikuperime, ndërsa për Netsat spikati Russell me 29 pikë. Francezi Fournier me 28 pikë, katër asiste dhe gjashtë kërcime ishte një tjetër vlerë e shtuar për Mexhik. Gjen vazhdimësinë në rezultate Boston Seltiks, që kaloi pa shumë vështirësi 110-89 Nju Jork Niks. Indiana Pejsers shkatërroi 107-130 në "Target Center" Minnesota Timberwolves, Portland Trail Blazers iu imponua 103-93 Nju Orleans Pelikans, ndërsa Los Anxhelos Klipers fitoi në "Staples Center" 102-84 me Jutah Xhez. Kalifornianët po tregojnë se do të jenë pretendentë seriozë në këtë sezon, pasi kryesojnë Konferencën e Lindjes me tre fitore në po kaq ndeshje.



## Po paguajmë shtrenjtë gabimet e bëra gjatë sezonit

Sebastian Fettel vlerëson paraqitjen dhe fitoren e Luis Hamilton në pistën e Austin dhe, njëkohësisht, pranon se nuk kishte asnjë shans për ta fituar garën e fundit të zhvilluar në Amerikë. Piloti gjerman ka shtyrë të paktën edhe me një javë festën e britanikut, që është pranë titullit të katërt kampion në karrierë. "U nisa mirë dhe ishim të shpejtë. U përpoqa ta ndaloja Luis, por ishte shumë i shpejtë dhe diferencat ishin të dukshme. U ndala më shpejt për të provuar diçka ndryshe, por ndjeja se gomat nuk përshtateshin mirë. Megjithatë, arritëm të ngjitemi në podium me të dyja makinat dhe ky është një rezultat i mirë", tha Fettel. Duke folur për garën e fundit, piloti gjerman i "kokëkuqes" pranon se Ferrari ka bërë progres, çka konfirmohet te rezultati final. Nga gara e Austin ai kujton parakalimin ndaj Bottas, që ishte i veçantë. "U futa mes dy makinave, ishte pak e rrezikshme por pashë hapësirën dhe hyra", tha Fettel, që vazhdon të mbajë të hapura shpresat për titullin kampion edhe pse ai duket tabu. "Doja të fitoja në Austin, por duhet të pranojmë që kemi probleme. Sot po paguajmë problemet që kemi patur gjatë kësaj periudhe dhe tani duhet të ishim më lart në renditje", deklaroi piloti gjerman i Ferrarit.

Publicitet

## Të rinjtë e kanë rritur nivelin, por jam gati të përballem me ta

Valentino Rossi nuk ndihet aspak "i vjetër" në sportin e motoçiklizmit, pavarësisht se po prek shifrën e 40 viteve. Një jetë kaluar në garat e motorëve e kanë kthyer pilotin italian në një idhull, një model për shumë të rinj, me të cilët ai sot përballlet çdo fundjavë në pistë. "Vitet e fundit kanë ardhur shumë pilotë të rinj, që e kanë rritur ndjeshëm nivelin në Moto GP dhe shtuar rivalitetin. Por unë nuk kam frikë dhe jam gati të dueloj me çdokënd prej tyre", tha Rossi, që praktikisht është



jashtë betejës për titullin kampion këtë sezon. Rossi vazhdon të triumfojë, të ngjitet në podium apo rivalizojë me pi-

lotët më të rinj në pistë, çka tregon se ai nuk plaket kurrë dhe se përvoja e fituar e ka bërë atë një konkurrent edhe më të fortë. Rikthimi i tij në pistë 24 ditë pas aksidentit është një sinjal i qartë që kampionë si ai nuk tërhiqen kollaj nga sfidat. Ndërkohë, që, ai ka ende një kontratë edhe për vitin 2018 me Jama-ha, e cila mund të shtyhet edhe për dy vite të tjera. "Unë punoj për ta bërë Jama-ha kompetitive dhe fituese në çdo garë. Podiumi në Austri është një rezultat i mirë për mua", deklaroi Rossi.

Në bazë të nenit 15, paragrafi 2 e Rregullores së Seminarit ndërkombëtar për gjuhë, letërsi dhe kulturë maqedonase pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup nr. 02-637 të datës 28.9.2009, nr. 02-515 të datës 5.7.2010, nr. 02-690 të datës 29.11.2010, nr. 02-272 të datës 28.3.2011, nr. 02-509/18 të datës 8.6.2012 dhe nr. 02-667/3 të datës 15.7.2015 dhe Propozimit të Këshillit të Seminarit ndërkombëtar për gjuhë, letërsi dhe kulturë maqedonase nr. 27-802/2 të datës 18.10.2017, Drejtoria e rektoratit të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup publikon

### KONKURS

Për zgjedhje të lektorëve të gjuhës maqedonase për kohë të caktuar për vitet shkollore 2017/2018 dhe 2018/2019 në universitetet në Paris – Francë, Krakov – Poloni, Budapest – Hungari, Moskë – Federata ruse, Stamboll – Republika e Turqisë, Brno – Republika Çeke dhe Bukuresht – Rumuni, dhe atë në lektoratet në:

- Paris – Francë, një realizues në vendin e punës lektor i gjuhës maqedonase;
- Krakov – Poloni, një realizues në vendin e punës lektor i gjuhës maqedonase;
- Budapest – Hungari, një realizues në vendin e punës lektor i gjuhës maqedonase;
- Moskë – Federata ruse, një realizues në vendin e punës lektor i gjuhës maqedonase;
- Stamboll – Republika e Turqisë, një realizues në vendin e punës lektor i gjuhës maqedonase;
- Brno – Republika Çeke, një realizues në vendin e punës lektor i gjuhës maqedonase;
- Bukuresht – Rumuni, një realizues në vendin e punës lektor i gjuhës maqedonase;

1. Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet në vijim:

- Të kenë të mbaruar Fakultetin filologjik, grupi gjuhë maqedonase dhe gjuhët e sllavëve të jugut, grupi i letërsisë maqedonase dhe letërsisë së sllavëve të jugut me gjuhën maqedonase si lëndë të dytë kryesore apo me grupe të lëndëve: gjuha maqedonase bashkëkohore – semestri 6, historia e gjuhës maqedonase dhe dialektologjia e gjuhës maqedonase;
- Ta zotërojnë gjuhën e vendit për të cilën bëhet zgjedhja për lektor në atë masë që do të mundëson kryerjen me sukses të punëve apo të zotërojë një nga gjuhët botërore, e cila përdoret për mësim në shtetin përkatës;
- Të kenë leje nga organizata në të cilën është i punësuar për pushim të marrëdhënies së punës;
- Zotërimi i gjuhës dëshmohej me vërtetim të dhënë nga Fakulteti filologjik "Bllazhe Koneski" në Shkup.

2. Fillimi dhe mbarimi i orarit të punës ditore dhe javore dhe orari i kohës së punës është në pajtim me organizimin e vendit të punës në lektoratet pranë universiteteve në Paris – Francë, Krakov – Poloni, Budapest – Hungari, Moskë – Federata ruse, Stamboll – Republika e Turqisë, Brno – Republika Çeke dhe Bukuresht – Rumuni

3. Punëtorit ka të drejtë në fitim – rrogë, në pajtim me aktet e universitetit, nëse sigurohen mjete nga buxheti i Republikës së Maqedonisë. Për muajt prej tetor deri korrik paguhen 70 % (13.710,00 denarë, neto-shuma, mujore), ndërsa për muajt prej gusht dhe shtator paguhen 100% (18.035,00 denarë, neto-shuma, mujore). Rroga e punëtorit mund të jetë e ndryshueshme.

4. Zgjedhja e lektorit bëhet sipas Rregullores së Seminarit ndërkombëtar për gjuhë, letërsi dhe kulturë maqedonase, për punë të lektorëve dhe lektoratëve të gjuhës maqedonase jashtë vendit.

Nëse lektori i zgjedhur nuk pranohet nga ana e universitetit për ku është zgjedhur, Universiteti zgjedh tjetër lektor apo ndalet zgjedhja.

Për kandidatit e zgjedhur i cili nuk është në marrëdhënie pune, Universiteti nuk ka për obligim që ta punësoj pas kryerjes së afatit për të cilën zgjidhet lektori.

Kandidatët me fletëparaqitje dorëzojnë: diplomë për fakultet të kryer, biografi të shkurtër, vërtetim për zotërimin e gjuhës së huaj përkatëse dhe leje nga personi juridik për pushim nga marrëdhënia e punës.

5. Dokumentet dorëzohen deri te Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të konkursit. Zgjedhja do të kryhet në afat prej 30 ditë, me shenjë për Seminarin ndërkombëtar për gjuhë, letërsi dhe kulturë maqedonase, bul."Goce Dellçev" nr. 9, fahu post. 576, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup, me propozim të Dekanit të Fakultetit matematiko-naturor në Shkup, publikon

### KONKURS

për zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor të grupit të lëndëve në sferat mësimore-shkencore:

- Kultura shpirtërore;
- Etnologjia e Maqedonisë;
- Historia e etnologjisë;
- Antropologjia kulturore;
- Antropologjia sociale;
- Antropologjia aplikative.

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: biografi të shkurtër, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.

Dokumentet dorëzohen në Fakultetin matematiko-naturor në Shkup, rr. Arihmedova nr. 3, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodi" në Shkup

## URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

**Koha**  
E REZULTUESHME INFORMATIVE

www.koha.mk • WEB FAQJA MË E VIZITUAR

Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060  
marketing@koha.com.mk





Nëse duhet t'ia jepja një këshillë do të ishte kjo — bëj seks një javë para çdo lufte. Kjo të relakson dhe të jep energji të reja, por seksi nuk duhet të bëhet çdo ditë pasi mund të lodhesh

“Ne jemi në krye, por nuk mund ta rrezikojnë këtë. Në këto situata ne duhet të përmirësohemi, sepse ne e dimë cilësinë që kemi. Sidoqoftë, rruga është ende e gjatë. Ne duhet të vazhdojmë të fitojmë dhe përfundimisht do të shohim se ku do të jemi. Qëllimi mbetet Liga e Kampioneve”, pohon Ikardi

# Objektivi i Interit mbetet Liga e kampionëve



Kur topat mbërrijnë në zonën e tij, Mauro Icardi i magnetizon dhe pastaj i fut në rrjetë. Me një natyrë çarmatosëse. Me dopietën kundër Sampdorias, argjentinasi arriti në kuotën e 11-të golave, duke lënë pas vetes me një gol më pak patriotin Dybala dhe pozicionuar pas kryegolashënuesit Immobile. Numra të frikshëm prej bombarduesi race. Duke luajtur dhe duke folur si kapiten. “Ne jemi në krye, por nuk mund ta rrezikojnë këtë”, — tha ai për “Premium Sport”. — Në këto situata ne duhet të përmirësohemi, sepse ne e dimë cilësinë që kemi. Sidoqoftë, rruga është ende e gjatë. Ne duhet të vazhdojmë të fito-

jmë dhe përfundimisht do të shohim se ku do të jemi. Qëllimi mbetet Çampionisi”. Dhe, nëse Mauro vazhdon të shënojë kështu, Interi nuk duhet të

ketë probleme. Ndërkohë, Luçiano Spalletti, megjithatë, i intervistuar nga “Premium”, preferon të fillojë nga aspektet pozitive të një ekipi, që ren-

ditet i pari për një natë dhe është ende i pamposhtur. “Ajo që më bën efekt është sjellja e ekipit, rezultatet dhe renditja, të cilat nuk janë të mundshme pa një ekip të fortë. Sonte ne bëmë një performancë të mirë. Sidoqoftë, tek Interi nuk ka vend për eufori, sepse duhet gjetur gjithmonë mënyra për të fituar çdo lojë. Ne kemi luajtur një ndeshje të madhe, jo 70, 60, ose 50 minuta. Kjo ishte një lojë e madhe në tërësi. Pastaj, kundërshtari, i fortë dhe i trajnuar mirë, na vuri në vështirësi në fund. Ne e arritëm qëllimin. Pra, gjithçka ishte në rregull”, deklaroi Spalletti. Gjithsesi, Interi fitoi dhe morri përkohësisht kreun e renditjes, me 26 pikë, në 10 javë, 1 më tepër se Napoli, që mbremë luajti me Xhenoan.

## Kutinjo vlen 150 mln euro

Barcelona ka mësuar çmimin që duhet të paguajë për të siguruar në janar shërbimet e Filip Kutinjës. Sipas “Mirror”, Liverpooli është i gatshëm të privohet nga mesfushori brazilian vetëm për 135 milionë stërlina, që konvertohen afërsisht me 150 milionë euro. “Blaugranat” po vazhdon të këmbëngulin për 25-vjecarin, të cilin e konsiderojnë pasuesin ideal të Andres Iniestës, që është drejt fundit të karrierës. Gjatë verës, drejtuesit e Liverpoolit refuzuan tri oferta të Barcelonës, e fundit 119 stërlina. Interesi i kalanasve për ish-futbollistin e Interit ka mbetur i njëjtë, por



edhe dëshira e lojtarit është që të transferohet në “Camp Nou”. Kjo është arsyeja që mes përfaqësuesve të skuadrës spanjolle dhe menaxherit të Kutinjës, Kia Joorabçian, janë zhvilluar bisedime në fillim të

javës. Si ndërmjetës mes dy klubeve, përfaqësuesi ligjor i brazilianit ua ka bërë të qartë të dërguarve të Barcelonës së Liverpooli është gati të nënshkruajë marrëveshjen në janar, për 135 milionë stërlina.

## Zeman me Peskaran luan pa portier rezervë



Peskara e Zdenek Zemanit sapo përfundoi sfidën e javës së 11-të në Serinë B italiane, përballë Empolit, dhe u mund me rezultatin 3-1. Por, më shumë se sa për rezultatin, mediat italiane janë bërë kureshtarë për një fakt në listën e lojtarëve të Peskarës në këtë ndeshje.

Portieri i dytë, Piljaceli, është dërguar në tribunë nga çeku Zeman, dhe kështu klubi i Peskarës ishte në këtë sfidë pa një portier rezervë. Numri 12 u përjashtua për këtë sfidë për thyerje të disiplinës, ndërsa portieri i tretë nuk ishte grumbulluar fare me skuadrën.

## Derbi anglez për Rojs

Ka një derbi britanik mes Manchester Junajtedit dhe Arsenalit për Marko Rojs, kontrata e të cilit me Borussia Dortmundit skadon në vitin 2019. Sipas mediave gjermane, dy klubet e mëdha angleze po e monitorojnë me shumë vëmendje situatën e mesfushorit gjerman, i cili është duke u rifitësuar nga dëmtimi i ligamentit të gjurit, për t'u kthyer në fushën e blertë vetëm në fillim të vitit të ardhshëm. Është vetë 28-vjecari i cili e pranon se po e merr në konsideratë largimin nga verdhezinjtë për të ndryshuar ambient, duke e pranuar se janë 4-5 klube të mëdha që interesohen për të.

“Jam afër të 30-tave, kështu që do të kem mundësinë e



fundit për një kontratë të madhe dhe për të bërë diçka ndryshe”, u shpreh Rojs. Në Gjermani këmbëngulin se “Djajtë e Kuq” dhe “Topçinjtë” kanë marrë një sinjal të qartë nga Rojs dhe po duelojnë mes tyre për të siguruar shërbimet e futbollistit. Arsenali pritet të

humbasë verën e ardhshme Aleksis Sanchez me parametër zero, ndaj e konsideron lojtarin e kombëtares gjermane pasuesin ideal të kilianit, por edhe Hose Murinjo po e ndjek me shumë kujdes, për të përpiluar më pas një ofertë zyrtare te Borussia e Dortmundit.

### Shkurt

#### Çells do trajnerin e Napolit

Çells do të kthehet te trajneri i Napolit, Maurizio Sarri, të cilin e shikon si trashëgimtar të Antonio Conte në “Stamford Bridge”, sipas “7Gold” (via Football Italia). Ndërsa Conte fitoi titullin në Premier Ligë sezonin e tij të parë me Çells, ai e gjeti sezonin e dytë me një perspektivë shumë më të vështirë dhe raportet mediatike e lidhën atë me Milanin në javët e fundit. Kjo ka bërë që “Blues” t'i ofrojnë Sarrit një pagë vjetore prej 12 milionë eurosh, në një përpjekje për ta provokuar e larguar nga udhëheqësit e Seria A, Napoli.

#### Tjetër detaj marramendës të

#### transferimit të Nejmarit

E përditshmja franceze “L'Equipe” ka zbuluar një detaj tjetër në lidhje me transferimin rekord të Nejmar nga Barcelona te Paris Sen Zhermen për 222 milionë euro. Për të mbyllur operacionin, lexohet, babai i Nejmar ka punësuar atë që tani është menaxheri më i fuqishëm në botë: Pini Zahavi, i cili ka bërë punën e tij për një shifër të çmëndur. Në fakt, ai ka përfutur plot 12 milionë euro pas transferimit të brazilianit në kryeqytetin francez.

#### Puel, pranë stolit të Leicesterit

Klod Puel mund të marrë drejtimin e Leicester Sittit. Trajneri francez, me eksperiencën te Sautemtoni, ka nisur bisedimet me drejtuesit e skuadrës angleze për të pasuar të shkarkuarin Kreg Shaksipir. 56-vjeçari është parë dy herë në ambientet e klubit dhe, me sa duket, palët janë drejt arritjes së marrëveshjes. Sipas mediave angleze, Puel është favoriti për t'u ulur në stolin e Leicester Sittit, edhe pse interes për këtë detyrë ka shfaqur edhe ish-futbollisti dhe ish-ndihmësi Van Gal te Manchester J, Rajan Giggs. Pas nëntë javësh kampionat skuadra e Leicester-it renditet në vendin e 14 me nëntë pikë të grumbulluara. Derisa, drejtimin e përkohshëm të ekipit e ka marrë Appleton.

#### Volfsburgu mendon për Sanjan

Drejtimesit e Wolfsburgut në Bundesligë kanë hedhur sytë nga Bajary Sanja, i cili pasi mbylli aventurën me Manchester Sittin ka mbetur pa skuadër. Klubi gjerman kërkon një futbollist me eksperiencë për repartin e pasmë, pasi po vuan shumë në këtë fillim sezoni, teksa vetëm në Bundesligë ka pësuar 12 gola. 34-vjeçari është pikërisht futbollisti tek i cili mund të mbështeten “ujqërit” për t'u ringritur në kampionat. I pozicionuar në vendin e 14-të, me vetëm 9 pikë të grumbulluara, Wolfsburgu e sheh mëse të nevojshme të afrojë në organikë një futbollist me shumë eksperiencë si francezi, i cili ka luajtur me skuadra të mëdha në Premier Ligë.

#### SHBA-të duan trajner Biliçin

Rezultatet negative të Uest Hemit kanë vënë në dyshim të ardhmen e Sllaven Bilicit në krye të skuadrës. Në rast shkarkimi, 49-vjeçari mund të marrë menjëherë drejtimin e Kombëtares Amerikane. Sipas mediave angleze, e ardhmja e kroatit mund të jetë përtej Atlantikut. Bilic është në bisedime me drejtuesit e Federatës Amerikane të Futbollit, që kërkojnë të nisin një epokë të re pas zhgënjimit në eliminatorët e “Rusi 2018”, ku nuk mundën të siguronin një vend në finalët e kompeticionit nga zona e Amerikës Qendrore dhe Veriore. Trajneri Brus Arena dha dorëheqjen menjëherë pas humbjes turpëruese 2-1 me Trinidad Tobagon, që e la jashtë botërorit pas shumë vitesh skuadrën amerikane.



## Refuzova Realin kur Juventus ishte në krizë

David Trezeguet, në një intervistë të dhënë për “AS”, ka zbuluar një prapaskenë interesante të merkaton: “Në periudhën e dytë të Kapellos, në 2006-ën, më ka kontaktuar Real Madrid. Juventus sapo kishte pësuar një krizë administrative, por unë refuzova. Ishin ata që nuk donin të largoheshin, si Del Piero, Buffon dhe unë. Duhet të falënderojmë disa vlera që na janë përcjellë”, ka thënë sulmuesi francez. Kriza për të cilën flet ish-futbollisti është “Calciopoli”, skandali që u zbuluar në javët e fundit të sezonit 2005-06, që dërgoi klubin bardhezi në Serinë B. Mes “senatorëve” që vendosën të qëndronin te bardhezinjtë, përveç Del Pieros dhe Buffonit të përmendur nga francezi, kanë qenë edhe Pavel Nedved, Mauro Kamoranesi, Xhianluka Pessotto, Alessandro Birindelli dhe Xhorgjio Kielini. Jo më kot këta janë edhe lojtarët më të dashur për tifozerinë bardhezi.





Rezultati pa cilësi është i mërzitshëm. Cilësia pa rezultat nuk ka kuptim”, janë akoma parimet e Krojfit dhe të futbollit total që udhëheqin “De Toekomst”, e Ardhmja, sektori i moshave të Ajaksit. Aktualisht ka 220 të rinj që ëndërojnë të jenë mes të paktën tre vetave që klubi do të vendosë t’i marrë në ekipin e parë. Ajaksi, sipas studimit të fundit të CIES, është miniera e vërtetë e arit e Evropës. Atje janë rritur 71 lojtarë, të cilët tani aktivizohen në 31 kampionate të Evropës

Stërvitja shkencore dhe vëmendja ndaj detajeve bëjnë diferencën në “Amsterdam Arena”. Ushtrimet për zotërimin e topit dhe cilësinë e pasimeve janë baza e stërvitjes së fëmijëve të çdo moshe, të gjithë të mësuar me të njëjtin model: 4-3-3 sulmues, futboll krijues dhe i shpejtë, i përbërë nga vertikalizime të shumta dhe shfrytëzimin e krahëve. Sekretet e rinjve të Ajaksit qëndron në katër fjalë, Teknikë, vizion, personalitet dhe shpejtësi (TIPS: “Technique”, “Insight”, “Personality”, “Speed”), katër asët që një talent premtues i Ajaksit duhet të tregojë se i ka. Që në moshën tetë vjeçare fëmijët mësohen të përmirësojnë ekuilibrin, të zhvillojnë një ritëm të lartë loje dhe të godasin me të dyja këmbët. Mësojnë menjëherë të vrapojnë jo vetëm drejt topit, por edhe larg, të godasin edhe nga krahët dhe jo vetëm përpara. Trajnerët janë të vëmendshëm ndaj tetë aspekteve: teknika, taktika, “know-how”, vrapim dhe rezistencë atletike, formimi i personalitetit, marrëdhënia me trajnerët, stërvitja, rendimenti në ndeshje.

ITALIA – Italia, siç e ka konfirmuar edhe “Raporti Futboll 2016” i publikuar nga FIGC, ka sektorin e moshave më pak frytdhënës mes pesë kampionateve kryesore të Evropës. CIES ka zbuluar se vetëm 6,6 për qind e lojtarëve

# Tre shkollat më të mira të futbollit në Evropë



aktualë të Serisë A kanë dalë nga ekipet e moshave të skuadrave respektive. Me pak fjalë, kemi të bëjmë me një kampionat që preferon të eksportojë më shumë se të besojë te të rinjtë më të mirë që ka në dispozicion. Kështu, nuk është një rastësi që mes 50 ekipeve të para që vlerësojnë më shumë të rinjtë është vetëm një skuadër Italiane, Inter, që vitin e kaluar ka fituar të gjitha kampionatet e moshave. Por 44 të rinjtë që zikaltrit kanë në ekipet zinxhir nuk kthehen në burime të çmueshme për ekipin e parë. Gjithsesi, sipas gazetarit të “Eurosport”, Alberto Koriele: “Ekipet e moshave i kanë siguruar zikaltrëve 160 milionë euro në 10 vitet e fundit. Ndoshta për shkak të mungesës së durimit dhe tërheqjes së madhe ndaj lojtarëve të huaj, por fakti është se numri i të rinjve është shumë i ulët”. Ndërkohë, sipas CIES, skuadra italiane që ka aktivizuar më shumë të rinj mbetet Roma, që ka rritur 20 lojtarët të cilët aktualisht luajnë në një prej pesë kampi-

onale kryesore të Evropës. Skuadra e tretë italiane në këtë renditje të veçantë pas Interit (23) dhe Milanit (22).

PERLAT E BALLKANIT – Mbrapa Ajaksit, për numrin e futbollistëve të formuar dhe të aktivizuar në Evropë, nuk është “La Masia” e Barcelonas dhe as “La Fabrica” e Real Madrid. Me 67 lojtarët që aktualisht luajnë në Evropë, shkolla e dytë më e mirë e Evropës është në Kroaci dhe është ajo e Dinamos së Zagrebit. 11 klasa moshash dhe 250 të rinj dalin prej aty çdo vit. Nga ty kanë dalë Alen Halilović, që ka qenë debutuesi më i mirë, në moshën 16 vjeç e tre muaj, në historinë e klubit, Luka Modriç, Dejan Lovren, Vedran Ćorluka, Mateo Kovačić, Niko Kranjčar, pa harruar paraardhësit e tyre Robert Prosinečki dhe Zvonimir Boban. Shkolla e Dinamos ka lindur në 1945-ën.

PARTIZANI – Kryeqyteti tjetër i futbollit për eksport në Ballkan është Beogradi. Nga ekipet zinxhir të Partizanit kanë dalë në vitet e fundit Ste-


van Jovetiç, Matija Nastasiç, Adem Ljajiç, Lazar Marković, Aleksandar Mitroviç, Milosh Jojiç i Borussia Dortmund. Prej disa vitesh, shpjegonte drejtori Vukotić për “ESPN” në 2014-ën, fëmijët futen që në moshën tetë vjeçare dhe jo më 12-13. “Ishin fëmijë dhe kishin mësuar të luain në rrugë, mes pallateve, duke zhvilluar krijimtarinë dhe lirinë e mendimit. Kjo është ajo që ne duam, të rinj që të kenë hapësirë për të gjetur zgjidhje të reja pa asnjë formë presioni”. Por, nëse në epokën e Jugosllavisë së madhe kur dilte nga ekipet e moshave qëndronte te klubi deri në moshën 28 vjeç, sot klubi ka në Evropë plot 61 lojtarë. Por vetëm 4 luajnë me ekipin e parë. Suksesi i tyre, shpjegonte Vukotić, është një kënaqësi e madhe për të gjithë. Sepse nëpërmjet historive të tyre, të rinjtë e brezave të ardhshëm mund të shohin se çfarë objektivash kanë përpara tyre. Në fund, për të gjithë vlen i njëjti leksion. Cilësia dhe rezultati duhet të ecin paralelisht.



## Ketri ndërpret ndeshjen në “Etihad”



Tifozët e pranishëm në “Etihad Stadium” për të ndjekur përballjen e “Carabao Cup” mes Manchester Sittit dhe Volvs, u bënë dëshmitarë të një episodi gazmor pak para se gjyqtari të vërshëllente për fillimin e takimit. Një nga punëtorët e klubit dalloj një brejtës pranë flamurit të këndit, të cilin tentoi ta largonte nga fusha. Bëhej fjalë për një ketër, i cili nuk dëshironte të “braktiste” fushën e “Etihad”. Duhej të kalonin plot 8 minuta që “i paftuari” të largohej nga terreni i lojës, sigurisht jo me dëshirën e tij.



## ISIS kërcënon me foton e gjakosur të Messit

ISIS kërcënon se do të ketë si objekt vitin e ardhshëm Kupën e Botës, që do të zhvillohet në Rusi. Kështu njofton “SITE Intel Group”, një agjenci ndërkombëtare e specializuar për të ndjekur komunikatat e organizatave xhihadiste. Sipas saj, Shteti Islamik ka përdorur një foto të Lionel Messit, ku shfaqet me sy të gjakosur, si kërcënim për atë që i pret futbollistët por edhe tifozët në stadiumet ruse. Por fotomontazhi me Lionel Messin nuk është i vetmi që ka publikuar ISIS për të kërcënuar pjesëmarrësit në “Rusi 2018”. Janë edhe shumë imazhe të tjera të montuara nëpërmjet të cilave Shteti Islamik kërkon të shkaktojë panik para evenimentit për të rëndësishëm sportiv të vitit të ardhshëm.



## Messi meriton ta fitojë Kupën e Botës



Ai e njeh mirë, e admiron atë. Por, mendimi i Karles Pujol nuk është i kushtëzuar nga dashuria, por argumentohet rigorozisht. “Leo Messi meriton të fitojë një Kupë Bote. Kam admiruar gjithmonë frymën e tij konkurruese, krenarinë

e tij. Kjo është arsyeja pse unë kam qenë i shqetësuar në lidhje me kualifikimin e Argentinës së tij për Kupën e Botës 2018. Shpresoj që të kemi një finale mes Spanjës dhe Argentinës. Messi është më i miri dhe unë gjithmonë e uroj atë, – mendon dhe thotë kapiteni historik i Barcelonës. – Është e mahnitshme se si e shikoni duke luajtur atë. Sot ai menaxhon të gjitha të dhënat e lojës. Gjithashtu, Leo është përmirësuar në ekzekutimin e gjuajtjeve të lira, – tha ai në një intervistë me “90 minuta”, në “Fox Sports”.

## Kemi luajtur me një top “të papranueshëm”

Trajneri i Manchester Sittit Pep Guardiola është ankuar për topin me të cilin u luajt në “Carabao Cup” duke e cilësuar si “të papranueshëm”. Pas 120 minutash lojë pa gola ndaj Vulverhempton Uandersons, qytetarët u kualifikuan në çerekfinale të kompeticionit nga pika e bardhë e penalltive, ku shkëlqeu Klaudio Bravo me dy pritje vendimtare. 4-1 për Sittin, falë pritjeve të Bravos ndaj Alfred N’Diahje dhe Konor Koady. Pas ndeshjes Guardiola tha se topi i kompanisë “Mitre Sports International” nuk ishte i përshtatshëm. “Ishte i papranueshëm. Topi ishte i papërshtatshëm për një kompeticion të një niveli të tillë. Është shumë i lehtë dhe lëviz lehtësisht gjithandej. Është e pa-



mundur të shënosh me një top të tillë dhe mund ta them këtë sepse ne fituam, ndaj nuk ka se si të jetë një justifikim. Të gjithë lojtarët e mi thanë “Çfarë është ky? Më vjen keq por ‘Carabao Cup’ është një kompeticion serioz dhe ky nuk është një top serioz. Bëhet për marketing, OK, por është i papranueshëm, nuk ka peshë, asgjë”, deklaroi trajneri spanjoll.



## DASHI (20/III-20/IV)



Ndikimi i Hënës dhe Jupiterit të favorshëm për ju mund t'ju lejojë sot të përfini tonin nga raste interesante argëtimi. Mund të jetoni dashurinë në mënyrë të shkujdesur, gjë e cila do ju bëjë të jenit në humor.

## DEMI (21/IV-20/V)



Sot ndikimi pak i favorshëm i Hënës dhe Merkurit ju bën të jenit të tensionuar, nervozë dhe të keni një sjellje mosbesuese. Të paktën me personat e dashur mundohuni t'i zbusni pak gjërat.

## BINJAKËT (21/V-20/VI)



Ndikimi diellor dhe hënor mjaft i favorshëm do ju lejojë të kaloni një ditë të këndshme të mbushur me takime interesante dhe argëtuese në të njëjtën kohë. Vetëm mundohuni të mos i transformoni bisedat e ndryshme për qëllimet tuaja personale.

## GAFORRJA (21/VI-22/VII)



Në këtë periudhë do të ndihenit më pak të gatshëm për të marrë pjesë në vende argëtuese. Preferoni më shumë të qëndroni mënjanë duke studiuar nga larg sjelljet e personave që ju rrethojnë. Në qoftë se kjo ju bën të ndihenit mirë, nuk ka asnjë problem.

## LUANI (23/VII-22/VIII)



Do të jenë të shumta rastet për të arritur pozicione prestigjioze në sektorin profesional, sidomos në qoftë se keni një kohë të gjatë që punoni në të njëjtin sektor. Mundohuni t'i shfrytëzoni mirë energjitë tuaja, sepse sfi da midis kolegëve është e fortë. Sot dhe nesër janë ditët e përshtatshme për të bërë një kontroll mjekësor.

## VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Puna dhe studimi janë shumë të favorizuara, duket se është dita e duhur për të mbyllur çdo punë që keni lënë përgjysmë. Fati do ju ndihmojë në një takim pune ose në një provim. Mos u tërhiqni përballë opinionëve me kolegë, bashkëpunëtorë e eprorë, sepse mund të nxirrni elemente të vlefshme që do ju nevojiten në të ardhmen.

## PESHORJA (23/IX-22/X)



Përqendrimi i planetëve në sektorin e bashkëpunimit dhe komunikimit ju drejton të zhvillonit projektet tuaja profesionale. Sukseset më të kënaqshme parashikohen në aktivitetet private, tregti, gazetari dhe studim. Edhe ata që kanë vendosur të bëjnë një takim pune mund të mbështeten tek yjet në favor.

## AKREPI (22/X-21/XII)



Ditë perfekte për të udhëtuar, sidomos në qoftë se ka të bëjë me udhëtime pune. Do të rritet brenda jush dëshira për të vënë në jetë projekte të reja dhe të zgjeroni rrethin e klientëve tuaj. Nuk do humbisni asnjë rast që do ju paraqitet.

## SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Edhe pse sfera fi nanciare do të jetë e favorizuar, duhet të keni kujdes, sepse Afërdita do të kalojë në kundërshtim me shenjën tuaj, duke ju bërë të shpenzoni për gjëra të kota. Kështu, yjet ju këshillojnë që në momentin që keni një shumë parash në dispozicion, të hiqni një pjesë mënjanë, për të mos ngelur pa asnjë lek në xhep.

## BRICJAPI (22/XII-20/I)



Hëna në pozicion pak të favorshëm me shenjën tuaj bën që sot të shfaqni sjellje kritike përballë partnerit, sidomos në qoftë se ky i fundit i përket Gaforres ose Peshores. Në qoftë se dëshironi të mos prishni ditën e sotme, ruani një sjellje korrekte në ambientin profesional dhe privat.

## UJORI (20/I-19/II)



Të ndihenit tërheqës, të sigurt në vetvete dhe të rëndësishëm për dikë, mjafton për të qenë të bukur dhe interesantë. Është vetëm çështje vetëkontrolli. Përfini tonin nga ky moment me fat për ta shfrytëzuar në sektorët që keni më shumë nevojë.

## PESHQIT (20/II-19/III)



Do të demonstroi një shpirt të madh initiative dhe aftësi të shkëlqyera për të parandaluar çdo problem që ju paraqitet. Kush ka një aktivitet të pavarur mund të ketë besim të suksesi i garantuar dhe përfini time të mëdha. Gjithashtu do të shikoni më mirë brenda vetes, duke i dhënë përgjigje çdo dyshimi që keni në jetën sentimentale.



NE KËTË DATE

26 TETOR 1919  
27 KORRIK 1980

SHAHIST DHE NOVELIST HOLADEZ (ORIGJ.)	T	BARABARËSI	B	POLITIKANI NE FOTO	
PRUEJES I XHAMISE		TITULLI QË I U NGJIT POLITIKANIT NE FOTO 'MBRETI...'			
KOMPANI SPORTIVE ANGLEZE					
U					
GJYMYTYRE E SIPERME					
POLITIKANI NE FOTO TAKSE					
T					
B. E.			SPANJA	E BEJ TE PAVDEKSHEM, E PERJETESOJ	
AKTORI AMERIKAN, PIT QË VUAN NGA SNOBIZMI					
Mensur Mamuti	RRUAZE GUASKASH (SHQ.)	POLITIKANI NE FOTO ISHTE 'SHAH I...'	AKTORJA AMERIKANE, UELÇ	TË BERIT INAT	VEPËR MËSHIRE, BAMIRESI ADEM DEMAÇI
BANOR I SIRISE					
TITULLI I POLITIKANIT NE FOTO					KËNGËTARJA QAZIMI KUNDËRSHTAR
P					SH. H. KËNGËTARJA TARNER
AKTORI KOSOVAR, LUAN QYTET NE OREGON					MANASTIR (QYTETI) AGIMI
V					DREJTËZA ROBERT REDFORD
PUNIM ARGJENDARIE					
					VANADIUMI AZOTI
ITRIUMI					ERA E FORTË, STUHIA

ZGJIDHJET: TB, IMAM, UMBRO, KRAH, REZA, TATIM, BË, E, BRED, SEVAR, SIRIAN, EMA, PERANDOR, SHH, DAKA, BITOL, VENETA, VIJA, FILIGRAN, V, IT, MURLANI.

## Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

				1											
4		5	6		2	9			1		2		8		7
6			4							5		8	2		9
	5		8		9	7	2				9			6	2
7										9	1			3	2
	9	2	1		6			5				4	2		5
5					1				2						7
8		7	5		4	3			6						1
				3										1	5

Shumë i lehtë: 928315647, 475682931, 631497285, 156849723, 784253169, 392176458, 543961872, 817524396, 269738514. Mesatar: 739415682, 215896347, 684273591, 973164258, 156382479, 842759163, 328647915, 567931824, 491528736.





## I lënë djalit emrin Xhihad, çifti shkon në gjykatën franceze

A do të ishte e pranueshme që në Francë, vendi që ka pësuar sulmin më gjakatar terrorist të viteve të fundit, një fëmijë të quhet Xhihad? Rasti i një çifti në qytetin e Tuluzës ka ngjallur mjaft polemika në Francë, ku autoritetet ci-

vile franceze e kanë çuar në gjykatë çështjen. Prindërit myslimanë të djalit të vogël mbrohen duke thënë se Xhihad në gjuhën arabe do të thotë mundim, përpjekje dhe nuk lidhet domosdoshmërisht me atë që njihet "lufta e shenjte". Ligji në

Francë u lejon prindërve të vendosin çfarëdolloj emri për fëmijët, me kushtin që ky emër të mos shkojë kundër interesave të të porsalindurit. Fjala xhihad apo xhihadist lidhet ngushtë me përshtetimin e militantëve të Shtetit Islamik. Në vitin

2013 një grua në Francë u dënua me 2 mijë euro gjobë dhe burgim me kusht, pasi dërgoi djalin 3-vjeçar me emrin xhihad në shkollë, me një bluzë me mbishkrimin "Unë jam një bombë" dhe "Xhihadi lindi më 11 shtator".

## Psikopatët mund të jenë të dobishëm për shoqërinë

Një studim i ri do t'ju ndryshojë tërësisht mendimin për njerëzit psikopatë. Sipas studimit, persona me sjellje antisociale dhe me tipare të tilla të ngjashme, mund të jenë realisht të mira për shoqërinë. Studiuesit thonë se tekta shumica e njerëzve përpiqen të marrin vendime morale, psikopatët janë më të prerë për të bërë zgjedhje pragmatike për të mirën e përbashkët. Të dhënat e gjetura nga studimi tregojnë se në rrethana të caktuara, tiparet psikopatike mund të konsiderohen të do-



bishme. Studimi është bërë nga Universiteti britanik i Plymouth. Pjesëmarrësit në studim u pyetën nëse do të ishin të aftë të sakrifikonin një person duke kryer veprime të dëmshme kundër tyre,

për të shpëtuar nga ana tjetër një grup më të madh njerëzish. Rezultatet treguan se të gjithë kishin më shumë gjasa të sakrifikonin të tjerët. Por u zbulua gjithashtu se personat me aftësi të forta psikopatike kishin më shumë probabilitet të ishin të dhunshëm më shumë se sa duhet. Në përfundim, ky studim i ri tregoi se aftësia e psikopatëve mund të konsiderohet e dobishme në rrethana të caktuara, pasi mund të nxisin një reagim më të fuqishëm "për të mirën e përbashkët".

## Suksesi i uebsajtit që ndihmon myslimanët të gjejnë grua të dytë

Në Britani është hapur një uebsite që ndihmon myslimanët që të gjejnë një grua të dytë. Faqja ka patur një sukses të madh dhe deri më tani numëron të paktën 100 mijë ndjekës.

Poligamia, ku një person ka më shumë se një bashkëshort, është e paligjshme në Britaninë e Madhe dhe personat që kryejnë këtë vepër penale, dënohen deri në 7 vjet burg. Dje një gazetare e Daily Mail, e cila u fut në



sajt, nuk u pyet nëse ajo ishte 18 vjeçe. Azad Chaiëala, themeluesi i faqes, pretendon se po

ofron një shërbim të nevojshëm dhe nga kjo përfitojnë gratë. Femrat që futen në faqe, iu prezantohen

menjëherë profilet e meshkujve myslimane të moshës 30 deri në 60 vjeç. Yasmin Rehman, nga Qendra e Hapësirës Laike, tha se faqja e internetit është shumë e rrezikshme dhe iu bëri thirrje politikanëve që të marrin masat. "Unë mendoj se kjo është shumë e rrezikshme. Faqja promovon pabarazinë dhe shfrytëzimin e grave. Gjithashtu minon martesat e ligjshme dhe po promovohet poligamia", tha ajo.

## KALENDARI HISTORIK 26 TETOR

- 740 - Tërmet i madh në Konstantinopojë.
- 1407 - Turmë e njerëzve sulmojnë Komunitetin hebre në Krakov.
- 1662 - Çarlsi II i Anglisë shet Dankirkun Francës.
- 1776 - Benjamin Franklini niset nga Amerika për në Francë në mision për të kërkuar mbështetjen e Francës për Revolucionin amerikan.
- 1810 - SHBA përvetësojnë Floridën perëndimore.
- 1822 - Mbreti Uilhemi I obligon banorët e Brukselit të përdorin gjuhën holandeze.
- 1830 - Rebelët belg okupojnë Antwerp.
- 1863 - Kryqi i Kuq mbarë botëror organizohet në Gjenevë.
- 1896 - Abisinia dhe Italia nënshkruajnë marrëveshje për paqe.
- 1905 - Përfundon Unioni mes Suedisë dhe Norvegjisë.
- 1912 - Trupat serbe pushtojnë Shkupin.
- 1922 - Qeveria italiane je dorëheqje pas presionit nga fashistët dhe Benito Musolini.
- 1941 - Takimi i dytë mes Titos dhe Drazha Mihailoviçit në Jugosllavi.
- 1947 - Përfundon okupimi britanik në Irak.
- 1950 - Nëna Terezë themelon Misionin e Bamirësisë në Kalkutë, Indi.
- 1951 - Uinston Çerçili ri-zgjidhet Kryeministër britanik.
- 1962 - Kenedi paralajmëron Rusinë që SHBA nuk do të lejojë që raketat sovjetike të qëndrojnë në Kubë.
- 1962 - Nikita Khrushchev dërgon notë Kenedit duke i ofruar tërheqjen e raketave nga Kuba nëse SHBA mbyllë bazat e saja në Turqi. Oferta refuzohet.

## A E DINI SE... ?

Kush pështyn, urinon ose nuk i mënjanojnë jashtëqitjet e qenit (të vet) në hapësirë publike, në qytetin e Lozanës, duke filluar nga dhjetori i këtij viti do të paguajë gjobë. Më 1 dhjetor në mesin e kundërvajtjeve për të cilat duhet paguar gjobë, hyjnë në fuqi gjithsej 10 sish të reja, bën të ditur qyteti i Lozanës, njofton sda.ch. Gjashtë prej këtyre kundërvajtjeve parashihen vetëm për hapësirat publike, transmeton albinfo.ch. Kështu, personi që kapet duke urinuar, do të dënohet me 200 franga, ndërsa kush pështyn, do të paguajë 100 franga. Ata që nuk i mënjanojnë jashtëqitjet e qenve të tyre në koshat përkatës, do të detyrohen të paguajnë gjobën prej 150 frangash.

## BARSOLETA



### NË PAZAR

Një hajdut shkon në Pazar për të shitur rrobat që kishte vjedhur, por një hajdut tjetër ia vjedh.

Në darkë e shoqja e cila e sheh të mërziur e pyet:

- Nuk fitove gjë?

- Kësaj here i shita me çmimin që i mora!, thotë hajduti duke qeshur...

### THËNIA E DITËS

Dikush pyeti: "A ekziston ndonjë vend ku të gjitha fajet dhe gabimet tona falen?"

Një fëmijë i vogël buzëqeshi dhe u përgjigj:

"Po, zemra e NËNËS"

